

# KOMISIONI PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR

Krijuar nga Kryeministri  
Drejtuar nga Dr. Arjan Gjonça

## RAPORTI I PARË PËR REFORMIMIN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Tiranë, Janar- Prill 2014





# **KOMISIONI PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR**

Krijuar nga Kryeministri  
Drejtuar nga Dr. Arjan Gjonça

## **RAPORTI I PARË PËR REFORMIMIN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR**

Tiranë, Janar- Prill 2014



# Termet e Referencës, Anëtarësia e Komisionit, Procedura e Punës dhe Përmbajtja e Raportit

## KAPITULLI I

### 1.1. Termet e Referencës së Komisionit

- 1.1.1. Ky Komision, i quajtur Komisioni për Reformën në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor u krijua me urdhër të Kryeministrit.
- 1.1.2. Ky Komision u krijua si një instrument i pavarur, i drejtuar dhe i përbërë nga studiues dhe ekspertë të arsimit të lartë me qëllim kryesor hartimin e reformës së arsimit të lartë në Shqipëri.
- 1.1.3. Komisioni iu ngarkua Dr. Arjan Gjonça<sup>1</sup> për ta krijuar dhe drejtuar në periudhën Janar 2014 - Korrik 2014. Kjo është periudha, gjatë së cilës Komisioni është ngarkuar që të arrijë synimet e kërkuara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- 1.1.4. Objektivi kryesor i Komisionit është të prodhojë të ashtuquajturën “White Paper”, një Raport Shkencor për Politikën e Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Shqipëri për të përballuar zhvillimin afatshkurtër dhe afatgjatë të vendit.
- 1.1.5. Përgatitja e raportit do të kalojë në tri faza:
  - 1.1.5.1. Faza e parë është hartimi i “Green Paper”- (Raporti i Parë), për t’u diskutuar nga të gjitha grupet e interesit dhe faktorët e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Shqipëri. Me daljen e këtij raporti kjo faza cilësohet e mbyllur. Në këtë fazë që ka zgjatur nga Janari deri në Prill 2014 është punuar për të prodhuar këtë Raport të Parë.
  - 1.1.5.2. Faza e dytë përfshin diskutimin e Raportit të Parë me grupet e interesit dhe faktorët e Arsimit të Lartë në Shqipëri. Kjo fazë fillon me publikimin e raportit dhe është menduar të zgjasë të paktën një muaj.
  - 1.1.5.3. Faza e tretë është faza e hartimit të Raportit Përfundimtar – “White Paper” dhe dorëzimi i tij pranë Ministrisë së Arsimit dhe Këshillit të Ministrave.
- 1.1.6. Objektivi kryesor i këtij Komisioni është të hartojë Draft-propozimin e Reformës së Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Shqipëri, e materializuar kjo në të ashtuquajturën “White Paper”.
- 1.1.7. Një objektiv tjetër i këtij Komisioni është edhe Hartimi i Procedurave për të vënë në jetë Reformën e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Shqipëri; Aktorët e përfshirë; Institucionet e Arsimit të Lartë; Procedurat që duhet të ndiqen; Afatet kohore të Vënies në jetë.
- 1.1.8. Objektivi përfundimtar i këtij Komisioni është të paraqesë pranë Qeverisë propozimet për ndryshimin e Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Shqipëri.
- 1.1.9. Në këtë proces, Komisioni ka për detyrim të përfundojë brenda afateve të detajuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave, dy raporte: Raportin e Parë “Green Paper” (Draftin për Diskutim) dhe Raportin Përfundimtar “White Paper” për Reformën e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Shqipëri.

<sup>1</sup>Dr. Arjan Gjonça është Prof. i Assoc. në Departamentin e Politikave Sociale, në London School of Economics and Political Science.

## 1.2. Anëtarësia e Komisionit

1. Dr. Arjan Gjonça (Kryetar i Komisionit)  
Prof. Asoc. i Demografisë, London School of Economics and Political Science
2. Dr. Besnik Aliaj  
Prof. i Arkitekturës dhe Planifikimit Urban, Universiteti POLIS
3. Dr. Myftar Barbullushi  
Prof. Shkencave Mjekësorë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë
4. Dr. Dhurata Bozo  
Prof. Asoc. Shkencave Biologjike, APPAL
5. Dr. Adrian Civici  
Prof. Shkencave Ekonomike, Universiteti Evropian i Tiranës.
6. Dr. Ervin Demo  
Prof. Asoc. Shkencave Ekonomike, Universiteti i Tiranës.
7. Dr. Edmon Hajdëri  
Prof. Shkencave Biologjike, Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”
8. Dr. Artan Hoxha  
Prof. Asoc. i Shkencave Juridike, Universiteti i Tiranës
9. Dr. Anila Paparisto  
Prof. Shkencave Biologjike, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, UT
10. Dr. Elida Rapti  
Psikologe, Universiteti i Arteve
11. Dr. Aleksandër Xhuvani  
Prof. i Inxhinierisë Informatike, Universiteti Politeknik i Tiranës

## 1.3. Procedura e Punës së Komisionit

Komisioni për Reformën në Arsim e Lartë dhe Kërkim Shkencor është mbledhur disa herë, gjatë periudhës Janar-Prill 2014. Në punën e tij në këta muaj, Komisioni ka marrë me dhjetëra komente dhe materiale ndihmëse nga shumë Institucione të Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe departamente të ndryshme. Midis të tjerave Komisioni ka marrë një numër të madh mesazhesh elektronike nga individë dhe institucione të arsimit të lartë.

Gjatë periudhës së hartimit të këtij Raporti, Komisioni ka biseduar me drejtoritë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe me departamente të ndryshme të Qeverisë. Komisioni ka shfletuar një dokumentacion të gjerë ku përfshihen të gjitha ndryshimet legjislative në vite, studimet e bëra nga qeveritë e mëparshme, si dhe studimet e realizuara nga institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë fazë, Komisioni ka krijuar një pasqyrë të plotë të situatës së Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe problematikës së saj. Aspekt tjetër i punës së Komisionit ka qenë prurja e eksperiencave të ndryshme ndërkombëtare. Komisioni, përveç eksperiencës individuale të anëtarëve të tij, ka studiuar dhe diskutuar sisteme të ndryshme të arsimit të lartë në rajon, Evropë dhe vende të tjera.

Komisioni e ndërtoi punën e tij mbi bazën e grupeve të punës, të drejtuara nga anëtarët e tij përkatës. Çdo grup pune u mbështet nga një numër ekspertësh. Pas punës në grupe, materiali i punuar u diskutua në Komision, dhe më pas u aprovua nga anëtarët e tij.

Minutat e takimeve janë arkivuar dhe mund të bëhen publike në materialin përfundimtar “White Paper”.

Pas përgatitjes së Raportit të Parë, Komisioni do të organizojë takime me drejtues të IAL-ve, personelin akademik të departamenteve të ndryshme, dhe me studentë në të gjitha IAL-të në vend. Komisioni do të organizojë edhe takime të tjera me grupe interesi si: Shoqatat e biznesit, autoritetet lokale, apo edhe intervista me individë të shquar në jetën akademike në vend. Periudha e diskutimit do të jetë të paktën një muaj. Kontributet e mbledhura do të përfshihen në diskutimet e ardhshme të Komisionit. Materialet për të cilat është rënë dakord do të përfshihen në raportin përfundimtar: “Green Paper”.

## **Puna e Komisionit është organizuar si vijon:**

Fillimisht u ra dakord për parimet bazë që do drejtojnë punën e këtij komisioni. Në vazhdimësi u diskutuan dhe u aprovuan qëllimet e kësaj reforme. Si të gjitha reformat edhe kjo e jona u përqendrua tek mënyra e organizimit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe IAL-ve të tij. Pasi u analizuan problemet duke marrë parasysh eksperiencat e vendeve të tjera, u bënë sugjerimet e nevojshme. Më tej puna e Komisionit u fokusua tek format dhe madhësia e financimit të arsimit të lartë. Për këtë pjesë të raportit janë bërë analiza dhe krahasime të shumta. Fokus të veçantë zunë dy aspekte të rëndësishme të arsimit të lartë; ana mësimore dhe puna kërkimore - shkencore. Rekomandimet e menduara dhe të diskutuara janë përfshirë në kapitujt VII dhe VIII, të këtij raporti. Gjatë procesit u diskutua nëse është e domosdoshme që Shqipëria të ketë një “sistem” të unifikuar dhe standardizuar të arsimit të lartë. Ky objektivi u la si qëllim afatgjatë i reformimit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe idetë kryesore për të janë përpiluar në Kapitullin XI. Një element i rëndësishëm që u diskutua për të cilin është rënë dakord, në rekomandimet tona, është lidhja shumë e rëndësishme midis mësimdhënies dhe punës kërkimore - shkencore brenda një institucioni, departamenti dhe individit. Gjithashtu, theksojmë se sugjerimet tona duhet të merren si një e tërë dhe se interpretimi e vënia në jetë i tyre mund të funksionojnë vetëm si një e tërë.

## 1.4. Përmbajtja e Raportit

### PJESA I – KOMISIONI DHE REFORMA E ARSIMIT TË LARTË

#### KAPITULLI 1 – Termat e Referencës, Anëtarësia e Komisionit, Procedura e Punës dhe Përmbajtja e Raportit

- 1.1. Termat e Referencës së Komisionit
- 1.2. Anëtarësia e Komisionit
- 1.3. Procedura e Punës së Komisionit
- 1.4. Përmbajtja e Raportit

#### KAPITULLI 2 – Qëllimet dhe Parimet e Reformës

- 2.1 Qëllimet e Raportit
- 2.2 Parimet bazë të Reformës së Arsimit të Lartë
- 2.3 Fazat e vënies në jetë sipas prioriteteve

#### KAPITULLI 3 – Gjendja aktuale e Arsimit të Lartë në Shqipëri

- 3.1 Gjendja aktuale e Arsimit të Lartë
- 3.2 Ndryshimet Ligjore në Arsimin e Lartë
- 3.3 Problematika e Sistemit të Sotëm dhe Drejtimit e Zhvillimit të tij

### PJESA II – NDRYSHIMET E REKOMANDUARA

#### KAPITULLI 4 – Organizimi i Arsimit të Lartë

- 4.1 Organizimi aktual i Arsimit të Lartë në Shqipëri
- 4.2 Problematika
- 4.3 Sugjerimet

#### KAPITULLI 5 – Organizimi dhe Funkionimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë

- 5.1 Organizimi aktual i universiteteve
- 5.2 Organizimi strukturor dhe vendimmarrja në IAL
- 5.3 Problematika
- 5.4 Sugjerimet

#### KAPITULLI 6 – Financimi i Arsimit të Lartë

- Gjendja financiare e Arsimit të Lartë në Shqipëri
- 6.1. Problematika
  - 6.2. Sugjerimet – Llojet e Financimit
  - 6.3. Sugjerimet – Burimet e Financimit
  - 6.4. Sugjerimet – Financimi në Fazën e parë (3-5 vjet)
  - 6.5. Sugjerimet – Financimi në Fazën e dytë (afatgjatë)



## **KAPITULLI 7** – Mësimdhënia

- 7.1. Cilësia e mësimdhënies
- 7.2. Ciklet e studimit
- 7.3. Programet e Studimit
- 7.4. Problematika
- 7.5. Sugjerimet – Rishikimi i programeve të studimit
- 7.6. Sugjerimet – Rishikimi i Standardeve
- 7.7. Sugjerimet – Rishikimi i Aksesit në Arsimin e Lartë
- 7.8. Sugjerimet – Rishikimi i Ngarkesës Mësimore
- 7.9. Sugjerimet – Rishikimi i Mësuesisë
- 7.10. Sugjerimet – Struktura për Organizimin e Programeve të Studimit në IAL

## **KAPITULLI 8** – Kërkimi Shkencor

- 8.1. Niveli dhe Cilësia e Punës Kërkimore -Shkencore
- 8.2. Problematika
- 8.3. Sugjerimet – Organizimi
- 8.4. Sugjerimet – Funksionimi
- 8.5. Sugjerimet – Financimi

## **KAPITULLI 9** – IAL/Degë, me Natyrë të vecantë

- 9.1. Përshkrimi
- 9.2. Problematika
- 9.3. Sugjerimet
- 9.4. Universiteti i Arteve
- 9.5. Universiteti i Sporteve
- 9.6. Universiteti i Mjekësisë
- 9.7. Akademia e Policisë
- 9.8. Akademia Ushtarake
- 9.9. Universiteti Bujqësor
- 9.10. Universitetet Rajonale

## **KAPITULLI 10** – Vënia në jetë e Reformës

- 10.1. Rëndësia
- 10.2. Fazat e jetësimit
  - 10.2.1. Faza e parë – Afatmesme
  - 10.2.2. Faza e Dytë – Afatgjatë

## **PJESA III** – E ARDHMJJA E SISTEMIT TË ARSIMIT TË LARTË

### **KAPITULLI I 11** – E Ardhmja e Sistemit të Unifikuar dhe të Standardizuar në AL në Shqipëri

# Pjesa I – Komisioni dhe reforma e arsimit të lartë

## Kapitulli II

### QËLLIMET DHE PARIMET

#### 2.1.1 Qëllimet e Raportit

2.1.1. Arsimit të lartë në Shqipëri, si në të gjitha vendet e zhvilluara, konsiderohet një shërbim publik dhe e mirë publike, dhe si rrjedhojë një nga qëllimet kryesore të kësaj Reforme është të ruajë parimet bazë të këtij arsimit të tilla si:

- o parimin e mundësive të barabarta,
- o parimin e konkurrencës së lirë
- o mbi të gjitha, të qenit shërbim publik, pra të ketë akses nga të gjithë mbi bazën e meritës.

2.1.2. Qëllimi i çdo reforme është të përmirësojë treguesit, kryesisht ata të matjes në “dalje”. Në rastin e Reformës së Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, reformimi ka si qëllim të sugjerojë ndryshime me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në dy drejtimit kryesore: mësimdhënie dhe punë kërkimore - shkencore.

2.1.3. Arsimit të lartë duhet t’u përgjigjet, përshtatet dhe paraprijë ndryshimeve në tregun e punës dhe në zhvillimin e vendit. Qëllimi i kësaj reforme është të krijojë premisat për një arsim të lartë që t’u përgjigjet nevojave të tregut të punës, si dhe drejtimeve të zhvillimit strategjik të vendit.

2.1.4. Është shumë e rëndësishme të mendojmë për një sistem të unifikuar dhe standardizuar të arsimit të lartë në Shqipëri, ku të krijohen mundësitë për një arsim të lartë, të bashkëmatshëm dhe konkurrues me “tregjet” rajonale dhe ato evropiane. Krijimi i një sistemi të unifikuar, mbetet qëllimi afatgjatë i kësaj reforme.

2.1.5. Një nga qëllimet e Reformës arsimore është të krijojë një arsim të lartë mbi baza financiare të qëndrueshme që t’u bëjë ballë ndryshimeve dhe cikleve ekonomike. Në këtë prizëm, larmia e financimit dhe pavarësia institucionale janë shumë të rëndësishme për krijimin e një arsimit të lartë që të maksimizojë të gjitha burimet e financimit që ekzistojnë në shoqëri.

2.1.6. Një tjetër qëllim i Reformës është të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të kontrollit të brendshëm (brenda IAL-ve) dhe të jashtëm, në mënyrë që të sigurojë standarde evropiane të arsimit të lartë.

2.1.7. Reforma synon krijimin e institucioneve të pavarura të arsimit të lartë që t’i rezistojnë kohës dhe ndryshimeve të ekonomisë dhe tregut.

#### 2.2 Parimet bazë të Reformës së Arsimit të Lartë

2.2.1. Parimet bazë, të cilat u diskutuan dhe u aprovuan nga Komisioni i Reformës, janë nënvizuar si më poshtë. Këto parime janë mbajtur parasysh në të gjitha fazat e punës së këtij komisioni.

2.2.2. Arsimit të lartë në Shqipëri është dhe duhet të jetë SHËRBIM DHE E MIRË PUBLIKE, dhe si i tillë kërkon në mënyrë të vazhdueshme financim të pjesshëm dhe vëmendjen e shtetit.

2.2.3. Arsimit të lartë duhet të bazohet mbi parimin e MUNDËSIVE TË BARABARTA. Shteti e ka detyrim ligjor të ndihmojë për shkollim studentët që plotësojnë kriteret, por e kanë të pamundur financim e studimeve të tyre.

2.2.4. Arsimit të lartë në Shqipëri nuk mund të zhvillohet dhe të jetë konkurrues në rajon dhe më gjerë, në qoftë se në themel të tij nuk futet KONKURENCA midis institucioneve dhe individëve.

2.2.5. Sistemi i Arsimit të Lartë duhet të INTEGROJË MËSIMDHËNIEN dhe KËRKIMIN SHKENCOR. Është shumë e rëndësishme që jo vetëm performanca e çdo individi në jetën akademike të matet dhe vlerësohet mbi këto dy drejtime, por edhe që studentët të mësohen nga akademike që kanë kontribuar në shkencë dhe në jetën shoqërore të vendit. Standardi i mësimdhënies nuk rritet vetëm nga mësues të mirë, por edhe nga studiues të mirë.

2.2.6. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik janë TË BARABARTA PËR FINANCIM qeveritar (parimi i konkurrencës). Kjo barazi bëhet mbi bazën e vlerësimeve të mësimdhënies dhe punës kërkimore- shkencore. Shteti bën diferencim vetëm për prioritetet e tij strategjike.

2.2.7. Disa nga institucionet e arsimit të lartë duhet të gëzojnë status “TË VEÇANTË” për arsye se: janë prioritet kombëtar, ose nuk mund të aplikojnë të njëjtat rregulla të konkurrencës si në IAL-të e tjera.

2.2.8. Financimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë bëhet në bazë të PERFORMANCËS së tyre me anë të modeleve/formulave që marrin parasysh:

Mësimdhënien  
Punën shkencore  
Inovacionin

2.2.9. Qeveria/ Ministria e Arsimit, përcaktojnë për çdo vit PËRPARËSITË për arsimin e lartë, pra se sa fonde do të shkojnë dhe cilat fusha janë prioritet (këtu çdo qeveri reflekton politikën e saj), por jo mënyrën se si do të përdoren këto fonde nga IAL -të.

2.2.10. Financimi i universiteteve duhet të bëhet i pavarur nga qeveria dhe për këtë sugjerohet krijimi i AGJENSISË KOMBËTARE TË FINANÇIMIT (që administron shpërndarjen e fondeve) dhe organizon vlerësimet e IAL-ve. Ky institucion është tërësisht i pavarur. AKF shpërndan fondet nëpër universitete mbi parimet e:

Barazisë  
Transparencës  
Performancës

2.2.11. Nëse duam që të kemi një SISTEM TË STANDARDIZUAR DHE UNIFIKUAR të Arsimit të Lartë në Shqipëri, IAL-të duhet të jenë:

TË PAVARURA në aktivitetin e tyre mësimdhënës dhe në kërkimin shkencor  
Të financuara pjesërisht nga shteti  
Të vetë-menaxhuara

Nuk duhet në asnjë mënyrë që financimi nga shteti të influencojë pavarësinë e këtyre institucioneve për vetëqeverisjen. Në të kundërt shteti duhet të rrisë ndërgjegjësimin e këtyre institucioneve për të qenë më efektive.

2.2.12. Në kushtet kur financimi i arsimit të lartë është një problem, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato të pazhvilluara, është e domosdoshme futja e një PAGESE MINIMALE (TARIFË) për çdo student/vit shkollor, ku qeveria përcakton pagesën/ KUFIRIN MAKSIMAL (TAVAN) të tarifës, dhe ku çdo universitet vendos tarifat e tij.

Shtresat në nevojë financohen nga shteti me fond të veçantë.

Studentët më të mirë financohen nga shteti Pagesa vendoset për diplomën universitare Për nivelin e dytë – programet e Master-it, IAL-të kanë liri të plotë në vendosjen e tarifave të tyre. Në këtë nivel shteti nuk përcakton çmim tavan.

2.2.13. Universitetet Publike për procesin e mësimdhënies kanë STATUS JOFITIMPRURËS, por mund të zhvillojnë edhe aktivitet ekonomik fitimprurës për aktivitetet e tjera jashtë mësimdhënies.

### 2.3 Fazat e jetësimit sipas prioriteteve

2.3.1. Zbatimi i Reformës së Arsimit të Lartë është i një rëndësie po aq të madhe sa është edhe hartimi i saj. Veçanërisht në kushtet kur janë evidentuar moszbatime, apo edhe shkelje të ligjit, monitorimi i zbatimit të reformës merr një rëndësi të veçantë.

2.3.2. Vënia në jetë e Reformës së Arsimit të Lartë, e detajuar në kapitullin 10, është menduar të kalojë në tri faza:

2.6.2.1. Faza e parë (0), është faza e hartimit të dokumentit strategjik të Reformës dhe përgatitjes së Ligjit. Kjo fazë ka filluar në Janar 2014 dhe do mbarojë në Korrik 2014.

2.6.2.2. Faza e dytë (1). Zbatimi afatmesëm i reformës, përfshin periudhën 2014-2017. Kjo fazë është menduar të zgjasë minimalisht 3 vjet.

2.6.2.3. Faza e Tretë (2), është faza e standardizimit të hapësirës shqiptare të arsimit të lartë, që ka si qëllim unifikimin dhe standardizimin e sistemit të arsimit të lartë, si dhe integrimin e sistemit të arsimit të lartë në hapësirën evropiane.

## Gjendja e arsimit të lartë, situata, problematika dhe zhvillimi i sistemit

### Kapitulli III

#### 3.1. Gjendja aktuale


Në vitet e tranzicionit shoqëror dhe ekonomik Arsimi i Lartë në Shqipëri ka pësuar një masivizim të jashtëzakonshëm për kapacitetet që ka dhe mundësitë që ofron. Ky masivizim, ndoshta i rëndësishëm si politikë arsimore<sup>2</sup>, nuk u bë i ndarë në faza, duke i studiuar ato. Ky faktor çoi deri diku edhe në rënien drastike të cilësisë, në vend që duhej të sillte përmirësimin e pritshëm të saj. Aktualisht sistemi shqiptar i Arsimit të Lartë paraqet konfigurimin e mëposhtëm:

Gjithsej 59 Institucione të Arsimit të Lartë, 15 publike dhe 44 private. Ndër to, 19 gëzojnë statusin universitet (12 publike dhe 7 private), 5 statusin kolegji (të gjitha private), 26 shkolla të larta (të gjitha private), 8 akademi (2 publike dhe 6 private), 1 institut (publik, qendër ndëruniversitare) dhe 17 filiale (5 të IAL publike dhe 12 të IAL-ve private). Numri i programeve të ofruara gjithsej është rreth 1500, nga të cilat rreth 700 të ofruara nga IAL publike dhe pak më shumë nga IAL -të private. Të ndara sipas nivelit të studimit, janë; rreth 650 programe Bachelor, rreth 250 Master Profesional, rreth 350 Master Shkencor, dhe rreth 100 programe të ciklit të tretë Doktoratë dhe specializime afatgjata.

Burimi: Të dhënat për IAL-të janë grumbulluar nga Banka Botërore dhe UNESCO, ndërsa ato të popullsisë nga UN Population Prospects. Siç tregojnë edhe të dhënat ndërkombëtare, Shqipëria ka një numër shumë të madh të IAL-ve për 1000 banorë (shiko figurën 3.1) në krahasim me vende të tjera të zhvilluara. Në Shqipëri ka rreth 20 IAL për një milion banorë, gati tetë herë më shumë se vende si Britania e Madhe që e ka arsimin e lartë të ndërkombëtarizuar dhe ka një përqindje shumë të madhe të studentëve të huaj. Në kushtet e një vendi me 2.8 milionë banorë dhe një ekonomie që investon jo më shumë se 40 milionë euro ose 0.5% (0.4-0.6%) të GDP-së së saj në arsimin e lartë, kjo shifër është e paprecedent.

Gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, por në veçanti nga viti 2005 deri sot, është vënë re një rritje dhe zgjerim i shpejtë eksponencial i të gjithë sistemit të Arsimit të Lartë në të gjithë komponentët e tij, si ai publik dhe ai jo publik (shiko tabelën 3.1.). Kësaj rritje i shërbeu ndjeshëm edhe hapja e riaktivizimi i sistemit të studimeve me kohë të pjeshme (i pezulluar në vitin 2001), madje dhe në fushat e studimeve të aplikuara, teknike, mjekësore, etj., që përfshihen në profesionet e rregulluara.

Figura 3.1. Numri i IAL-ve për një milionë banorë në 2014 – Shqipëria dhe një grup vendesh evropiane



<sup>2</sup>Është e rëndësishme të përmendim këtu që Shqipëria sot ka numrin më të ulët të studentëve në arsimin e lartë në rajon, numër ky që duhet të rritet në të ardhmen e afërt, por pa prekur cilësinë dhe standardet

**Tabela 3.1.** Numri i studentëve sipas statusit të universitetit dhe kohës së studimit (Numër Absolut)

Institucionet e Arsimit të Lartë	2004-5	2005-6	2006-7	2007-8	2008-9	2009-10	2010-11	2011-12
IAL Publik dhe Private	63257	74747	86863	90606	93139	122326	134877	160839
IAL Publik	62274	73031	81102	81100	79795	98917	107523	126257
Me kohë të plotë	42202	50567	58916	62289	61343	79615	88439	99241
Me kohë të pjesshme	19616	21898	21820	18119	17772	18218	18441	26655
Edukim në Distançë	456	566	366	692	680	1084	643	361
IAL Privat	983	1716	5761	9506	13344	23409	27354	34582
Me kohë të plotë	983	1716	5761	9506	13344	22894	26784	34219
Me kohë të pjesshme	0	0	0	0	0	515	570	363

(në %)

Institucionet e Arsimit të Lartë	2004-5	2005-6	2006-7	2007-8	2008-9	2009-10	2010-11	2011-12
IAL Publik dhe Private	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
IAL Publik	98.4	97.7	93.4	89.5	85.7	80.9	79.7	78.5
Me kohë të plotë	67.8	69.2	72.6	76.8	76.9	80.5	82.3	78.6
Me kohë të pjesshme	31.5	30.0	26.9	22.3	22.3	18.4	17.2	21.1
Edukim në Distançë	0.7	0.8	0.5	0.9	0.9	1.1	0.6	0.3
IAL Privat	1.6	2.3	6.6	10.5	14.3	19.1	20.3	21.5
Me kohë të plotë	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	97.8	97.9	99.0
Me kohë të pjesshme	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.2	2.1	1.0

Nga të dhënat e tabelës 3.1 është e qartë që pjesa më e madhe e studentëve në vend studiojnë në universitetet publikë (78.5%). Vlen të veçojmë dy elementë të rëndësishëm nga këto të dhëna. E para numri i studentëve në IAL-et private ka pasur një rritje shumë të shpejtë, veçanërisht në 3-4 vitet e fundit. Më e rëndësishmja është se ka pasur një rritje drastike në studimet me kohë të pjesshme në universitetet publike, që sot zënë rreth 21.5% të numrit total të studentëve në IAL-të publike. Këto dy zgjerime të paorganizuara dhe të pakontrolluara kanë sjellë masivizimin dhe deri diku edhe rënien e standardit.

Zhvillimi shumë i shpejtë i sistemit nuk u shoqërua paralelisht me zgjerimin dhe ngritjen e mekanizmave të kontrollit, plotësimin e kuadrit normativ, duke ndikuar negativisht në cilësinë e sistemit. Në këto vite, programet e profilizuara dhe ato pak profesionale humbën në kërpuhëzimin e programeve të fushave të Infermierisë, Ekonomike, Juridike, Sociale, Politike etj. Po ashtu humbi dhe kontrolli dhe rregullimi edhe mbi fushat e profesioneve të rregulluara si: Mjekësia, Stomatologjia, Farmacia etj.

Shqipëria investon në Arsimin e Lartë disa herë më pak edhe se fqinjët e saj. Ky investim është akoma më i pabashkëmatshëm kur krahasimet bëhen

me vendet më të zhvilluara të Evropës. Buxheti i shtetit ka në dispozicion rreth 38 milion euro për të mbështetur mbi 126 000 studentë në universitetet shtetërore. Kësaj shume mund t'i shtohen edhe afërsisht 20 milion euro të tjera nga të ardhurat dytësore të siguruara nga vetë universitetet, pra vetëm rreth 460 euro për student në sektorin shtetëror. Gjithsej, siç tregon edhe tabela, ka edhe rreth 34,500 studentë në sistemin privat.

Në sistemin privat, nga pagesat e ekonomive shtëpiake shqiptare, këtij investimi mund t'i shtohen diku rreth 35 - 45 milionë euro (rreth 34,500 studentë me një pagesë 1000-1250 euro). Buxheti për arsimin në përgjithësi nuk ka qenë kurrë më i lartë se 3% e PBB, duke u lëkundur në intervalet 2.2-2.8%/PBB. Ndërkohë objektiv i domosdoshëm i sugjeruar nga UNESCO, UNDP, Objektivat e Mijëvjeçarit, OCDE, BE, etj., është të paktën niveli 5% i PBB (çka nënkupton dyfishin e asaj që Shqipëria akordon aktualisht). Vendet e zhvilluara perëndimore në kuadrin e OCDE e financojnë në nivelet 5 - 8% të PBB arsimin e tyre universitar, nga i cili 1 - 3% e PBB shkon direkt për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Shqipëria i ka shpenzimet për arsimin e lartë, aktualisht 0.4 - 0.6% % të PBB, - si shumë e përbashkët e universiteteve shtetërore dhe atyre private. Shqipëria harxhon sot rreth 500-600 euro/student,

<sup>3</sup>Të dhënat për IAL-të janë grumbulluar nga Banka Botërore dhe Unesco, ndërsa ato të popullsisë nga UN Ppulation Prospects.



ndërkohë që i duhen të paktën 4-5 herë më shumë për t'u barazuar me Rumaninë dhe Bullgarinë, ose 8-10 herë më shumë për t'u afruar me Portugalinë, Spanjën etj. Pra, edhe duke mbajtur në konsideratë kushtet dhe mundësitë tona aktuale, Shqipëria duhet të synojë të paktën shifrat 1500-2000 euro/student, ose e thënë ndryshe një buxhet prej 250-350 milion euro për 161500 studentët e saj. Për buxhetin e shtetit, një shifër e tillë është e papërbalueshme edhe në 10 vitet e ardhshme, pasi tashmë trendet dhe mundësitë reale të buxheteve tona janë të perceptueshme dhe të kushtëzuara nga shumë faktorë të tjerë strukturorë e madhorë.

3.2. Ndryshimet Ligjore në Arsimin e Lartë  
Duke nisur nga viti 1990, Arsimit i Lartë ka kaluar në disa faza domethënëse me anët e tyre pozitive dhe negative për zhvillimin e tij.

Periudha: 1990-1994, karakterizohet nga vitet e hapjes së universiteteve, pas viteve të ndryshimit, ku shteti dominonte dhe autonomia universitare ishte në stad jo domethënës. Statusin "universitet" e gëzonin fillimisht vetëm dy universitete, të cilat i pasoi edhe Universiteti Politeknik, pas ndarjes nga Universiteti i Tiranës. Po ashtu, në Tiranë ekzistonin tri akademi (e Arteve, Sporteve dhe Ushtarake), në tri rajone (Shkodër, Elbasan dhe Gjirokastrë) funksiononin ende Institutet Pedagogjike që formonin mësues, ndërkohë në Korçë prej vitesh funksiononte Instituti i Lartë Bujqësor. Gjatë kësaj periudhe kërkimi shkencor realizohej pjesërisht në universitete, apo në Institutet e Sistemit të Akademisë së Shkencave dhe në Institute në varësi të Instituteve Qendrorë me vendndodhje në Tiranë dhe në rrethe të tjera.

Në vitet 1992-'93 me Vendim të Ministrisë së Arsimit, Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë Tiranës, u shndërruan në Universitete, përkatësisht të Elbasanit, Shkodrës, Gjirokastrës dhe Korçës. Më tej, në vitin 1994, në Vlorë u hap edhe Universiteti Teknologjik. Ndryshimi i statusit të tyre në universitete ishte një vendim politik, pa iu nënshtruar një procesi vlerësimi dhe standardesh akademike. Ky vendim ishte hapi i parë drejt fashitjes së identitetit dhe traditës së këtyre institucioneve dhe drejt zgjerimit që pasoi më tej në profilet e tyre programore. Që nga ky moment, këto IAL zhvilluan të gjitha programet në fusha të ndryshme akademike, pa ndonjë dallim të dukshëm. Kjo shënon dhe fazën e parë drejt largimit nga profilizimi, kaq i domosdoshëm në kushtet e një ekonomie tregu dhe një transformimi rrënjësor të strukturës së ekonomisë në vend. Vitet 1994-'99 u karakterizuan nga zgjerimi i

mëtejshëm i sistemit dhe sidomos nga zgjerimi i profileve të universiteteve në njërën anë dhe universiteteve të rretheve nga ana tjetër, duke humbur kështu në mënyrë graduale identitetin dhe profilin e tyre specifik. Ende në këtë kohë sistemi privat nuk bënte presion mbi sistemin publik, boshllëk të cilin, si nga pikëpamja e shumëllojshmërisë akademike, ashtu dhe nga pranimet e studentëve e plotësonte sistemi shtetëror që rritej dhe zgjerohej, por i palidhur me zhvillimin ekonomik të vendit dhe të kërkesës për profesione të caktuara.

Në vitin 1998 Sistemi i Arsimit të Lartë në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës përbëhej nga njëmbëdhjetë (11) Institucione të Arsimit të Lartë, nga të cilat tetë (8) universitete (3 në Tiranë, 5 në rrethe të tjera) dhe 3 shkolla të larta në Tiranë (Akademia e Arteve, Shkolla e Lartë e Infermierisë dhe Instituti i Kulturës Fizike).

Ligji i ri për Arsimin e Lartë në vitin 1999 erdhi si një domosdoshmëri për të lejuar dhe rregulluar zhvillimin e sistemit të Arsimit të Lartë dhe të gjithë komponentëve të tij përbërës, veçanërisht në kushtet e domosdoshmërisë të përditësimit të tij me elementë dhe mekanizma të rinj që impononte

### **Procesi i Bolonjës.**

Përmes këtij ligji sanksionohet qartë, për herë të parë autonomia universitare e shprehur kryesisht në skemën dhe mënyrën e zgjedhjeve të autoriteteve dhe organeve drejtuese, në vendimmarrjen akademike, qeverisjen dhe menaxhimin financiar. Në aspektin akademik futen konceptet e kurrikulave të organizuara, konceptet bazë të Bolonjës, sistemi evropian i krediteve universitare (ECTS) në kurrikulat e studimet universitare dhe integrimi i kërkimit shkencor midis atij që zhvillohej në universitete me atë të instituteve kërkimore, kryesisht të Akademisë së Shkencave. Kjo synonte dhe zbutjen reciproke të diferencave në kapacitetet mësimdhënëse dhe kërkimore midis stafit të universiteteve dhe atyre kërkimore të instituteve.

Në kuadrin e mekanizmave të sistemit të Bolonjës, në këtë ligj sanksionohet për herë të parë Sistemi i Sigurimit të Cilësisë.

Për herë të parë konceptohet dhe hapet rruga për futjen e arsimit të lartë privat në sistem dhe përfshirja e arsimit policor dhe ushtarak në sistemin e arsimit të lartë.

Vitet 1999-2007 shënuan vitet e ridizenjimit të sistemit, të riakomodimit të institucioneve dhe

kurrikulave sipas sistemit të Bolonjës dhe hapjen e institucioneve të para private të arsimit të lartë. Në vitin 2001, Shqipëria nënshkruan Marrëveshjen e Lisbonës për njohjen e diplomave dhe fillimin e sistemit të njohjes së diplomave të huaja në vend sipas kriterëve dhe standardeve evropiane, të parashikuara në kuadrin e procesit të Bolonjës. Po këtë vit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës urdhëron zbatimin e sistemit ECTS (European Credits Transfer Sistem) në të gjitha kurrikulat e IAL-ve në Shqipëri.

Gjatë vitit 2003 Shqipëria aderon zyrtarisht në procesin e Bolonjës. Ky vit shënon fillimin e organizuar të rishikimit dhe të përshtatjes së kurrikulave të Arsimit të Lartë sipas këtij sistemi, konceptimin e ECTS dhe zbatimin e tyre. Ky ishte dhe është një proces i vështirë, ende i papërfunduar veçanërisht në aspektin e harmonizimit të kurrikulave, sipas cikleve dhe profileve universitare në rang kombëtar dhe evropian.

Gjatë kësaj periudhe, duke filluar që nga 2002, u licencuan institucionet e para private. Deri në vitin 2005 funksiononin vetëm 5 IAL private, pothuajse të gjitha të specializuara (Neë York, Marubi, Luarasi, Zoja e Këshillit të Mirë dhe Fakulteti i Stomatologjisë i UFO).

Duhet të theksojmë se në këto vite, nuk kishte një kuadër ligjor të plotë, gjithë-mbulues dhe me standarde të plota për procesin e lejimit të hapjes së institucioneve private, megjithatë procesi ishte deri diku i përgjegjshëm dhe i kujdesshëm e për pasojë gradual. Institucionet e hapura gjatë kësaj kohe drejtoheshin kryesisht nga figura akademike. Ato hapeshin në kuadrin e marrëveshjeve të mirëkujdesura për cilësi dhe në fusha profesionale e komplementare që mbuloreshin më me vështirësi nga institucionet shtetërore. Është e rëndësishme të përmendet që këto IAL private u hapën si plotësuese të IAL-ve publike. Vlen të evidentohet fakti që procesi ishte i mirëkontrolluar nga MASH, ndërkohë që Sistemi i Akreditimit ishte ende në hapat e para të krijimit dhe funksionimit. Gjatë kësaj periudhe (2005-2006), AAAL ndërmori procesin e parë të vlerësimit dhe analizës së programeve dhe institucioneve ekzistuese të Arsimit të Lartë, edhe pse ky proces nuk vijoi me një vendimmarrje, apo ndikim në politikat pasuese të Arsimit të Lartë. Në këtë periudhë, rishikimi, riorganizimi i programeve ekzistuese dhe hapja e programeve të reja sipas Bolonjës, si dhe hapja e institucioneve private u bë në një bashkëpunim konstruktiv midis MASH dhe Agjencisë së Akreditimit, përfshirë këtu dhe njohjen e diplomave me komisione të përbashkëta.

Pranimet pa kritere (si në drejtim të kuotave, por edhe të standardit –mesatares) në institucionet private dhe zgjerimi i mëtejshëm i sistemit me kohë të pjesshme ishin dy faktorët kryesorë që ulën ndjeshëm cilësinë e pranimeve në hyrjen dhe në daljen të diplomave.

Gjatë viteve 2000-2005 kishte vetëm 5 IAL private, ndërkohë në 2005-2009 u hapën 34 institucione private të reja dhe një publik, ndërsa në periudhën 2009-2013, dy publike dhe 10 private IAL. Edhe ato iniciativa të hapjes së IAL-ve publike me një identitet të veçantë rajonal/gjeografik si p.sh UAMD-Durrës, apo me programe studimi special dhe krijues për sistemin shqiptar (si p.sh. FASTIP në Universitetin e Durrësit), me kalimin e kohës e humbën profilizimin, duke arritur që ata vetë, të krijuar si institucione me drejtim të rëndësishëm të profilizuar dhe rajonal, të hapnin filiale në rrethe të tjera.

Sot, Arsimi i Lartë profesional është thujse jo ekzistentë, edhe pse në Kuadrin Shqiptar të Kualifikimeve ai figuron dhe referohet si nivel. Aktualisht janë 2 institucione private që ofrojnë arsimin profesional me 4 programe studimi, ndërsa në arsimin publik janë 3 IAL me 10 programe gjithsej.

Sistemi i Sigurimit të Cilësisë, i konceptuar në ligj që në vitin 1999, me krijimin Agjencinë e Akreditimit në vitin 2001, mori zhvillim veçanërisht pas vitit 2003, me ngritjen e Këshillit të Akreditimit. Hartimi i procedurave dhe kriterëve të vlerësimit dhe formësimi i këtij sistemi ishte relativisht i ngadalshëm, në raport me rritjen dhe zgjerimin e shpejtë të institucioneve dhe programeve të studimit. Proceset e vlerësimit dhe akreditimit filluan të kenë shikueshmëri kur një pjesë e mirë e institucioneve dhe programeve në sistemin privat ishin licencuar. Ndërkohë nën kompetencën dhe kontrollin e MASH –it sistemi publik, nën mbrojtjen nga shteti nuk e konsideronte rëndësinë e tij.

Deri në vitin 2009 sistemi u zgjerua kryesisht nën vullnetin politik dhe në skemat, ku MASH kishte më shumë kompetencë në hapjen e sistemit, ndërkohë presioni mbi akreditimin pas hapjes u zhvendos mbi Agjencinë dhe Këshillin e Akreditimit. Kjo bëri që ndërsa deri në vitin 2009-2010 kishte një numër të madh hapjesh institucionesh (11), në vitet 2010-2013 përballemi me procesionin e zgjerimit dhe shtrirjes së IAL-ve private ekzistuese dhe të akreditimit me dhe pa kritere e standarde. Me gjithë përpjekjet shpesh nën izolim dhe të lëna të vetme nën presion të institucioneve të akreditimit për të vlerësuar dhe garantuar cilësinë, edhe përmes

angazhimit të ekspertëve dhe anëtareve të huaj në Këshillin e Akreditimit, nuk u arrit të pengohej ky ortek. Kjo solli situatën e sotme ku cilësia pësoi në favor të masivizimit nga njëra anë dhe abuzivimit nën petkun e zbatimit të këtij parimi nga ana tjetër. Ministria Arsimit dhe Sportit në këtë periudhë, ka pasur një rol pasiv, ndaj detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin e arsimit të lartë, si institucion përgjegjës për zbatimin e detyrimeve ligjore në arsimin e lartë dhe ndërmarrjen e politikave të nevojshme në funksion të sigurimit të cilësisë në AL.

### 3.3. Problematika e Sistemit të sotëm dhe e zhvillimit të tij

Në këtë seksion paraqiten disa nga problemet e përgjithshme të gjetura në sistem. Detajimi i tyre bëhet në çdo kapitull sipas organizimit të këtij raporti.

3.3.1 Në strukturë nuk ka pasur dhe ende nuk ka një strategji, një politikë të qartë zhvillimore dhe një model të arsimit tonë të lartë. Në të kundërt, sistemi karakterizohet nga një numër i madh rregullimesh ligjore dhe nënligjore, pa vizion dhe shpesh të pazbatueshme, të pazbatuara ose të pakontrolluara në zbatimin e tyre.

3.3.2. Nuk është kryer në rang kombëtar një analizë e mundësive reale që ka vendi për punësim, zhvillim dhe orientimin e arsimit të lartë drejt përmbushjes së këtyre nevojave aktuale, apo në të ardhmen sipas nevojave të tregut.

3.3.3. Ecuria e Arsimit të Lartë karakterizohet: o Nga një zhvillim i deformuar dhe i pa harmonizuar mes sistemit publik dhe atij privat të AL, i shprehur në numrin shumë të madh të IAL-ve, shpërndarjen e programeve të studimit dhe atë të studentëve o Orientim i gabuar i studentëve nëpërmjet zgjedhjes me “detyrim” të studimeve nëpërmjet sistemit aktual të Maturës Shtetërore, ku përputhshmëria midis preferencës reale të studimit të studentëve dhe studimeve që kryhen është e ulët.

3.3.4. Në IAL-të tona ka ndryshime të mëdha në numër studentësh, apo programesh të ofruara midis vetë institucioneve. Sot ka institucione dhe programe që funksionojnë me numër minimal studentësh. Ky fakt sjell problematikën e pamundësisë financiare për mbulimin e kostove dhe sigurimin e standardeve minimale të mësimdhënies, pa folur për kërkim shkencor apo aktivitete të tjera. Në shumë raste, nga institucionet janë gjetur rrugë

alternative të mbulimit të kostove në dëm të cilësisë deri në shkelje ligjore.

3.3.5. Sistemi privat i Arsimit të Lartë paraqitet i fragmentuar, me Institucione private të copëzuar pa një profil të vetin, me shumë programe studimi në të gjitha cikleve, por që mbajnë një numër tepër të pakët studentësh në raport me numrin e përgjithshëm. Sot, 44 IAL private mbajnë vetëm 20% të numrit të përgjithshëm të studentëve në rang vendi.

3.3.6. Arsimi i lartë publik në Shqipëri përbëhet nga disa IAL publike kombëtare të mëdha në vështirësi menaxhuese të vendosura në Tiranë, dhe nga IAL të tjera publike më të vogla, të zgjeruara artificialisht dhe që riprodhojnë njëra-tjetrën në strukturë dhe ofertë akademike.

3.3.7. Kemi akordim pa kritere të qarta të statusit të universitetit, ndërkohë që shumë prej tyre nuk i plotësojnë standardet institucionale për këtë status, gjithashtu nga ana tjetër kemi numër të kufizuar të institucioneve të arsimit të lartë universitar: akademi, shkolla të larta, kolegje, etj.

3.3.8. Ka filiale të hapura pa kriter dhe jashtë logjikës ekonomike e institucionale që krijojnë konkurrencë të panevojshme e të dëmshme, madje brenda vetë IAL-ve publike.

3.3.9. Cilësia e IAL-ve dhe e programeve të studimit në sistemin publik nuk është testuar përmes procesit të vlerësimit dhe akreditimit, duke ndikuar edhe në sistemin e IAL-ve private.

3.3.10. Në arsimin e lartë, sot ka një diversitet të lartë në ofertën akademike, që është zgjeruar pa kriter, pa politika planifikimi dhe e pajustificuar për madhësinë, popullatën, dhe kërkesën e tregut shqiptar.

3.3.11. Në llojshmërinë e ofertës akademike, mbizotëron dukshëm arsimimi i lartë universitar mbi atë profesional, jo universitar; shkallë shumë e ulët e tij si në numrin e llojeve të programeve të studimit të ofruara (as 1% të programeve në total), ashtu dhe në numrin e studentëve në këtë sistem (rreth 0.1%).

3.3.12. Pranimi në universitet karakterizohet nga politika pranimi pjesërisht të kontrolluara në sistemin publik (të paktën për programet e preferuara), por thuajse pa kritere e kontrole në sektorin privat, madje edhe për fushat e veçanta të rregulluara (BE)



dhe sipas niveleve e cikleve të studimit (MA, Prof, M.Sc. Shkencor dhe PhD në IAL-të praktikisht është lejuar pa kritere dhe nuk kontrollohet).

3.3.13. Kurrikulat janë të paharmonizuara në nivel kombëtar për të njëjtat programe sipas emërimit, llojit dhe niveleve, apo titujve të studimit. Kjo është e vërtetë madje dhe për programet që testohen pas diplomimit me Provimin e Shtetit. Kjo listë është e kufizuar në raport me atë të BE dhe me programet jo të harmonizuara me vendet e BE që midis tyre i kanë (imperative për programet që çojnë në profesione të rregulluara).

3.3.14. Zgjerimi i sistemit part-time (me kohë të pjesëshme) pa kriter e pa politika, duke e kthyer atë në një sistem kryesor arsimimi (nga dytësor në vitet e mëparshme) dhe kundër qëllimit për të cilin ekziston, si mundësi alternative për ata që janë në marrëdhënie pune.

3.3.15. Zgjerimi i pakontrolluar i sistemit të studimeve part-time preku edhe programet e studimit specifik me komponent të rëndësishëm teknik, kërkimor, praktik, profesional madje dhe ato të profesioneve të rregulluara.

3.3.16. Me gjithë politikat masiviste (në praktikë) për kualifikimin e stafeve akademike, dhe që lënë hapësira interpretuese, ato çuan në një rritje të pakuptimtë të shkallës së kualifikimit të stafit akademik. Ende shumë struktura universitare nuk i plotësojnë standardet aktuale të kualifikimit, kjo edhe për shkak të zgjerimit të tyre të vazhdueshëm.

3.3.17. Kërkimi shkencor, si komponent i rëndësishëm kyç, për institucionet e arsimit të lartë me statusin universitet, në ato shqiptare është në nivele mjaft të ultra veçanërisht krahasuar me ato evropiane. Ndërkohë që kjo problematikë është më e theksuar në universitetet që operojnë jashtë Tiranës dhe në shumicën e IAL-ve private. Për pasojë, IAL-të shqiptare sot, kanë një fizionomi kryesisht mësimdhënëse dhe fare pak kërkimore.

3.3.18. Institucionet Shqiptare të Arsimit të Lartë kanë një dukshmëri dhe dimension shumë të kufizuar ndërkombëtar dhe evropian, janë të mbyllura, thuajse tërësisht domestike. Kjo dëshmohet përmes përfshirjes në nivel të pakënaqshëm në bashkëpunime ndërinstitucionale me impakt afatgjatë dhe vizibilitet, përmes numrit të limituar të programeve të studimit zyrtare të përbashkëta. Kemi shumë pak shkëmbime

studentësh, ndërkohë që mobilitete jo të pakta të stafeve, kanë pak efekt në zhvillimin në planin institucional e programor, dhe efektiviteti i tyre është shumë i ulët në raport me fondet e përfituara e të shpenzuara. Paradoksi qëndron që ka diploma të përbashkëta, që ofrohen mbi marrëveshje zyrtare të njohura në BE që i ofrojnë vetëm pak universitete private, praktikisht më cilësoret e sistemit. Mobiliteti tepër i ulët i studentëve është një nga treguesit më domethënës të një përgjegjësie të pa ushtruar në shërbim të tyre. Kjo mbyllje e institucioneve tona shprehet edhe në mungesën e bashkëpunimit midis vetë institucioneve shqiptare në fushat e përafërta, ku nuk zhvillohen e zbatohen projekte kërkimi të integruara, ndërdisiplinore, ndërinstitucionale, duke i shndërruar ato në entitete të mbyllura, madje dhe brenda qytetit apo rajonit ku operojnë. Një tjetër dimension i mos hapjes janë marrëdhëniet e dobëta gati të munguara me komunitetin, tregun e punës, organizatat profesionale dhe palë të tjera, direkt apo indirekt të interesuara.

3.3.19. Sistemi i Brendshëm dhe i Jashtëm i Sigurimit të Cilësisë është karakterizuar nga probleme dhe vështirësi që lidhen së pari me shkallën e njohjes dhe interesimit të vetë IAL-ve për cilësinë e brendshme. Ky proces nuk u ndihmua edhe prej ndryshimeve të vazhdueshme ligjore, kritereve e standardeve (shpesh herë evazive, të paqarta e vështirësisht të lexueshme) që kërkonin adoptime të shpeshta të IAL-ve dhe vetë institucioneve të sigurimit të cilësisë jashtë tyre. Këtyre faktorëve u shtohet dhe mos ndarja e qartë dhe konfuzë e fushës së veprimtarisë dhe kompetencave në sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë midis vetë IAL-ve, institucioneve të sistemit të cilësisë dhe akreditimit dhe atyre vendimmarrëse në sistem, si MASH dhe KM.

## Pjesa II – Ndryshimet e rekomanduara

### Kapitulli 4

#### ORGANIZIMI I ARSIMIT TË LARTË

4.1 Organizimi aktual i Arsimit të Lartë në Shqipëri Arsimi i Lartë në Shqipëri ofrohet dhe zhvillohet në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) Publikë dhe Jo publikë, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligjin e arsimit të lartë. Në grupimin e parë bëjnë pjesë IAL me financim të drejtpërdrejtë nga fondet publike, ndërsa në grupimin e dytë bëjnë pjesë dy tipa të IAL-ve: jofitimprurës dhe fitimprurës, të cilët nuk përfitojnë financim nga fondet publike,. Të gjithë IAL-të e mësipërme menaxhohen dhe funksionojnë mbi bazën e ligjit të arsimit të lartë dhe atij për ndërmarrjet private e fondacionet në Shqipëri. Mënyra se si organizohen IAL-të në Shqipëri detajohet në Kapitullin e 5-të. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) është institucioni, që në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, është përgjegjëse për realizimin e programit politik- qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standardeve në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Ajo kontrollon zbatimin e ligjshmërisë dhe përdorimin e fondeve publike në institucionet publike të arsimit të lartë, si dhe zbatimin e ligjshmërisë në institucionet private të arsimit të lartë.

Në përputhje me kornizën ligjore në fuqi institucionet qendrore publike, të cilat merren me mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e arsimit të lartë janë:

- Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, njësi përbërëse e MAS;
- Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), agjenci varësie e MAS, dhe Këshilli i Akreditimit (KA), organ kolegjal, që kryen veprimtarinë e vet, pranë APAAL;
- Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), agjenci varësie e MAS;
- Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH), organ këshillimor i MAS dhe i Këshillit të Ministrave për politikën e zhvillimit në arsimin e lartë dhe në shkencë;
- Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA), organ kolegjal i kryesuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.

Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës pranë MAS, është njësi bazë që harton strategjitë dhe politikat për zhvillimin e arsimit të lartë me objektiva specifike, të realizueshëm, të matshëm dhe strategjikë, për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulave dhe të cilësisë së tyre, në bazë të legjislacionit dhe standardeve në fuqi, si dhe në përputhje me Procesin e Bolonjës.

Hartimi i planeve të monitorimit për zbatimin e kurrikulave dhe vlerësimin e cilësisë së tyre, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në vend, zhvillimi dhe përsosja e vazhdueshme legjislacionit për shkencën drejt modeleve bashkëkohore të organizimit, bashkëpunimit nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare e ndërkombëtare, me synim final integrimin në Hapësirën e Kërkimit Shkencor Evropian.

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) është agjencia e ngarkuar me vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin institucional dhe të programeve të studimit të reja dhe ekzistuese, si dhe përmes mekanizmave të tjerë me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, të programeve të studimit të të gjitha cikleve dhe llojeve dhe të Institucioneve të Arsimit të Lartë në vend. Pranë APAAL funksionon Këshilli i Akreditimit, i cili, në bazë të vlerësimit dhe rezultateve të tij, i sugjeron Ministrisë vendimin e hapjes së programeve të reja ose akreditimin e programeve apo institucioneve ekzistuese. Vendimi më pas merret nën përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Në procesin e vlerësimit angazhohen edhe ekspertë të jashtëm dhe të huaj sipas fushave akademike. APAAL ka si mision dhe objektiv kryesor vlerësimin e cilësisë në arsimin e lartë në bashkëpunim me Ministrinë dhe krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë në bashkëpunim edhe me vetë Institucionet e Arsimit të Lartë në vend.

Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), është një institucion i posaçëm që ka një funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe organizimit të Provimeve të Maturës dhe të Shtetit. Ka disa drejtori në varësi.

Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH) është organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe i Këshillit të Ministrave për politikat e zhvillimit në arsimin e lartë dhe shkencë. Ky organ ka një varësi të dyfishtë sipas legjislacionit ekzistues.

KALSH-i ka për mision të japë mendime e propozime për:

- strategjitë e zhvillimit të arsimit të lartë si në lëmin e mësimdhënies, ashtu edhe në atë të veprimtarisë kërkimore- shkencore;
- drejtimet kryesore të zhvillimit të arsimit të lartë;
- projektbuxhetin e parashikuar për arsimin e lartë dhe shkencën dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;
- standardet për vlerësimin dhe akreditimin e IAL-ve dhe të programeve të studimeve;
- kriteret për dhënien e titujve dhe gradave shkencore, së bashku me Komisionin e Vlerësimit të Titujve Akademikë;
- çështje të tjera të veçanta, të kërkuara nga Ministri i Arsimit dhe Sportit

Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA). Ky organ kolegjal, ka këto detyra kryesore:

- të vlerësojë propozimet e IAL-ve dhe të marrë vendim për dhënien e titullit akademik “Profesor”;
- të kryejë njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të gradave shkencore ose titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, sipas procedurave, të përcaktuara me udhëzim të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- të përcaktojë kriteret e dhënies së titujve akademikë dhe gradave shkencore në bashkëpunim me KALSH-in; t’i rekomandojë institucioneve të arsimit të lartë organizimin e studimeve të doktoratës dhe promovimin për titujt akademikë;
- të vlerësojë, me kërkesë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, zbatimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor nga institucionet e arsimit të lartë dhe, kur vëren shkelje të kuadrit ligjor dhe nënligjor, propozon masat përkatëse;
- të dërgojë përfaqësuesit e vet, për të mbikëqyrur procedurat për mbrojtjen e doktoratave, si dhe për shqyrtimin e titujve akademikë, të cilat zhvillohen nga institucionet e arsimit të lartë në mbledhjet (seancat) e hapura.

Konferenca e Rektorëve, është organ kolegjal i pavarur i autoriteteve drejtuese të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë. Kryen veprimtari të koordinimit dhe zhvillimit të arsimit të

lartë dhe kërkimit shkencor dhe shpreh opinione për probleme të zhvillimit të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe për rastet të tjera të parashikuara në ligj.

## 4.2 Problematika

4.2.1. Nga një analizë e thellë dhe e detajuar e funksionimit, drejtimit, organizimit dhe akreditimit të IAL, si dhe nga vlerësimet e bëra në vite nga institucionet vendase dhe të huaja rezultojnë se sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri paraqet një sërë problematikash komplekse dhe nuk i përgjigjet nevojave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit, si për sa i përket aspekteve të mësimdhënies, ashtu edhe atyre të punës kërkimore - shkencore.

4.2.2. Perceptimi i opinionit publik për sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri është ai i një sistemi problematik në disa aspekte, duke nisur nga korrupsioni në nivele të ndryshme tek paaftësia e sistemit për “të prodhuar” profesionistë që i përgjigjen kërkesave të kohës dhe tregut të punës.

4.2.3. Nga një analizë e situatës rezultojnë problematika të mprehta në të gjitha nivelet, nga ato qendrore të menaxhimit dhe drejtimit të arsimit të lartë, ato të menaxhimit dhe drejtimit të IAL-ve, deri tek mësimdhënia apo pranimet e studentëve dhe respektimi i kërkesave të tregut për profesionistë të fushave të ndryshme.

4.2.4. Mungon ndërthurja në të gjitha nivelet e mësimdhënies me punën kërkimore-shkencore. Vetë ekzistenca e dy ligjeve të ndara për Arsimin e Lartë dhe për Shkencën shpreh qartë këtë koncept, i cili shtrihet më pas në të gjithë organizimin e Arsimit të Lartë në vend, duke munguar integrimi i mësimdhënies me punën kërkimore-shkencore që në nivelet bazë deri tek individi. Madje edhe vlerësimi i tyre, si edhe i vetë IAL nuk kryhet mbi këto dy shtylla të zhvillimit bashkëkohor të arsimit të lartë.

4.2.5. Pavarësisht problematikave që paraqet në një pjesë të tij, ligji aktual i arsimit të lartë në shumë hallka të sistemit shpesh nuk zbatohet. Kjo ndodh për arsye të ndryshme që shkojnë nga faktori njerëzor, deri tek mungesa e mekanizmave të vlerësimit dhe kontrollit në çdo hallkë të sistemit. Raportimet vjetore nga ana e IAL-ve nuk janë transparente dhe nuk bëjnë një analizë reale të gjendjes së institucionit në çdo nivel të tij. Përgjithësisht mungojnë analizat sistematike të cilësisë së mësimdhënies apo punës shkencore nga ana e organizmave drejtuese. Llogaridhënia është në nivel minimal, për të mos e kualifikuar jo ekzistuese.

4.2.6. Sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri është jo fleksibël dhe nuk lejon shumëllojshmëri të institucioneve. Një shembull i saj është mungesa e profilizimit të universiteteve rajonale sipas nevojave të tregut dhe transformimi i tyre në miniatura të universiteteve publike qendrore.

4.2.7. Një mangësi e madhe e sistemit të deritanishëm është edhe fakti që centralizimi i vendimmarrjes është shumë i theksuar dhe vertikal. Kjo fillon që në mungesën e pavarësisë së agjencive dhe këshillave kombëtare (të përmendura me sipër) për të marrë vendime të pavarura, e deri tek mungesa e pavarësisë së institucioneve.

4.2.8. Një tjetër problem i sistemit është edhe ndërhyrja në ligj me vendime të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit, të cilat jo vetëm që nuk e kanë ndihmuar zhvillimin e arsimit të lartë, por shpesh e kanë bërë të pamundur, zbatimin korrekt të ligjit ekzistues.

### 4.3 Sugjerimet

4.3.1. Për të mundësuar zgjidhjen e problematikave të sipërpërmendura propozohet një strukturë e re organizative për institucionet e arsimit të lartë, e cila do të rriste efikasitetin dhe pavarësinë institucionale të IAL-ve. Në sugjerimet e mëposhtme janë mbajtur parasysh disa parime të rëndësishme të menaxhimit si dhe disa nga përvojat më të mira ndërkombëtare.

4.3.2. Disa nga elementët dhe parimet kryesore ku janë bazuar sugjerimet për strukturën e re të IAL-ve janë:

- vendosja e konkurrencës në themel të financimit dhe menaxhimit të arsimit të lartë;
- eliminimi i burokracisë dhe krijimi i institucioneve të pavarura
- krijimi i mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies në mënyrë që të rritet cilësia dhe përgjegjshmëria.

4.3.3. Propozimet e bëra mbajnë parasysh uljen e kostos së kalimit nga skema e vjetër tek e reja, duke transformuar disa nga institucionet ekzistuese, por edhe duke krijuar institucione të reja dhe të pavarura.

AKF – Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë.

4.3.4. Ky është një institucion i ri i pavarur në ushtrimin e veprimtarisë së tij. Ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve publike sipas politikave të çdo qeverie.

4.3.5. Ky institucion i drejtuar dhe organizuar nga një bord akademikësh dhe menaxherësh ka pavarësi në vendimmarrjen e tij. Anëtarët e bordit zgjidhen me konkurs publik nga propozimet e bëra nga IAL ne vend. Në përbërje të bordit midis anëtarëve të tjerë ka edhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave.

4.3.6. Qëllimi i kësaj agjencie është që të shpërndaje fondet publike në drejtim të tre kategorive të rëndësishme:

- Mësimdhënies
- Punës kërkimore - shkencore (pjesa logjistike)
- Inovacionit/zhvillimit

4.3.7. Mënyra e financimit dhe skema që ndiqet nga kjo agjenci për financimin e IAL-ve është dhënë e detajuar në kapitullin 6, të financimit të arsimit të lartë. Ajo që duhet të theksohet këtu është se për financimin e punës kërkimore - shkencore, kjo agjenci shpërndan vetëm një pjesë të fondeve, ato që jepen mbi bazën e klasifikimit shkencor të çdo individi/departamenti/IAL-je dhe për anën logjistike të punës kërkimore shkencore. Financimi kryesor i punës kërkimore-shkencore bëhet nga Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, mbi bazën e projekteve të fituara nëpërmjet aplikimit, individual apo në grup.

4.3.8. AKF është përgjegjëse, gjithashtu, për të propozuar kriteret dhe formulat mbi të cilat bëhet edhe shpërndarja e fondeve publike për arsimin e lartë.

4.3.9. Në bazën e punës së kësaj agjencie janë tri parime të rëndësishme:

- i. Konkurrenca e lirë (zgjedhje e gjerë për studentët)
- ii. Mundësi të barabarta (pa pasur parasysh të ardhurat)
- iii. Ekselencia në mësimdhënie dhe punë shkencore

4.4 AKKSh – Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor.

Kjo agjenci që ka pavarësi të theksuar, nuk është një institucion i ri, por është në fakt zëvendësimi i Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI). Ajo ka pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë së saj, si edhe AKF-ja. Bordi është organi më i lartë vendimmarrës dhe ka në përbërjen e tij, përveç anëtarëve të zgjedhur, dhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave.

4.4.1. Ndër përgjegjësitë e kësaj agjencie është dhe identifikimi i fushave prioritare në kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin.

4.4.2. Agjencia i bën propozime MAS-it për promovimin e karrierës akademike e kërkimore, si dhe kontrollon zbatimin e këtyre kriterëve me anë të mekanizmave të saj të brendshme, si për shembull elementët e plagjiaturës, vlerën e botimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor, të akademikëve e të tjera.

4.4.3. AKKSH ka përgjegjësi direkte për organizimin, vlerësimin dhe listimin e punës kërkimore shkencore të IAL për çdo departament. Ky ushtrim që është shumë i rëndësishëm për shpërndarjen e investimeve për punë kërkimore-shkencore nga AKF-ja bëhet në mënyrë të rregullt çdo 4 vjet, ku çdo akademik duhet të paraqesë disa nga punimet e tij shkencore. Vlerësimi bëhet mbi bazën e departamentit, dhe mbi të bëhet rankimi i IAL-së. Pasi bën këtë vlerësim ia komunikon AKF-së vlerësimin dhe listimin 4 vjeçar të IAL-së, mbi bazën e kësaj pune kërkimore shkencore.

4.4.4. Sidoqoftë qëllimi kryesor i kësaj agjencie është që nëpërmjet instrumenteve të saj, të shpërndajë fondet e punës kërkimore - shkencore mbi bazë aplikimi. Fondet shpërndahen mbi katër fusha të gjera studimi:

- i. shkencat sociale
- ii. shkencat e sakta, inxhinieritë dhe teknologjia e informacionit
- iii. mjekësia dhe shkencat e lidhura me të
- iv. artet dhe sporti

4.4.5. Kjo agjenci shpërndan edhe fondet për studimet e doktoratës (për supervizim dhe tarifa). Deri me sot kjo është bërë nga IAL-të. Kjo nuk do të thotë që IAL nuk mund të japin fonde për studime të nivelit të doktoratës (të përfituara nga "Grant"-i i AKF), por është një mundësi shtesë për mbështetjen financiare të tyre.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë - ASCAL

4.4.6. Agjencia aktuale e Sigurimit të Cilësisë APAAL, nën një emërtim të rishikuar Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë – ASCAL, duhet të zgjerojë fushën e saj të veprimtarisë dhe kompetencave me mekanizma të rinj, dhe më efektiv, veçanërisht në kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së mësimdhënies në IAL në Shqipëri.

4.4.7. Kjo agjenci duhet të ketë një status më të qartë në kuadrin e administratës civile, me mision dhe një fushë veprimtarie të përcaktuar pa ekuivok, të mirëvendosur në kuadrin e aktorëve dhe organizmave të tjerë që garantojnë cilësinë, me një pavarësi të shtuar si në planin operativ, financiar ashtu dhe vendimmarrës. Kjo agjenci mund të vetëfinancohet në të ardhmen dhe të ketë pavarësi të plotë, sikurse edhe agjencitë e tjera. Mbi këto parime, procesi i vlerësimit të cilësisë në kuptimin e gjerë dhe gjithëpërfshirës duhet të përfshijë mekanizma e instrumente të tjerë në përmbajtje. Rezultatet e vlerësimit nuk duhet të ndikohet nga asnjë palë jashtë procesit teknik dhe në përmbajtje të vlerësimit, duke u shoqëruar me hartimin e kriterëve dhe standardeve të qarta e lehtësisht të lexueshme e zbatueshme në vlerësim dhe vendimmarrjen e akreditimit.

4.4.8. Në kuadrin e ASCAL ngrihet dhe funksionon Këshilli (Bordi) i Akreditimit, i cili, në koherencë me rezultatet e vlerësimit, merr vendimin përfundimtar në lidhje me akreditimin e programeve dhe institucioneve të arsimit të lartë, si të reja ashtu dhe atyre ekzistuese, në mënyrë periodike dhe ç'ka është më e rëndësishme, në mënyrë të pavarur nga MAS. Kjo agjenci është përgjegjëse për akreditimin e IAL-ve në Shqipëri, si në funksionet e mëparshme. Sugjerojmë të quhet Bordi i Akreditimit, sepse nuk këshillon, por merr vendime për akreditim. Gjëja që ndryshon do të jenë kriteret e akreditimit, për të cilat Komisioni mendon se duhet të forcohen në drejtim të cilësisë së mësimdhënies dhe në aspekte të tjera, sipas rekomandimeve dhe në zbatim të politikave e udhëzimeve të Bashkimit Evropian për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, në përputhje me objektivat e procesit të Bolonjës. Proces i vlerësimit dhe akreditimit duhet të parashikojë angazhimin e përhershëm dhe në mënyrë të qenësishme të ekspertizës së huaj në vlerësim edhe në Bordin e Akreditimit, në një masë domethënëse për vendimmarrjen.

4.4.9. Sistemi i Sigurimit të Cilësisë duhet të sanksionojë qartë se operon në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me ekspertizë të huaj dhe agjenci homologe jashtë vendit pjesë të ENQA.

4.5.0. Përveç vlerësimit të parë dhe periodik, ASCAL duhet të ketë detyra dhe përgjegjësi të shtuara në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, si një nga shtyllat kryesore të cilësisë e lidhur direkt me studentin, dhe monitorimin e saj të vazhdueshëm në institucionet e arsimit të lartë në



Shqipëri. Po në këtë linjë, Institucionet e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë duhet të fillojnë procesin e vlerësimit të mësimdhënies, bazuar në rezultatet në dalje (outcome oriented) dhe të mësimnxënies mbështetur në learning outcomes, e për pasojë dhe vlerësimin e cilësisë së diplomave mbi këtë bazë. Ato duhet të rrisin, gjithashtu dukshmërinë publike, transparencën dhe të sigurojnë informimin për orientimin e studentëve në mënyrë që t'i ndihmojë për përzgjedhjen e studimeve të tyre të ardhshme.

4.5.1. Si pjesë e vlerësimit të mësimdhënies, kjo agjenci duhet të bëjë edhe vlerësimin e programeve të mësimdhënies (curriculae) dhe të diplomave të lëshuara nga çdo IAL. Pasi bën këto vlerësime, agjencia duhet të hartojë raportet e vlerësimit për secilin IAL. Raportet duhen të publikohen dhe të jenë transparente për të gjithë publikun, e në veçanti për studentët e ardhshëm, në mënyrë që t'i ndihmojë ata për përzgjedhjen e studimeve të tyre të ardhshme.

4.5.2. Një tjetër detyrë e rëndësishme e kësaj agjencie është të hartojë direktivat ("guidelines") për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të propozojë një dokument të rëndësishëm - Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë në Shqipëri, i cili dërgohet në MAS dhe miratohet me VKM.

4.5.3. Puna e kësaj agjencie mbështetet në komisionet e zgjedhura dhe të pavarura që bëjnë këto vlerësime, në të cilët përfshihen akademikë nga të gjitha IAL-të, njerëz nga shoqëria civile dhe studentë.

4.5.4. Një tjetër detyrim i kësaj agjencie është të organizojë vrojtimet tre vjeçare të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si dhe t'i bëjë ato publike në kuadër të transparencës dhe informimit të publikut.

#### **AKAU – Agjencia Kombëtare e Aplikimit Universitar.**

4.5.5. Ky institucion është një ide e re në kushtet e Shqipërisë, por me rëndësi shumë të madhe, pasi duhet të reformojë hyrjen në arsimin e lartë, duke përmirësuar standardin e rekrutimit të studentëve. Kjo agjenci bashkon kompetencat aktuale të RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar) dhe AKP për pjesën e arsimit të lartë.

4.5.6. Është agjenci vartësie e MAS-it .

4.5.7. AKAU do të ketë katër funksione kryesore:

- Organizimin e aplikimit studentor
- Matrikullimin
- Provimin e shtetit
- Menaxhimin e database-ve universitar dhe studentor.

4.5.8. Detyra kryesore e kësaj agjencie është organizimi i aplikimit universitar për çdo kandidat dhe çdo institucion, qoftë ky publik apo privat. Çdo kandidat duhet të dërgojë formën e aplikimit, nëntë (9) muaj përpara se të mbarojë shkollën e mesme, ku të ketë përcaktuar tri zgjedhjet e tij/saj.

4.5.9. Niveli minimal i pikëve që duhet të fitojë kandidati përcaktohen me VKM, ndërsa çdo IAL harton kriteret shtesë.

4.6.0. Agjencia kryen edhe kontrollin e të dhënave të deklaruara, si dhe të procedurave të ndjekura nga aplikantët. Ajo u komunikon IAL-ve emrat e kandidatëve fitues sipas programit të studimit.

4.6.1. Procedurat e ndjekura nga kjo agjenci, për pranimet në IAL, funksionojnë mbi bazën e parimeve të barazisë, konkurrencës së lirë dhe të së drejtës së zgjedhjes së çdo individi që dëshiron të studiojë.

4.6.2. Agjencia ka për detyrë, gjithashtu, të krijojë një databazë të dhënash, të plotë për çdo IAL, për programet e studimit dhe diplomat/certifikatat që lëshohen; të vërë në dispozicion të publikut informacionet e nevojshme për të bërë transparencën lidhur me procedurat e ndjekura për pranimet, diplomimet, etj.


4.6.3. Kjo agjenci është përgjegjëse edhe për krijimin e një baze të dhënash kombëtare të të diplomuarve dhe studentëve që po ndjekin universitetet publike dhe private. Agjencia i krijon akses online IAL-ve, për të hedhur të gjitha të dhënat e studenteve dhe karrierës së tyre shkollë, duke i ofruar IAL-ve mundësinë e printimit të certifikatave të notave në çdo moment, etj.

4.6.4. Universitetet, të detyruara nga ligji, duhet të mbajnë të përditësuar bazën e të dhënave, e krijuar me të dhënat e kandidatëve dhe karrierës së tyre akademike, përfshi dhe të dhënat për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie në IAL-në përkatëse.

4.6.5. Kjo siguron vërtetësinë e të dhënave duke eliminuar një nga problematikat më të spikatura sot, atë të dhënies së diplomave të pamertuara dhe falsifikimit të notave. Gjithashtu, sigurohet një vështrim i përgjithshëm në çdo moment i studentëve dhe pedagogëve, duke mundësuar kështu edhe monitorimin e standardeve akademike të mësimdhënies, për sa i përket raporteve pedagog/student, nivelit të pedagogëve, respektimit të strukturës së programit të studimit, etj. Veç kësaj, monitorohet pjesëmarrja në projekte dhe në kërkimin shkencor të stafit, duke i ofruar AKKSH një bazë të dhënash për vlerësimin e kërkimit shkencor dhe financimit të tij.

4.6.6. Ky raport nuk analizon të gjitha organet këshilluese apo vendimmarrëse në arsimit e lartë në Shqipëri dhe fakti që nuk janë përmendur nuk do të thotë që do të pushojnë së ekzistuari ose që nuk duhet t'i nënshtrohen një analize të plotë në një fazë të dytë<sup>4</sup>.

**Figura 4.1.** Skema Institucionale e propozuar për organizimin e Arsimit të Lartë në Shqipëri



<sup>4</sup>Organizmat e tjerë institucional nën varësi të MAS do të shihen në një fazë të dytë të punës së Komisionit për Reformën në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.

# Organizimi dhe funksionimi i institucioneve të arsimit të lartë

## Kapitulli 5

### ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

#### 5.1. Organizimi aktual i Universiteteve

Një ndër problemet më të mëdha në hallkat e arsimit të lartë në Shqipëri është organizimi i brendshëm problematik i institucioneve të arsimit të lartë. Problemet e konstatuara në këtë sistem janë te natyrave të ndryshme nga moszbatimi i ligjit; i natyrës së shkëlqeve njerëzore; dhe me e rëndësishmja i mënyrës mos funksionale të vendimmarrjes dhe mos ndarjes së funksioneve. Rekomandimet e këtij komisioni do të fokusohen kryesisht në çështjen e parë dhe të tretë të përmendura më sipër. Problemet e shumta në këtë sistem hierarkik janë konstatuar edhe nga studime të mëparshme dhe janë adresuar edhe nga politika qeverisëse të mëparshme. Tendencat ka qenë e tillë që këto politika, të paktën në letër, predikojnë pavarësinë/autonominë institucionale të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri. Po kështu edhe studimet e ndryshme nga organizmat ndërkombëtarë dhe kombëtarë kanë detajuar një problematikë të madhe në mënyrën se si organizohen institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe veçanërisht në vendimmarrjen e centralizuar të tyre. Për qëllime të transparencës shkencore në këtë analizë dhe rekomandimet që do jepen, janë marrë parasysh vetëm organizimi i institucioneve publike dhe jo publike, të cilat rregullohen me ligj.

Përpara se të analizojmë problemet që kanë dalë nga mënyra aktuale e organizimit të brendshëm është e rëndësishme të detajojmë mënyrën se si janë organizuar strukturalisht këto institucione. Ky seksion ndiqet nga analiza e problematikës dhe përfundon me sugjerimet dhe ndryshimet e rekomanduara nga Komisioni.

5.2. Organizimi strukturor dhe vendimmarrja në IAL  
Në bazë të ligjit ekzistues institucionet e arsimit të lartë kanë në letër autonomi dhe liri të theksuar akademike. Universitetet vetëqeverisjen më anë të statuteve dhe rregulloreve të hartuara nga ta, por në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Këto institucione organizojnë strukturat e tyre të brendshme dhe po kështu kanë një pavarësi në hartimin e programeve të studimit dhe ato të punës kërkimore shkencore. Përcaktojnë kriteret e tyre të pranimit në programet e studimit. Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, IAL-të janë gjithashtu të pavarura të hyjnë në marrëdhënie me qeverinë dhe hallkat e saj; me institucione si motra dhe me shoqëri biznesi për realizimin e qëllimeve të tyre, që parashikohen nga ligji – mësimdhënia dhe puna shkencore.

Hapja, mbyllja apo edhe bashkimi i IAL-ve bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Mënyra e organizimit të IAL-ve  
IAL-ja është e organizuar në këto njësi përbërëse organizative:

- o Njësi kryesore (fakultetet, institutet e kërkimit dhe zhvillimit, kolegjet profesionale dhe filialet),
- o Njësi bazë (departamentet dhe qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit)
- o Njësi ndihmëse (labororët, stacionet eksperimentale, njësitë didaktike, bibliotekat dhe njësi të tjera, që realizojnë studime, projektme dhe shërbime).

IAL-ja drejtohet nga organe vendimmarrëse kolegjiale si Senati, Këshilli i Administrimit, Këshilli i Fakultetit dhe autoritete drejtuese ekzekutive si Rektori, Dekani, Shefi i Departamentit. Anëtarët e senatit dhe të Këshillit të Fakultetit zgjidhen nga i gjithë stafi. Në këto organe stafi jo akademik dhe studentët përfaqësohen respektivisht me 5 dhe 15%. Po ashtu dhe autoritetet drejtuese zgjidhen nga i gjithë stafi përkatës, ku votat e stafit jo akademik dhe studentëve vlejnë respektivisht 5 dhe 20% të totalit të votave. Në rastet e qendrave ndëruniversitare, autoritetet drejtuese përzgjidhen me konkurs të hapur. Senati kryesohet nga rektori ndërsa këshilli i fakultetit nga dekani. Këshilli i Administrimit përbëhet nga: përfaqësues me të paktën gradë shkencore të zgjedhur nga stafi akademik, 1 përfaqësues nga studentët dhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Këshilli i Administrimit kryesohet nga Kryetari që zgjidhet nga anëtarët e tij me dy të tretat e votave. Ai ka si objekt të tij mbikëqyrjen e kontrollonin



e veprimtarive të Universitetit që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij. Organet dhe autoritetet drejtuese në IAL zgjidhen për një mandat 4 vjeçar dhe nuk mund të rizgjidhen për më shumë se dy mandate radhazi në të njëjtin funksion.

Këshilli i Profesorëve mund të ngrihet në çdo fakultet dhe ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e studimeve të doktoratës dhe të kualifikimit shkencor e pedagogjik pas doktoratës. Përbërja, detyrat dhe funksionimi i Këshillit të Profesorëve përcaktohen në rregulloren e këtij këshilli. Drejtuesi më i lartë i një institucioni të arsimit të lartë është rektori, i cili është autoriteti drejtues dhe përfaqësues i këtij institucioni. Emërimi i rektorit të zgjedhur/drejtorit të qendrës ndëruniversitare nuk është kompetencë e Ministrit, por e Presidentit të vendit. Shkarkimi propozohet nga Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe aprovohet nga Presidenti. Emërimi i dekanit të zgjedhur bëhet nga rektori por shkarkimi i tij bëhet nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me propozim të rektorit të IAL-së. Kancelari i Institucionit, është përgjegjës për drejtimin e përditshëm të institucionit, për zbatimin e buxhetit, për kontrollin dhe aplikimin e veprimtarisë financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë. Kandidatura e kancelarit përzgjidhet nga KADM-i dhe i paraqitet për miratim ministrit nga rektori. Në IAL janë parashikuar dhe autoritete të tjera drejtuese si zv/rektorët, zv/dekanët dhe kancelarët e njësive kryesore Ky është një përshkrim i shkurtër i organeve dhe autoriteteve drejtuese dhe menaxhuese të IAL-ve.

### 5.3. Problematika

5.3.1. Një nga problemet kryesore të hasura në menaxhimin e IAL-ve në Shqipëri është fakti se struktura akademike dhe ajo menaxheriale nuk janë të ndara në vendimmarrjen e tyre. Përgjegjësia institucionale e rektorit dhe organizmave të tjera drejtuese është jo vetëm për anën akademike por edhe për anën financiare dhe menaxheriale të sistemit. Kjo ka krijuar, në radhë të parë, mungesë efikasiteti në drejtimin e institucionit, mundësi për keqpërdorim financiar të fondeve të institucionit si dhe një mungesë zhvillimi të universitetit. Plotfuqishmëria e drejtuesve të lartë sjell arrogancë në drejtim, suprimim të të gjitha të drejtave dhe vendimmarrjes në njësinë bazë (departamentin) dhe presionin mbi vendimmarrjen në nivele të ndryshme si administrative, ashtu dhe akademike si Senatet, Këshillat e Fakulteteve dhe Këshillat e Profesorëve.

5.3.2. Përveç ndarjes së funksioneve dhe detyrave që mungojnë midis anës menaxheriale dhe akademike, institucionet e arsimit të lartë dallohen edhe nga një centralizim vendimmarrjeje në të gjitha nivelet. Në mënyrë të qartë në vend që të drejtojë organizmi, drejton individi. Midis të tjerave kjo vjen edhe sepse drejtuesit ndikojnë në forma të ndryshme edhe për zgjedhjet në këto organizma.

5.3.3. Një tjetër problem që është hasur në institucionet e arsimit të lartë është mënyra dhe formula e zgjedhjeve në këto institucione. Zgjedhjet përfshijnë jo vetëm stafin akademik, por edhe atë jo akademik, si dhe stafin studentor, mbi bazën e një përqindjeje të caktuar. Kjo mënyrë zgjedhjeje si një politike populiste, që kënaqen të gjithë në shkelje të meritës dhe standardeve akademike, nuk ka në bazë të saj objektivitetin. Nuk mundet një grup njerëzish që nuk kanë interesa dhe njohjen e duhur akademike, të zgjedhin drejtuesin akademik të institucionit.

5.3.4. Një tjetër problem i dalë nga analiza e këtij Komisioni është fakti që drejtues të ndryshëm kanë varësi të ndryshme nga legjislativi dhe ekzekutivi. Rasti më flagrant është ai rektorit që aprovohet nga Presidenti i Republikës. Dyzimi midis organit aprovues (Presidentit) dhe atij financues (Ministrit) krijon një mundësi për mos llogaridhënie ndaj institucioneve ekzekutive; në rastin konkret Ministrit të Arsimit dhe Sportit, edhe pse nga ana tjetër garanton pavarësinë e rektorit nga organi financues, duke ndihmuar në autonominë institucionale të IAL-së.

5.3.5. Një tjetër problem i shfaqur është fakti që ndërsa është menduar dhe konkretizuar dhënia e autonomisë IAL-ve, kjo nuk është shoqëruar me mekanizmat efektivë të kontrollit nga institucioni përkatës, në këtë rast Ministria, për zbatimin e ligjit dhe përdorimin e kësaj autonomie.

5.3.6. Në kuadrin e kësaj autonomie/pavarësie nuk është shumë e qartë se kush është përgjegjës për mosfunksionimin e institucionit të arsimit të lartë. Futja e Këshillave të Administrimit është një risi, por detyrat dhe përgjegjësitë e tyre duhet të jenë më të qarta dhe më përfshirëse në drejtim të funksionimit të IAL-së.

5.3.7. Një tjetër problem i shfaqur është dhe lejimi i dy punësimit në institucione të ndryshme të arsimit të lartë. Ky dy punësim jo vetëm që u ka sjellë një mbingarkesë shumë të madhe të pedagogëve dhe një mungesë kontrolli të angazhimit të tyre akademik, por edhe ka pasur një influence negative të dyfishtë. Nga njëra anë nuk ka lejuar

pedagogun të zhvillohet individualisht për arsye të ngarkesës shumë të madhe të mësimdhënies në disa institucione, por edhe ka krijuar mungesë së kohës efektive për punë kërkimore - shkencore në IAL. Nga ana tjetër ka influencuar në mos zhvillimin e vetë institucionit pasi pedagogët nuk janë të interesuar të investojnë kohën e tyre në institucionin e arsimit të lartë ku punojnë, duke qenë se puna e tyre kërkimore, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk është lehtësisht e matshme dhe e vlerësuar, si nga ana e detyrimit që ka pedagogu si i punësuar në këtë IAL, ashtu dhe nga pikëpamja e promovimit të tij akademik, bazuar në këtë punë kërkimore shkencore. Kjo situatë ka krijuar një gjendje të ngurtë në drejtim të punës kërkimore-shkencore dhe një rënie të cilësisë së mësimdhënies.

5.3.8. Problem i hasur gjatë analizave dhe i shprehur nga një numër i madh i personelit akademik është mënyra dhe kriteret e promovimit të stafit akademik. Në radhë të parë aprovimi për titujt shkencorë vazhdon të bëhet nga një organizëm rudimentar i centralizuar pranë Ministrisë. Kjo sjell probleme të mëdha qoftë në drejtim të administrimit të procesit, por edhe në drejtim të kriterëve të promovimeve. Gjithashtu, ky proces anashkalon fakultetin/universitetin që janë edhe instrumentet e specializuara për fushat e ndryshme të kërkimit të individit dhe grupit.

5.3.9. Një tjetër mangësi e organizimit strukturor të IAL-ve është edhe mungesa e një apo disa instrumenteve për kryerjen dhe nxitjen e punës kërkimore- shkencore në çdo nivel, në departament, fakultet apo IAL. Kësaj i shtohet edhe mungesa e instituteve apo qendrave të kërkimit shkencor, brenda fakulteteve apo universiteteve që janë ose në një numër shumë të pakët ose nuk ekzistojnë në të shumtën e rasteve.

## 5.4. Sugjerimet

5.4.1. Në institucionet e arsimit të lartë duhet të ketë një ndarje të qartë dhe pa ekuivok të përgjegjësisë financiare nga ajo akademike, në dy duar të ndryshme dhe që kontrollohen në mënyrë të koordinuar. por të pavarur nga njëra- tjetra. Kështu drejtuesit akademike nuk do të kenë interesa financiare dhe organizmat akademike të universitetit nuk merren me menaxhimin financiar të tij. Për këtë është e domosdoshme që çdo IAL të ketë një sistem me dy varësi: atë akademike - senat, rektor, dekan dhe departamente; dhe atë administrative-administrator, kancelar, menaxher departamentesh për anën organizative (shih Skemën 5.1). Të dyja

këto funksione varen nga Bordi Administrativ një organ përgjegjës për gjithë mbarëvajtjen e universitetit.

5.4.2. Skema e zgjedhjeve duhet të ndryshojë në themel. Demokracia e gjerë nuk është zgjidhja e përsosur për vende që nuk kanë demokraci të stabilizuar. Por më i rëndësishëm është fakti që drejtuesit e zgjedhur të zgjidhen nga grupime që kanë njohuri të drejtpërdrejta mbi funksionin që do të ketë drejtuesi. Në rastin e senatit apo të rektorit në zgjedhje duhet të marrë pjesë vetëm stafi akademik i përhershëm i universitetit, dhe jo ai administrativ dhe studentët. Këta të fundit do të përfaqësohen me anë të anëtarëve të tyre në komitetet e ndryshme, që marrin dhe vendime ekzekutive të cilat lidhen direkt me studentin. Gjithashtu, Komisioni është i mendimit që të futet mbledhja e përbashkët semestrale e studentëve/ përfaqësuesve të tyre dhe stafit akademik për çdo program. Kjo mbledhje duhet të minutohet dhe të diskutojë të gjithë kërkesat e studentëve për atë program.

5.4.3. Në qendër të vendimmarrjes akademike është Bordi Akademik (i gjithë personeli akademik i përhershëm i institucionit). Ky organizëm është shumë i rëndësishëm së pari për mbarëvajtjen e vendimmarrjes demokratike dhe meritokratike të Institucionit të Arsimit të Lartë. Ky organizëm është përgjegjësi kryesor për vendimmarrjen strategjike të universitetit, që nga zgjedhja e anëtarëve të komiteteve për mbarëvajtjen e institucionit, deri te zgjedhja e senatit ,apo e këshillit të fakultetit. Asnjë vendim i rëndësishëm akademik nuk mund të merret jashtë këtij forumi (shih skemën 5.1)

5.4.4. Departamenti duhet të jetë zemra e zhvillimit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore të çdo institucioni të arsimit të lartë. Departamenti është përgjegjës kryesor për llojet e studimeve që organizon në të gjitha nivelet, për kurrikulat e studimeve dhe propozon numrin e programeve që duhet të organizojë, si edhe numrin e studenteve që duhet të ketë çdo program. Në rastet e programeve të përbashkëta midis departamenteve, vendimmarrja kalon në nivel fakulteti. Të dyja këto të fundit duhet të aprovohen në një Komitet që merret me organizimin e mësimdhënies dhe me zbatimin e planit strategjik të universitetit. Pas këtij aprovimi çdo program i ri, i propozuar duhet të marrë aprovimin financiar për tarifën nga administratori/ drejtuesi i Universitetit.

5.4.5. Departamenti duhet të ndërtohet në bazën e grupeve të kërkimit dhe mësimdhënies

në përputhje me fokusin dhe misionin që ai i ka vendosur vetes. Departamenti nuk mund të jetë i tillë pa program mësimor dhe kërkim-shkencor. Të dyja këto aspekte akademike të mishëruara në çdo akademik, organizohen tek niveli i departamentit. Për këtë çdo departament duhet të organizohet mbi bazën e grupeve/katedrave me interesa të njëjta kërkimore - shkencore dhe mësimdhënie.

5.4.6. Departamenti duhet të menaxhojë fondin bazë të kërkimit shkencor dhe ta ndajë atë midis anëtarëve akademike të tij. Bëhet fjalë për fondin që jepet nga AKF-ja për logjistikën dhe buxhetin individual të kërkimit shkencor.

5.4.7. Departamenti (në rastet e programeve të përbashkëta Fakulteti) duhet të përcaktojë listën e studenteve fitues për programet e tij të studimit, sipas kritereve dhe procedurave transparente. Departamenti duhet të ketë lirinë për të zhvilluar veprimtari për dhënien e shërbimeve edhe për të tretë, sipas rregullave të përcaktuara.

5.4.8. Departamenti duhet të ketë të përcaktuar edhe numrin minimal të stafit akademik, i cili përcaktohet sipas kërkesave dhe madhësisë së çdo universiteti dhe mbi bazën e rregulloreve përkatëse. Ligji duhet të përcaktojë një numër minimal të personelit permanent të çdo departamenti.

5.4.9. Departamenti ka për detyrim të zgjedhë Drejtuesin e Departamentit nga radhët e tij. Ky i fundit duhet të jetë me titullin profesor dhe profesor i asociuar dhe me një mandat të fiksuar 4 vjet. Shefi i departamentit nuk duhet të shërbejë në dy mandate të njëpasnjëshme si drejtues i departamentit. Në raste të veçanta aplikohen rregulloret e brendshme të çdo universiteti (për shembull kur numri i profesorëve është i ulët, e të tjera). Drejtuesi i departamentit propozohet nga pedagogët e departamentit.

5.4.10. Paralelisht me departamentin duhet të ngrihet edhe stafi administrues që ndihmon punën e departamentit në institucion. Një menaxher departamenti duhet të emërohet nga Administrata. Ky i fundit do të merret me nevojat administrative dhe menaxheriale të departamentit, duke lehtësuar punën e drejtuesit akademik të departamentit. Në varësinë e tij duhet të ketë një numër stafi administrativ që merret me mbarëvajtjen administrative të programeve, kurseve të mësimdhënies e të tjera. I gjithë stafi administrativ emërohet (pas konkursit të hapur) dhe ka varësi nga Kancelari/Administratori i Universitetit.

5.4.11. Organi më i lartë i IAL-së duhet të jetë Këshilli Administrativ (ose i riemëruar Bordi Administrativ). Për të rritur përgjegjësinë dhe mirëmenaxhimin e IAL-ve Publike dhe financimin publik në këto institucione propozohet krijimi i "pronësisë së qarte"<sup>5</sup> të IAL-së përmes ngritjes së Bordit Administrativ ( 5-7 veta në varësi të madhësisë së IAL, por kjo i lihet në dorë vete Institucionit) me një Administrator në krye. Pagat e tyre janë kosto e vetë IAL-ve. Anëtarët e këtij Bordi zgjidhen me votim të fshehtë të stafit akademik të IAL, mbi bazën e kandidimit dhe me konkurrimin publik në rastet e zgjedhjeve jashtë IAL-it. Ata preferohet të kenë formim dhe përvoja në fushat: financë, ekonomi, menaxhim, juridik, etj., ose specializim e përvojë në fushat kryesore të edukimit universitar. Kur nuk ka të tillë ose të interesuar brenda stafit, konkurrimi/punësimi hapet edhe jashtë institucionit. Pas zgjedhjes anëtarët e bordit punësohen me kohe të plotë në bord. Mandati i anëtarëve të Bordit ka një kohëzgjatje 1 vit më shumë se sa mandati i rektorit dhe senatit, kjo për arsye të vazhdimësisë institucionale. Ky Bord është përgjegjës për aprovimin e politikave afatmesme dhe afatgjata (5-10 vjeçare) të IAL-së. Rektori, Dekanët, Shefat e Departamenteve dhe Drejtuesit Administrative nuk mund të jene anëtarë të këtij Bordi, por marrin pjesë në këto mbledhje pa të drejtë vote.

5.4.12. Detyra kryesore e Bordit Administrativ është mbarëvajtja e shëndetshme dhe funksionimi optimal i universitetit. Anëtarët e Bordit duhet të aprovojnë strategjinë e zhvillimit të universitetit. Ata: o janë përgjegjës për garantimin e politikave të stabilitetit/rritjes institucionale në përputhje me burimet e financimit, dhe qëndrueshmërinë financiare afatmesme dhe afatgjate të IAL. o mbajnë përgjegjësi ligjore për dështimin financiar edhe të misionit të IAL. Ata janë de-fakto "pronarët/aksionarët" e IAL-ve si përfaqësues të balancuar të interesit publik dhe të punonjësve/studenteve të IAL-së.

5.4.13. Bordi ushtron monitorim/kontroll të rregullt të misionit dhe politikës financiare që zërthehet çdo vit në plane 1-vjeçare fiskale dhe akademike, të cilat propozohen dhe pas miratimit, menaxhohen nga vetë Rektorati, Dekanatet/Departamentet dhe Administrata.

5.4.14. Bordi Administrativ është përgjegjës për zgjedhjen dhe punësimin e Administratorit, Kancelarit, Shefit të Financave, Shefit të Personelit dhe çdo emërimi administrativ. Në Bord përfaqësohen, në bazë të përqindjes së financimit,

<sup>5</sup>"Pronësi" në këtë kontekst nënkupton që çdo person juridik që investon në një IAL duhet të ketë të njëjtën përfaqësi reprezentative sa edhe shuma e investuar në të. Nëqoftëse investimi i shtetit është në masën 20% të të ardhurave të këtij IAL-i, atëherë shteti duhet të ketë përfaqësues në masën 20% në këtë Bord.

të gjitha palët kontribuese (IAL – nëpërmjet zgjedhjeve/konkurrimit, Ministria – nëpërmjet emërimit, Biznesi – nëpërmjet emërimit, e të tjerë). Anëtarët e Bordit kanë procedura shkarkimi si në institucionet e pavarura. Ata balancojnë qeverisjen e IAL midis Stafit Akademik dhe Administrativ, dhe balancojnë 'rrezikun' e kontrollit absolut të Rektorit, apo Administratorit. Pavarësisht tipit të universitetit, ky Bord gjithmonë duhet të ketë në shumicë përfaqësuese personelin e votuar akademik.

5.4.15. Organi më i lartë akademik është Senati i Universitetit, i cili zgjidhet nga Bordi Akademik me votim të gjerë. Anëtarët e senatit vetë kandidohen për zgjedhje. Shërbejnë për një periudhë 5 vjeçare. Ata duhet të jenë pedagogë me titull profesor, ose profesor i asociuar.

5.4.16. Senati mbulon dhe aprovon të gjitha çështjet akademike të një universiteti. Ai zgjedh rektorin dhe ky i fundit jep llogari tek senati në mënyrë periodike.

5.4.17. Rektori zgjidhet nga Senati dhe mund të jetë nga stafi akademik i IAL-së. Anëtarët e senatit, rektori, apo zëvendës rektorët duhet të jenë pedagogë me titull profesor ose profesor i asociuar. Rektori është drejtues i senatit. Rektori nuk duhet të shërbejë në dy mandate të njëpasnjëshme në pozicionin e tij.

5.4.18. I njëjti sistem zgjedhjeje duhet të aplikohet për zgjedhjen e dekanëve që duhet të zgjidhen nga bordet akademike (këshillat e fakulteteve) të çdo fakulteti.

5.4.19. Çdo drejtues aktual dhe në vazhdim nuk mund të zgjidhet në të njëjtin post.

5.4.20. Nga ana administrative çdo universitet duhet të ketë Administratorin e tij që zgjidhet me konkurs dhe emërohet nga Bordi Administrativ. Ky administrator duhet të ketë një eksperience të gjatë në menaxhimin e një institucioni publik apo privat. Ky drejtues është përgjegjës për anën administrative dhe financiare të universitetit. Në varësi të tij janë kancelari dhe menaxherët e çdo departamenti.

5.4.21. Një risi në funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë është futja e Komiteteve me detyra specifike të caktuara. Çdo komitet ka një funksion të caktuar dhe një anëtarësi jo më shumë se shtatë vetë. Për shembull ai mund të merret me promovimin e stafit akademik; me çështjet e studenteve; një tjetër me çështjet e etikës së kërkimit shkencor; me bursat dhe aplikimin e

mundësive të barabarta e të tjera. Anëtarët e komiteteve vetë kandidohen nga stafi akademik dhe votohen nga Bordi Akademik, pra i gjithë personeli akademik permanent. Kanë mandat të kufizuar tre vjeçar. Anëtarësimi në këto komitete duhet të shihet si kontributi qytetar i çdo akademiku dhe është një obligim në fazë të ndryshme të karrierës së çdo akademiku, si i tillë është i rëndësishëm në promovimin e stafit akademik. Anëtarësimi në këto komitete ka të bëjë me kontributin e çdo stafi akademik në të ashtuquajturën "good citizenship".

5.4.22. Duhet të ndalohet dy punësimi midis institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, si një element që ka përkeqësuar të dy aspektet e jetës akademike, atë të mësimdhënies dhe atë të punës kërkimore-shkencore. Pjesëmarrja në projekte, konsulenca, botime dhe shërbime që realizohet në kuadër të institucionit nuk duhet të konsiderohet si dy punësim brenda institucionit, por duhet të njihen e vlerësohen prej këtij të fundit si një mjet për zhvillimin institucional. Në rastin e dhënies së kontributit, ky kontribut në nivelin personal duhet njohur dhe shpërblyer në bazë të punës së bërë, të kontributit personal dhe të cilësisë së rezultatit e arritjes.

5.4.23. Zgjerimi horizontal i Institucioneve të Arsimit të Lartë në parim duhet të përcaktohet nga performanca dhe kërkesa e tregut dhe jo vetëm nga investimet në infrastrukturë. Zgjerimi horizontal nuk mund të mbështetet në një numër fiks të IAL-ve. Të gjithë IAL-të Publike dhe Jo publike nuk duhet të jenë masive, qasja duhet të jetë cilësore. Mbi të gjitha financimi i programeve të reja të studimit, të departamenteve të rinj bëhet vetëm me aprovim nga AKF. Në të kundërt universiteti mbarë mbi vetvete koston e hapjes së këtyre programeve, departamenteve e të tjera.

5.4.24. Është e rëndësishme që emërimet e reja në institucionet e arsimit të lartë të bëhen mbi bazën e nevojave dhe të treguesve studentë/pedagog të çdo institucioni (deri tek niveli i departamentit). Këto emërime e kane pikënisjen tek departamenti dhe emërimi behet nga një komision "ad hoc" i emëruar nga stafi menaxherial. Si parim komisioni duhet të përbëhet nga pesë anëtarë: Kryetari i Komisionit të rekrutimit – një profesor jashtë departamentit të punësimit; dy anëtarë nga departamenti (mundësisht njëri profesor) që janë dhe më të rëndësishmit në komision; një anëtar nga një departament i ngjashëm dhe një tjetër nga një departament çfarëdo i universitetit. Emërimi duhet të ketë dy procese: një intervistë dhe një prezantim të punës kërkimore shkencore pranë departamentit. Ky i fundit jep një gjykim pranë komisionit të

rekrutimit. Pas përzgjedhjes personeli menaxherial merret me përfundimin e emërimit të individit. Kjo formulë siguron paanshmëri, zgjedhjen e kandidatit më të fortë, pjesëmarrjen e departamentit në vendimmarrje, dhe zbatimin e rregullores së Universitetit.

5.4.25. Universiteteve publike duhet t'u jepet e drejta që për një pjesë të produktit të tyre kërkimor-shkencor të funksionojnë si Sh.P.K, pra të kenë të drejtë të sigurojnë të ardhura për IAL-në e tyre nga puna kërkimore- shkencore e personelit akademik, patentat etj., ose shërbimet që mund të ofrojë institucioni. Në këtë kuadër çdo IAL mban një përqindje të projekteve (si overheads p.sh. 10%) dhe pjesa tjetër i shpërndahet personelit akademik në fjalë, të cilët mund ta marrin këtë shumë si të ardhur direkte mbi rrogën apo si "blerje" e kohës së tyre të mësimdhënies, duke punësuar një lektor part-time për të zëvendësuar mësimdhënien e tyre.

**Sugjerime - Struktura e propozuar për Institucionet e Arsimit të Lartë**

5.4.26. Duke pasur parasysh organizimin ekzistues të IAL-ve në vend, traditën ekzistuese si dhe eksperiencat më të mira ndërkombëtare, Komisioni sugjeron këto tipa të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri:

I. Universiteti – i strukturuar me të paktën 3 njësi kryesore (3 fakultete ose 2 fakultete dhe 1 Institut).


Çdo Fakultet duhet të ketë minimumi 3 njësi bazë/ Departamente (ose 2 departamente dhe 1 qendër kërkimore) dhe çdo departament duhet të ketë të paktën 7 anëtarë me kohë të plotë, midis së cilëve 3 me grada e tituj. Universitetet kanë të drejtë të organizojnë studimet në të tre Ciklet e Studimit (Cikli i parë Diplomë profesionale 1 ose 2 vjeçare (studime post sekondare, 60-120 kredite), Diplomë "Bachelor" (të paktën 3 vjet, 180 kredite), diploma "Master Shkencor" të integruara me kohëzgjatje 5-6 vjeçare dhe 300-360 kredite, Cikli i Dytë i studimeve Master Profesional 1 vjeçar 60 kredite dhe Master Shkencor 2 vjeçar 120 kredite; Cikli i Tretë Studimet e Doktoratës 3-5 vjeçare, specializime afatgjata me kohëzgjatje të paktën 2 vjeçare dhe të paktën 120 kredite dhe Master Ekzekutiv 1-2 vjeçar, 60-120 kredite.

II. Kolegji Universitar – i strukturuar me të paktën 2 Fakultete me të njëjtën strukturë.. Këto IAL ofrojnë programe studimi në Ciklin e Parë dhe Ciklin e Dytë dhe në formimin profesional .

III. Akademia – e strukturuar me 1 Fakultet me të njëjtën strukturë si ajo e Fakulteteve në përbërje të Universiteteve. Këto IAL ofrojnë programe studimi në dhe me të drejtë për organizimin e të tri Cikleve të studimit në fushën përkatëse të kompetencës.

IV. Kolegji Profesional – ofron shkollim profesional 1-2 vjeçar me të drejtën e lëshimit të një Diplome Profesionale.

**Figura 5.1.** Koncepti i ndarjes dhe balancës së pushteteve në IAL





## Kapitulli 6

### Financimi i Arsimit të Lartë

6.0.1. Premisa e parë për ndryshimin e sistemit tonë universitar, gjithnjë nën këndvështrimin e mundësive financiare që ka aktualisht ky sistem, është pamundësia e shtetit/buxhetit për të financuar dhe mbështetur arsimin e lartë në nivelet që kërkojnë standardet dhe cilësia bashkëkohore.

6.0.2. Aktualisht, buxheti i shtetit ka në dispozicion rreth 38 milion euro për të mbështetur mbi 126 000 studentë në universitetet shtetërore (kësaj shifre mund t'i shtohen edhe afërsisht 20 milion euro të tjera nga të ardhurat dytësore të siguruara nga vetë universitetet), afërsisht 460 euro për student në sektorin shtetëror. Sektori privat me rreth 34 500 studentë e ka çmimin rreth 1000-1500 euro/student ose rreth 31-35 milion euro plus, duke operuar në shifrat 900-1000 euro/student. Ndërkohë që vendet modeste të BE si Rumania dhe Bullgaria kanë kuota financimi për student rreth 2700-2900 euro/student, pa folur për vende si Britania e Madhe, Franca, etj. që janë në kuotat 10000-11500 euro/student, Zvicra 15700 euro/student, Suedia 15210 euro/student, SHBA 22000 euro/student.

6.0.3. Në Shqipëri, duke filluar nga viti 1992, me përjashtime shumë të rralla, buxheti për arsimin në përgjithësi nuk ka qenë kurrë më i lartë se 3% e PBB duke u lëkundur në intervalet 2.2-2.8% e PBB, ose 10-15% të shpenzimeve totale të buxhetit. Duhet theksuar se këto shifra janë për arsimin në përgjithësi (me të gjitha nivelet) dhe jo vetëm atë universitar. Vendet e zhvilluara perëndimore në kuadrin e OCDE e financojnë në nivelet 5 - 8% të PBB arsimin e tyre universitar, nga i cili 1 - 3% e PBB shkon direkt për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Shqipëria e ka aktualisht 0.4 – 0.6% % të PBB.

6.0.4. Premisa e dytë që kërkon reformimin e sistemit arsimor ka të bëjë me uljen e madhe të cilësisë së mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore që midis të tjerave ka ardhur si rezultat i një masivizimi të universiteteve deri në ekstremet e mundshme, duke ulur ndjeshëm cilësinë e diplomave në Shqipëri. Aktualisht Shqipëria ka rreth 161 500 studentë, numër ky (në qoftë se nuk reformohet sistemi) është me tendencë në

rritje (në 5 vitet e ardhshme ky numër mund të shkojë deri në 175-180 000 studentë), dhe 1350 programe mësimore që zhvillohen në 59 IAL të vendit (44 private – megjithëse një pjesë e tyre janë formale - dhe 15 shtetërore). Kjo rritje shkon në të kundërt me rritjen e investimit apo të standardit në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor. Pothuajse të gjitha standardet e një mësimdhënie cilësore, kërkimit shkencor real e eficient, mjediset e laboratorët, bibliotekat, librat mësimorë e botimet akademike etj., janë të mangëta, kryesisht si pasojë e mungesës së financimeve të domosdoshme. Universitetet janë shndërruar pothuajse totalisht në struktura formale mësimdhënëse.

### 6.1. Problematika

6.1.1. Forma e financimit të arsimit të lartë duhet të kthehet në një instrument, i cili i vendos universitetet në lëvizje për zhvillim të mëtejshëm dhe profilizim të tyre sipas prioriteteve të përcaktuara nga universiteti por edhe nga zhvillimi strategjik i vendit.

6.1.2. Dy janë konkluzionet që nxirren nga gjendja problematike aktuale financiare e institucioneve të arsimit të lartë në vend:

i. E para është niveli i ulët i financimit të arsimit të lartë në Shqipëri në krahasim me të gjitha vendet e Evropës, përfshi fqinjët tanë të afërt që kanë pasur një fazë të ngjashme tranzicioni;

ii. Dhe e dyta është pamundësia e shtetit për të rritur në afat të shkurtër investimin në këtë sektor shumë të rëndësishëm. Edhe me dëshirën më të mirë të çdo vendimarrjeje politike është ekonomikisht e pamundur që me prognozatat ekonomike (jo më shumë se 1-2% në dy vitet e ardhshme) të vendit të shohim një rritje më shumë se 50% të investimeve shtetërore në arsimin e lartë. Kjo rritje është jo sinjifikative për nevojat e arsimit të lartë në vend.

6.1.3. Këto dy konkluzione janë shumë të rëndësishme për të kërkuar zgjidhje të tjera të financimit jashtë mundësive të shtetit për të financuar arsimin e lartë. Vlen për t'u përmendur që pamundësia e shtetit për të financuar në masë sinjifikative arsimin e lartë nuk është thjesht një

problem “shqiptar”, as një problem i vendeve në zhvillim, por një problem edhe i vendeve më të zhvilluara.

6.1.4. Duke pasur parasysh kushtet ekonomike të vendit, si dhe duke menduar për periudhën afatshkurtër është e rëndësishme të theksohet se mundësia që shteti të rrisë investimin është e ulët qoftë edhe me dëshirën më të madhe të mundshme për ta bërë këtë. Kjo në periudhën e parë, si rezultat i ritmit të ulët të zhvillimit ekonomik të vendit, nuk lejon rritje të dëshirueshme të investimit në arsimin e lartë. Një tjetër arsye është dhe pamundësia e shtetit për të përballuar një zhvillim cilësor të arsimit të lartë, bazuar vetëm në financimin shtetëror. Këtë konkluzion e nxjerrin analizat e sistemeve të ndryshme në vendet evropiane më të zhvilluara se Shqipëria, si Franca, Gjermania dhe Italia. Pra alternativa që mbetet është rritja e investimeve nga burime të tjera.

6.1.5. Nuk mund të ketë reformë në financimin e arsimit të lartë në Shqipëri në qoftë se nuk reformohen vetë IAL-të për të rritur efikasitetin dhe pavarësinë institucionale. Këtu është shumë e rëndësishme të theksohet që rritja e investimeve paralele me ato të shtetit shkon dhe duhet të implementohet në të njëjtën kohë edhe me rritjen e autonomisë/pavarësisë së Institucioneve të Arsimit të Lartë. Në qoftë se nuk ndryshon mënyra se si IAL-të në Shqipëri drejtohen, organizohen, dhe zhvillohen për të qenë “të shëndetshme” nga ana financiare nuk mund të ketë reformë në mënyrën e financimit të tyre.

6.1.6. Në këtë këndvështrim Komisioni e sheh reformën në dy faza zhvillimi dhe realizimi të saj; në zgjidhjet afatshkurtra dhe ato afatgjata. Zgjidhjet afatshkurtra janë ato që do të shëndoshin institucionet e arsimit të lartë dhe do të përmirësojnë gjendjen e tyre në të gjitha drejtimit, mësimdhënie, kërkim shkencor, menaxhim drejt pavarësisë nga shteti si dhe rritje të mundësive financiare. Në zgjidhjet afatgjata është projektuar modeli më i mirë i financimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri bazuar në:

- i. Eksperienat më të mira ndërkombëtare
- ii. Në cilësinë e arsimit të lartë dhe maksimizimin e financimit për IAL-të në vend.
- iii. Traditën e zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri në këto 50 vitet e fundit ,për aq sa mund të mbahet dhe përmirësohet kjo traditë.

6.1.7. Kjo ndarje është marrë parasysh në sugjerimet e komisionit, veçanërisht në këtë kapitull.

7.1.8. Skema e re e financimit (në fazën e parë) duhet t'i japë frymë reale autonomisë financiare në universitetet publike, në mënyrë që ata të shëndoshen financiarisht për fazën e dytë zhvillimore.

6.1.9. Skema e re duhet të krijojë mundësinë që universitetet të marrin koston reale për të ofruar një arsim cilësor për të gjithë shoqërinë. Kjo detyrimisht nënkupton edhe rritje të tarifave vjetore që bashkë me kontributin nga buxheti i shtetit reflekton koston reale që ka ofrimi arsimit të lartë cilësor. Pa pasur parasysh këtë kosto reale të studimeve të arsimit të lartë është e pamundur të jemi serioz për reformë serioze.

## 6.2. Sugjerimet - Llojet e Financimit

6.2.1. Është e rëndësishme të përmendim që në fillim se parimet mbi të cilat duhet të mbështetet financimi i arsimit të lartë në Shqipëri janë ato të:

- i. Konkurrencës së lirë midis institucioneve. Pra institucionet janë të barabartë në aplikimin dhe shpërndarjen e fondeve.
- ii. Mundësve të barabarta. Studentet që e meritojnë por nuk kanë mundësi financimi duhet të financohen plotësisht nga shteti.
- iii. Shpërndarjes së fondeve mbi standardet e cilësisë për:
  - o mësimdhënie,
  - o kërkim-shkencor
  - o inovacionin/zhvillimin.

6.2.2. Për të përmbushur detyrimin për një arsim të lartë që të nxisë rritjen e standardit në tre aspekte kryesore të arsimit të lartë, mësimdhënie, punën kërkimore-shkencore dhe inovacionin/zhvillimin, është menduar që edhe investimi në arsim të ndahet në këto tri fusha. Shteti nëpërmjet agjencive të tij (AKKSH dhe AKF) shpërndan fondet si më poshtë:

6.2.3. GRANTI I INOVACIONIT/ZHVILLIMIT. Ky grant që është shumë i rëndësishëm në periudhën afatgjatë për vendin është i hapur për të gjithë IAL-të publike.

6.2.3.1. Qeveria në bazë të politikave të saj përcakton prioritetet për këtë grant dhe e shpërndan atë mbi bazën e aplikimit (për idetë e reja) apo të prioritetëve strategjike të zhvillimit të vendit.

6.2.3.2. Qeveria përcakton prioritetet dhe temat e

shpërndarjes së këtij granti (guidelines). Gjithashtu, qeveria përcakton edhe mënyrën e shpërndarjen dhe formën e aplikimit.

6.2.3.3. Granti nuk duhet të jetë më shumë se 10% e shumës së financimit shtetëror për universitetet publike, por kjo mund të ndryshojë në bazë të prioriteteve të çdo qeverie.

6.2.3.4. Detyra e shpërndarjes së këtij granti i takon Agjencisë Kombëtare të Financimit (AKF) mbi bazën e a) prioriteteve të qeverisë dhe b) inovacionit të universiteteve të ndryshme

#### 6.2.4. GRANTI I PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE.

Ky grant shumë i rëndësishëm për të stimuluar punën kërkimore shkencore dhe deri diku i munguar në sistem, ka dy pjesë:

i. Pjesa e logjistikës kërkimore- shkencore që shteti e financon vetëm tek universitetet publike. Shpërndarja e fondeve bëhet nga AKF mbi bazë merite/rankimi.

ii. Pjesa e punës së mirëfilltë shkencore (përfshi doktoratat), ku përfitojnë si IAL-et publike dhe ato jo-publike. Shpërndarja e fondeve bëhet nga AKKSH mbi bazë merite/aplikimi.

6.2.4.1. Pjesa e parë e grantit ajo e logjistikës bazohet mbi standardet e pedagogëve, mbi botimet e artikujve dhe librave sipas fushave/specialiteteve. Ajo varet nga madhësia e universiteteve dhe u jepet vetëm institucioneve të arsimit të lartë publik. Në këtë vlerësim është shumë i rëndësishëm faktori i impaktit të revistës, si dhe citimet e bëra për çdo botim, konferencat ndërkombëtare dhe aktivitetet e tjera shkencore të organizuara nga çdo departament. Të rëndësishme janë gjithashtu impakti që ka puna shkencore e çdo departamenti në a) Shkencë dhe b) Shoqëri (politika). Kjo bëhet me anë të raportimit të çdo departamenti dhe vlerësimeve të komisioneve përkatëse.

6.2.4.2. AKKSH bën rankimin e çdo departamenti dhe mbi rankimin e departamenteve bëhet edhe rankimi i IAL-ve. Mbi këtë rankim bazohet edhe masa e financimit për çdo institucion publik dhe shpërndarja bëhet nga AKF. Shteti ka për detyrë të listojë vetëm IAL-të publike, por në qoftë se duan mund të rankohen edhe IAL-të private.

6.2.4.3. Ky vlerësim duhet të bëhet një herë në tre - katër vjet dhe shuma e shpërndarë është një përqindje fikse për katër vitet e ardhshme. Vlerësimi bëhet vetëm për institucionet e akredituara.

6.2.4.4. Ky grant duhet të jetë në total në masën 30% të gjithë financimit shtetëror në arsimin e lartë. Sidoqoftë pjesa fikse e tij që u jepet vetëm institucioneve publike nuk duhet të jetë më shumë se 10%. Pjesa tjetër duhet të shpërndahet nga AKKSH për të gjithë IAL-et, publik dhe jo-publike në formën e aplikimit.

6.2.5. GRANTI I MESIMDHENIES. Ky grant që në fazën e parë të reformimit të arsimit të lartë jepet VETËM për universitetet publike, jepet edhe për studentin (pra llogaritet për student), por jepet si një shume totale për çdo IAL. Ky grant shpërndahet nga AKF.

6.2.5.1. Formula llogaritet mbi numrin e studenteve të një viti përpara se të pranohet në çdo IAL; mbi treguesit e rëndësishëm të raportit student/pedagog; numrin e diplomave të njohura ndërkombëtarisht; dhe logjistikën e vlerësuar të mësimdhënies.

6.2.5.2. Në këtë grant shteti duhet të ketë parasysh dy grupe të rëndësishme studentesh, ata të ekselencës, dhe ata që e kanë të pamundur financiarisht shkollimin. Në të dyja rastet shteti financon studentin.

6.2.5.3. Është e rëndësishme të theksohet se bursat e ekselencës jepen për studentin dhe ky/kjo mund t'i marrë ato si në universitetet publike apo jo-publike sipas zgjedhjes. Komisioni sugjeron që studentët e ekselencës duhet të kenë një mesatare mbi 9.5 të maturës shtetërore.

6.2.5.4. Ky grant gjithmonë është më i rëndësishmi në investimin shtetëror në arsim, dhe si detyrim ligjor i shtetit. Ai përbën 60-70% të të gjithë financimit shtetëror në arsimin e lartë në vend.

### 6.3. Sugjerimet - Burimet e financimit

6.3.1. Një nga problemet e arsimit të lartë në Shqipëri është mungesa e financimit shtetëror dhe mosnxitja e formave të tjera të financimit jashtë burimeve shtetërore. Në këtë këndvështrim komisioni sugjeron që format e financimit në të ardhmen të dizertifikohen dhe të përfshijnë:

6.3.1.1. Financimin direkt nga Shteti (në formë granti), siç u përmend edhe më lart.

6.3.1.2. Të ardhurat si aktivitet ekonomik fitimprurës. Universitetet publike duhet të krijojnë të ardhura nga produktet e tyre akademike dhe



infrastrukturore; puna shkencore; patentat; botimet; përdorimi i laboratorëve e të tjera.

6.3.1.3. Donacionet e ndryshme. Kjo formë deri më sot nuk njihet në sektorin publik dhe si e tillë duhet të rregullohet me ligj për të ardhmen.

6.3.1.4. Kontributi i Biznesit dhe Autoriteteve Lokale. Një nga problemet e arsimit të lartë tek ne është dhe mos lidhja e tij me tregun e punës. Orientimi në të ardhmen i arsimit të lartë duhet të bëhet drejt tregut të punës. Në këtë këndvështrim edhe biznesi lokal dhe qeverisja vendore mund të jenë kontribues në financimin e arsimit të lartë rajonal.

6.3.1.5. Pagesat e studenteve. Deri tani këto pagesa kanë qenë minimale dhe si të tilla nuk janë bërë një përqindje e konsiderueshme e të ardhurave të universiteteve publike. Në të ardhmen komisioni vlerëson si të pashmangshme rritjen e kontributit të këtyre tarifave në buxhetin e ILA-ve. Shteti është i detyruar të vendosë një tarifë tavan, bazuar mbi studimet e detajuara te tregut mbi bazën e mundësisë së çdo familjeje për të përballuar të ardhurat e arsimit të lartë.

#### 6.4. Sugjerimet – Financimi në fazën e parë (3-5 vjet):

6.4.1. Në këtë fazë shteti është financuesi kryesor dhe përpiqet të financojë prioritetet e tij, por edhe të “shëndoshë” sistemin për t’u përgatitur për fazën e dytë – zhvillimin afatgjatë të arsimit të lartë.

6.4.2. Në këtë fazë kërkohet një ndryshim i rëndësishëm strukturor në mënyrën e organizimit dhe financimit të arsimit të lartë, që duhet të synojë realizimin e disa qëllimeve dhe objektivave thelbësore:

6.4.2.1. Arsimi i lartë duhet të konceptohet si “shërbim publik” dhe e “mirë publike”, sektor ku shteti/qeveria garanton me politika specifike cilësi dhe standarde të larta të ofrimit të tij;

6.4.2.2. Arsimi i lartë duhet të bëhet i hapur ndaj financimeve direkte e indirekte që vijnë nga burime të ndryshme të tilla si : buxheti i shtetit, studentët, pushteti lokal, biznesi, të ardhura nga shërbime specifike, projekte zhvillimi etj.;

6.4.2.3. Autonomia/pavarësia e universiteteve duhet të zgjerohet në maksimum edhe në çështjet financiare e menaxheriale;

6.4.2.4. Universitetet duhet të përcaktojnë lirisht çmimin e realizimit të studimeve që ato ofrojnë,

numrin e pedagogëve, pagat, laboratorët, investimet thelbësore për një shërbim cilësor, etj., dhe të bëhen pjesë e tregut të lirë e konkurrues arsimor;

6.4.2.5. Shteti duhet të përcaktojë në bazë të tregut çmimin tavan të tarifave studentore për sektorin publik (mbi bazën e kostove të studimit);

6.4.3. Në këtë fazë ILA-të publike duhet të nxiten që të aplikojnë për fonde të tjera si për punën kërkimore - shkencore ,ashtu edhe për projekte ndërkombëtare. Në këtë fazë duhet t’i hapet rruga e krijimit të të ardhurave nga burime të tjera si nga puna kërkimore- shkencore e personelit akademik, ashtu edhe bashkëpunimi me sektorin privat dhe qeverisjen vendore.

6.4.4. Po në këtë fazë në mënyrë graduale dhe të studiuar duhet të afrohen pagesat e studentëve me koston e tregut. Shteti me vendim legjislativ duhet të vendos çmimin tavan për këto pagesa universitare.

6.4.5. Shteti në kuadrin e politikave publike dhe nëpërmjet objektivave të tij duhet të synojë të financojë/mbështesë :

6.4.5.1. një pjesë të studentëve, duke nënkuptuar ata me të ardhura të pakta (bursat sociale),

6.4.5.2. studentët e talentuar (bursat e ekselencës),

6.4.5.3. për degët dhe programet e studimit që klasifikohen me rëndësi kombëtare nga qeveria duhet parashikuar që mbështetja për to mund të jetë më e madhe, me fonde specifike nga buxheti.

6.4.5.4. degët pa treg për momentin por të domosdoshme për ekonominë e vendit (në përputhje me strategjitë e zhvillimit te vendit);

6.4.5.5. universitetet me cilësi specifike si p.sh. Universitetin e Arteve, Sporteve, Akademitë Ushtarake e të tjera;

6.4.5.6. universitetet rajonale në kuadrin e një specializimi më profesional/rajonal të tyre në bazë të nevojave të zhvillimit;

6.4.5.7. degët me natyrë “bachelor profesional”, programe specifike akademike, etj.

6.4.5.8. Në lidhje me ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve universitare, shteti mund të mbështesë me bursa e financime të plota/pjesëshme një pjesë

të Masterave profesionalë, dhe një pjesë specifike të doktoratave, kryesisht në ato degë e drejtime që korrespondojnë me prioritetet, objektivat strategjikë dhe politikat themelore të zhvillimit të vendit.

6.4.5.9. Skema do të parashikojë përfshirjen e skemës së kredive për studentin. Kreditet studentore duhet të jenë të hapura për të gjithë ata të cilët janë regjistruar në sistemin “Bachelor”, pavarësisht se në cilin universitet shkojnë, publik apo privat. Shteti duhet të shërbejë si garantor në banka në mënyrë që kreditë të jenë me interes zero dhe të paguhen kur studenti fillon punë.

6.4.6. Skema e re e financimit do të stimulojë dhe konkurrencën e brendshme të universiteteve. Departamentet me performancë më të lartë kërkimore- shkencore, cilësi diplome e të tjera duhet të marrin më shumë financim në krahasim me departamentet e tjera.

6.4.7. Për universitetet me status të veçantë për shkak të fushave specifike që mbulojnë duhet përcaktuar një mënyrë mbështetëse jo vetëm nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, por edhe nga ministritë e tjera të lidhura me specifikat e këtyre universiteteve për të gjeneruar të ardhura të tjera që u nevojiten universiteteve të cilët nuk mund të jenë konkurrues në treg.

6.4.8. Skematikisht financimi publik do të shkojë në tre blloqe, dhe në këtë mënyrë jo vetëm evidentohet përdorimi, por edhe ulet barra e shtetit dhe mobilizohen financime shtese nga partneriteti publik-privat (shih skemën e financimit në periudhën afatshkurtër në figurën 9.1):

6.4.8.1. Financim (thujse) i plote i IAL Shtetërore (Shkollë Profesionale, Bachelor, Master). Numrin e programeve dhe studenteve, si dhe profilet e programeve i përcakton vetë shteti për interesa publike/rajonale. Sidoqoftë ato mund edhe të mobilizojnë financa shtese.

6.4.8.2. Subvencionim i pjesshëm i IAL Publik (Shkollë Profesionale, Bachelor). Edukimi në nivel Master del në treg dhe konkurrencë te plotë publik-privat (degët me rëndësi kombëtare në IAL Publike që s’kanë treg rregullohen tek blloku i parë i financimit të shkollave shtetërore, përmes një qendre kordinimi në MAS).

6.4.8.3. Financimi i kërkimit dhe zhvillimit dhe Programet PhD bëhet përmes një fondit strategjik që jepet me garë të hapur për të gjithë IAL-të pa përjashtim (publik apo private) dhe shpërndahet nga AKKSH. Shteti mund të nxisë bashkëpunimet, që rrisin edhe më tej burimet e financimit, kapacitetet dhe cilësinë drejt qendrave të ekselencës.

## 6.5. Sugjerimet – Financimi në fazën e dytë (afatgjatë):

6.5.1. Kur diskutohet për mënyrat dhe format e financimit, sot në botë po fillon të humbasë kuptimi i ndarjes tradicionale në universitete shtetërore dhe universitete private, duke konvergjuar drejt nocionit të “universiteteve publike<sup>6</sup>”.

6.5.2. Në këtë faze nxitet konvertimi i universiteteve drejt “qendrës” në drejtim të statusit të tyre. Pra që të arrihet kalimi nga autonomi në pavarësi, universitetet publike do të kthehen në fondacione me “themelues” shtetin. Edhe universiteteve private u krijohen mundësitë në qoftë se dëshirojnë të ndryshojnë statusin në universitete jo fitimprurës, pra në fondacione, ku “themeluesi” mbetet krijuesi fillestar i universitetit.

6.5.3. Financimi në këtë rast do të jetë me i unifikuar, ku të gjithë universitetet duhet të trajtohen njëjloj në të tri format e grantit si atë të mësimdhënies, të punës kërkimore -shkencore dhe atë të inovacionit.

6.5.4. Në këtë fazë, fondet për mësimdhënie nga buxheti shtetit do të jepen vetëm për universitet me status të njëjtë. Këtu i referohemi gjykimit që në këtë fazë është parë e arsyeshme krijimi i një status të ri - UNIVERSITETIT PUBLIK, të tipit FONADACION, ku mund të futen universitetet publike, por ai le të hapur rrugën që dhe universitete jo publike t’i bashkëngjiten këtij grupimi. Kjo do t’u mundësonte këtyre universiteteve hapësira për të kërkuar financim nga buxheti shtetit për bllokun e mësimdhënies. Këtu duhet nënvizuar që universitetet të cilat i bashkëngjiten këtij grupimi (statusi) duhet të zbatojnë të njëjtat rregulla në funksionimin e tyre, si në organizim ashtu edhe për mirëqeverisje. Në rastet kur universiteti privat kërkon të marrë statusin e ri të një universiteti të tipit të Fondacionit, pronari/et heqin dorë nga pronësia dhe marrin meritën dhe statusin e themeluesit, njësoj sikurse shteti merr në rastin e transformimit të universitetit publik nga statusi i

<sup>6</sup>Ky lloj financimi dhe filozofie është mbështetur në filozofinë sunduese aktuale në reformat mbarëkombëtare të arsimit të lartë, që mbështeten në modelet anglosaksone universitare që imperativi moral i të drejtës së të gjithëve për arsim nuk duhet kushtëzuar nga instrumenti, që është çmimi i universitetit, por nga rezultati, që është cilësia e studentëve. Me një sistem universitar në ekspansion të madh dhe me kufizime buxhetore po kaq të mëdha, cilësia e universiteteve do të vihet në dyshim në qoftë se ajo mbështetet vetëm te subvencionet shtetërore, sepse duke insistuar vetëm në fondet publike që burojnë nga taksat, ne detyrojmë të paguajmë për shkollimin universitar mjaft prindër e familje që nuk do kenë kurrë dikë në universitet dhe kjo është e pa drejtë po të kemi parasysh se, formimi universitar, është mbi të gjitha një investim profesional, që të krijon oportunitete të reja në jetë.

sotëm në atë të ri. Gjithashtu, rregullat që zbatohen nga universitetet me statusin e ri janë të njëjta, pavarësisht se cili ka qenë themeluesi tyre, shteti ose privat.

6.5.5. Mbetet për t'u shënuar se ky konvertim mbase i dëshiruar dhe i testuar si rezultat i nevojave të tregut nuk u imponohet universiteteve private. Në të kundërt në qoftë se ata janë "te shëndetshëm" dhe me standarde të larta të kërkuara, mund të mbeten në statusin që kanë.

6.5.6. Në këtë fazë koncepti bazë, apo platforma kryesore për reformën synohet të jetë kalimi në një sistem të arsimit të lartë të ndarë në dy pjesë :

(1) sistem shtetëror të financuar pothuajse totalisht nga shteti dhe një pjesë të vogël modeste nga pagesat e studentëve në kuadrin e atyre që cilësohen si të ardhura dytësore, që zë gati 80% të numrit total të studentëve shqiptarë; dhe,  
 (2) sistem privat të financuar 100% nga pagesat e studentëve....

.....drejt një sistemi ku arsimit të lartë konsiderohet si "sektor dhe shërbim publik" dhe financohet në mënyrë të përbashkët nga shteti/buxheti, studentët, pushteti lokal, biznesi, donacione të ndryshme, të ardhura të tjera nga

shërbimet e universiteteve, projekte kombëtare e ndërkombëtare, etj<sup>7</sup>.

6.5.7. Edhe në këtë fazë parimet kryesore të financimit nuk do të ndryshojnë si dhe në fazën e parë:


6.5.7.1. Skema e re duhet të parashikojë përfshirjen e skemës së kredive për studentin. Sugjerohet që për kredi studentore të gjithë ata të cilët janë regjistruar në sistemin bachelor, pavarësisht në cilin universitet duhet t'u jepet e drejta për të aplikuar.

6.5.7.2. Për të aplikuar parimin universal të "mundësi të njëjta për të gjithë" dhe atë të "meritueshmërisë" kuptohet nëse plotësojnë kriteret akademike, vëmendje e veçantë u duhet kushtuar studentëve që vinë nga situata të vështira ekonomike në mënyrë që t'u jepet mundësia për të vazhduar arsimin e lartë.

6.5.7.3. Vëmendje të veçantë duhet të marri edhe ekselencia. Universiteteve, gjithashtu u duhen dhënë hapësira që të promovojnë dhe inkurajojnë studentët e vet më të mirë.

6.5.8. Universiteteve (publike të reja) u duhet lejuar mundësia që të marrin kredi për zhvillimin e tyre institucional, kjo duke plotësuar kushte të qarta, transparente dhe me miratimin e ministrive përkatëse.

Figura 6.1. Skema e Financimit të Arsimit të lartë në fazën e parë



Ekspëriencat më të spikatura botërore, kryesisht anglo-saksone në lidhje me financimin e universiteteve evidentojnë faktin se :

- financimet nga buxheti i shtetit variojnë rreth 25 -55%, nga pushteti lokal 10 -15%, nga sektori privat 8 -12%, nga institucionet e treta që kërkojnë e përfitojnë shërbime nga universitetet 15 -20%, nga të ardhurat nga studentët, vetëm 5 -8 %.
- kreditë që shteti ju jep universiteteve publike amerikane përfaqëson tashmë vetëm 15-20% të buxhetit të tyre funksional.
- është detyrë e çdo universiteti që të organizohet për të financuar pjesën tjetër, duke stimuluar kështu një shumicë strategjish dhe objektivash kërkesash në drejtimin e universiteteve dhe mbi të gjitha në ngritjen e reputacionit të tyre.

## Kapitulli 7

### MËSIMDHËNIA

#### 7.1 Cilësia e Mësimdhënies

Pas vitit 2000 me fillimin e procesit të riorganizimit të programeve të studimit në përputhje me kërkesat e procesit të Bolonjës, sistemi i vlerësimit të tyre u përshtat me këtë sfidë si në formë, ashtu edhe në përmbajtjen e kurrikulave universitare.

Vitet 2000-2003 shtruan platformën për këtë proces, ndërkohë pas këtij viti të gjitha kurrikulat e programet iu nënshtruan këtij procesi. Vlerësimi i programeve të reja të studimit për herë të parë filloi të bëhej mbi bazën e kritereve të strukturës dhe përmbajtjes, shoqëruar gjithashtu me organizimin e kurrikulave sipas moduleve e lëndëve me aktivitete formuese të disa niveleve (të përgjithshme, bazë, profesionale dhe me zgjedhje) si dhe me vlerësimin e ngarkesës së studentit me kredite ECTS. Çdo program i ri studimi, i konsideruar si i tillë edhe kur përbënte një riorganizim të një ekzistuesi, kaloi në këtë proces. Kjo ishte e vërtetë veçanërisht për Institucionet Publike të AL, ndërkohë që deri në atë kohë pak programe të IAL private ishin aktive jashtë kuadrit të Bolonjës.

Kështu të gjitha programet e reja, që sot ofrohen, janë në përputhje, të paktën në formë, strukturë dhe organizimin e përgjithshëm, me strukturën dhe ciklet e Bolonjës.

Në procesin e vlerësimit paraprak përfshiheshin Ministria e Arsimit dhe Shkencës si dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë. Gjatë këtij procesi ka pasur shpesh mbivendosje të kompetencave institucionale, madje dhe në linjën formale administrative, duke i lënë për vlerësim institucioneve të sigurimit të cilësisë pothuajse vetëm përmbajtjen e programeve. Kjo dukuri ka ndikuar në copëzimin e procesit të vlerësimit paraprak, si pasojë e një ndarjeje jo të qartë të përgjegjësisë midis institucioneve dhe për pasojë edhe të mungesës së koordinimit midis tyre.

Mungesa e kritereve dhe standardeve të qarta e lehtësisht të lexueshme dhe të matshme, edhe midis fushave kryesore akademike, ka bërë që procesi

të rezultojë shpesh i pa harmonizuar madje edhe brenda së njëjtës fushë. Edhe përpjekja për përafrimin e programeve të studimit për formimin e mësuesve rezultoi e pasuksesshme, për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme, që bënë mbi këto programe pas akreditimit IAL, bazuar në lirinë, që kanë Senatet akademike për ndryshimin e kurrikulave.

Midis të tjerave vlen të theksohet se akreditimi nuk është shoqëruar me monitorim të procesit në vazhdimësi, si pasojë programet e studimit, që janë miratuar nga strukturat akredituese gjatë viteve pas akreditimit kanë pësuar ndryshime të rëndësishme në përmbajtje, në stafin akademik, format e mësimdhënies dhe madje edhe në vetë emërtimin e diplomës. Në këto rrethana një nga detyrat kryesore, që duhet vlerësuar urgjentisht është zhvillimi i një sistemi funksional të vazhdueshëm monitorimi.

Cilësia e mësimdhënies duhet të vendoset në fokusin e kësaj reforme. Deri më sot cilësia e mësimdhënies është vlerësuar vetëm përmes treguesve formalë, që kanë lidhje me disiplinën, respektimin e orareve mësimore, por pothuajse aspak me cilësinë, që shkon tek studenti e që shprehet më mësimnxënie.

Përmirësimi i sistemi i sigurimit të cilësisë në të ardhmen duhet të përfshijë si vlerësimin e jashtëm, ashtu edhe atë të brendshëm.

Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e IAL publike nuk i janë nënshtruar asnjëherë procesit të akreditimit të programeve të studimit, pas licencimit dhe përpara lëshimit të diplomave, duke bërë që shpesh të kemi ndryshime të rësore të kurrikulave të këtyre IAL-ve, si në nivelin e objektivave, destinacionit apo edhe vlefshmërisë reale të diplomave në treg. Mungesa e aplikimit të standardeve të njëjta në vlerësim dhe akreditim ka sjellë në këtë proces diferencime në trajtimin midis IAL-ve publike dhe atyre private.

Ndërkohë që akreditimi i programeve në IAL private, me pak përjashtime (në disa, që ofrojnë programe serioze, madje edhe të dyfishta apo të përbashkëta zyrtarisht me IAL jashtë vendit), është kryer në mjaft raste jo në mënyrë konsistente dhe koherente me praktika përzgjedhëse dhe shpesh klienteliste. Problem i madh është jo vetëm akreditimi

i programeve, por dhe zbatimi i tyre. Akreditimi është një çast, ndërsa rëndësi të madhe ka edhe ecuria. Duhet një kontroll i vazhdueshëm jo vetëm për zbatimin e programit, por edhe për përvetësimin e tij. Në këtë proces ka pasur madje shkelje të procedurave të vlerësimit e akreditimit, angazhimit të ekspertëve joprofesionalë e pa lidhje me fushën, cilësi të dobët të vlerësimit dhe raste të inkoherencës midis rezultateve të vlerësimit dhe vendimit të akreditimit. Këtyre u shtohet paqartësia, interpretimi i dyzuar i ligjeve dhe akteve nënligjore, i standardeve vështirësish të lexueshme dhe të zbatueshme, edhe pse në vitet e fundit në procesin e vlerësimit dhe akreditimit janë përfshirë edhe ekspertë të huaj.

Për sa i përket akreditimit, vetëm rreth 50% e programeve të studimit të IAL private janë të akredituara. Një pjesë e mirë e tyre për shkak se ende nuk kanë arritur në vitin e fundit të studimeve janë në proces. Thua se të gjitha kërkesat e paraqitura deri tani për akreditim të programeve nga IAL-të private, kanë marrë vendim akreditimi pozitiv, me pak raste ku janë lënë kushte për akreditim.

## 7.2 Ciklet e Studimit

Megjithatë Shqipëria ka aderuar në Procesin e Bolonjës, strukturimi i kurrikulave të IAL-ve sipas ligjit ekzistues është ndërtuar në tre cikle: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë.

Cikli i Parë i studimeve, që përfundon me Diplomën Bachelor (me kohëzgjatje normale 3 vite/180 kredite). Cikli i Dytë i studimeve, përfundon me Diplomë Master i Shkencave (me kohëzgjatje normale 2 vite/120 kredite) ose Diplomë Master Profesional 1,5 vite (60-90 kredite). Në ciklin e dytë të studimeve futen edhe programet e Integruara të Ciklit të Dytë me kohëzgjatje normale 5-6 vjet (300-360 kredite). Cikli i Tretë i studimeve ku bëjnë pjesë: Doktorata, me kohëzgjatje të paktën 3 vite akademike dhe 180 kredite nga të cilat 60 kredite janë për studime të organizuara teorike; Specializimet afatgjata, që zgjasin jo më pak se 2 vite akademike dhe 120 kredite. Në fushën e mjekësisë programet e studimeve të doktoratës mund të ofrohen të integruara me studimet specializuese afatgjata, sipas planit dhe programit mësimor, të miratuar nga IAL-të.

IAL-të kanë të drejtën të ofrojnë programe të studimeve jo universitare, profesionale, pas arsimit të mesëm me jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatje jo më pak se 2 vite akademike. Kreditet e akumuluar mund të transferohen në studimet universitare të ciklit të parë në përputhje me kriteret e IAL-së.

## 7.3 Programe studimi

Aktualisht sot në Shqipëri ka 59 IAL, nga të cilat 15 Publike dhe 44 Private. Në këto institucione ofrohen gjithsej 1560 programe studimit nga të cilat 725 ofrohen nga IAL publike dhe 835 nga ato private. Nga këto vetëm 13 janë diploma dyvjeçare jo universitare (9 në IAL publike dhe 4 në ato private). 582 nga 1560 programe ofrohen në ciklin e parë (nga të cilat 271 në publike dhe 311 në private), 850 programe në ciklin e dytë (463 në publike dhe 387 në private) dhe 128 programe në ciklin e tretë (nga të cilat 101 në IAL publik dhe 27 në IAL privat (këto të fundit janë mundësuar vetëm në tre vitet e fundit)). Në programet e ciklit të dytë vërehet se programet “Master Shkencor” dominojnë në numër në krahasim me programet “Master Profesional”, si në sektorin publik ashtu dhe atë privat.

Të ndara sipas fushave mbizotërojnë programet në fushën ekonomike (304), ndërkohë ato të Mësuesisë dhe Shkenca Mjekësore (172 secila), Shkenca Sociale (161), Drejtësi (141), Gjuhësore dhe Matematikë-Informatikë (93 secila), Inxhinieri-teknologji (97), Art dhe Dizajn (65), Shkenca Bujqësore (60), Shkenca Natyrore (43), Arkitekturë-Planifikim Urban (31), Gjeografi-Gjeologji (35), Shkenca Humane (40), Shkenca të Komunikimit (30) dhe të tjera të ndryshme ku përfshihen dhe programet dyvjeçare (23).

Referuar treguesve të Arsimit të Lartë në Shqipëri për vitin akademik 2012-2013, situata paraqitet si më poshtë.

**Tabela 7.3.** Tregues të Arsimit të Lartë në Shqipëri në 2014.

Tregues	Total	IAL-Publike	IAL-Private
Numri i IAL-ve	59	15	44
<b>Numri Programeve të studimit</b>	<b>1560</b>	<b>835</b>	<b>725</b>
Nr. Prog. C1	582	271	311
Nr. Prog. C2	850	463	387
Nr. Prog. C3	128	101	27
<b>Nr. studentëve</b>	<b>174.421</b>	<b>141.295</b>	<b>33.126</b>
Me kohë të plotë	138.935	106.152	32.783
Me kohë të pjesshme	31.264	30.921	343
Të tjera	4.453	4.356	97
<b>Stafi akademik</b>	<b>10.844</b>	<b>6596</b>	<b>4248</b>
Me kohë të plotë	4781	3143	1638
Me kohë të pjesshme	6063	3453	2610



## 7.4 Problematika

7.4.1. Nga një analizë e hollësishme e sistemit të IAL-ve në Shqipëri është hasur problematika e mëposhtme:

7.4.2. Arsimi i Lartë në Shqipëri në këto 9 vitet e fundit është përballur me një sërë ndryshimesh, që në më të shumtën e rasteve kanë sjellë realitete jo pozitive.

7.4.3. Rritja pa kriter e numrit të studentëve (po t'i referohemi statistikave zyrtare të pranimeve vihet re një dyfishim i numrit të pranimeve në IAL në programet Bachelor, nga 16 588 studentë në vitin akademik 2004-2005 në 34 874 në vitin akademik 2011-2012), të cilëve përgjatë këtyre viteve u është mundësuar hyrja si në Universitetet Publike (duke shkelur standardet si për numrin e studentëve për pedagog edhe raportin student/sipërfaqe) dhe në Universitetet Private (ku në shumë raste nuk ka pasur asnjë lloj pengese si në hyrje ashtu edhe në dalje), ka çuar në uljen e ndjeshme të cilësisë dhe vlerave të arsimit të lartë në Shqipëri. Tregues i këtij masivizimi të arsimit të lartë është dhe rritja e madhe e numrit të studentëve nga 63 257 në vitin akademik 2004-2005 në 174 421 në vitin akademik 2012-2013.

7.4.4. Vlen të theksohet se kjo rritje e numrit të studentëve, pa vizion dhe studim të tregut, nevojave dhe mundësive, nuk u justifikua asnjëherë me mbështetje nga ana e shtetit për përmirësimin e infrastrukturës pritëse ekzistuese të IAL publike, bazës materiale të tyre si edhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore. Është i domosdoshëm që gjatë akreditimit të bëhet edhe një kontroll për aplikimin e kushteve të punësimit në të gjitha IAL-të publik dhe jo-publik.

7.4.5. Ky masivizim ka çuar në futjen në universitet të mjaft studentëve me mesatare shumë të ulët. Ky lloj kontingjenti (zakonisht i karakterizuar nga një kërkesë shumë e ulët ndaj cilësisë dhe vetvetes, si edhe nga një kulturë minimale e dëshirës dhe motivimit për të mësuar), ka ndikuar edhe në rënien e nivelit si të mësimit ashtu edhe në atë të vlerësimit.

7.4.6. Reforma e Bolonjës, (që më së shumti u keqinterpretua dhe keq zbatua nga politikë bërësit dhe zbatuesit), futi në lojë Diplomën 3-vjeçare "Bachelor" të Ciklit të Parë të Studimeve, e cila në shumë drejtime nuk arriti efektin e duhur për t'i drejtuar të diplomuarit drejt tregut të punës, duke shërbyer si një valvul, që shkarkonte Arsimin e Lartë nga ata studentë, që nuk plotësonin kushtet për të vazhduar studimet e Ciklit të Dytë.

7.4.7. Negativisht ka ndikuar edhe mungesa e një kornize kombëtare punësimi me përcaktimet për profesionet dhe fushat ku mund të punonin të diplomuarit e ciklit të parë të studimeve. Në këto rrethana presioni i të diplomuarve të ciklit të parë për të vazhduar shkollimin edhe kur nuk e meritonin ka qenë shumë i madh. Nga ana tjetër edhe IAL-të ose nuk ishin konsekuente në zbatimin e kriterëve të vendosura për pranimin në Ciklin e Dytë (kryesisht ato publike), ose nuk aplikuan kriterë përzgjedhëse (kryesisht ato private).

7.4.8. Rritja progresive e numrit të studentëve në Bachelor, politikat shtetërore që të gjithë ata që mbarojnë studimet e Ciklit të Parë duhet të vazhdojnë pa kriterë studimet e Ciklit të Dytë, bëri që jo vetëm të rritej numri i studentëve në Ciklin e Dytë në mënyrë artificiale jashtë mundësive që ofronte infrastruktura dhe kapaciteti i Institucioneve të Arsimit të Lartë, por dhe të binte mundësia për zhvillimin dhe përfshirjen e punës kërkimore shkencore në studimet e Ciklit të Dytë.

7.4.9. Një tjetër "plagë" e sistemit AL në Shqipëri është edhe Sistemi me kohë të pjesshme. Ky sistem, ligjërisht u jep studentëve të njëjtën diplomë me sistemin me kohë të plotë, pa asnjë dallim në standardet e përdorura në procesin e vlerësimit dhe akreditimit. Studentët mund të futen në të lehtësisht pa kriterë përzgjedhëse, pa u shpallur fitues, bazuar në sistemin e maturës shtetërore, me mesatare minimale, pa kuota të studiuara në raport me nevojat e tregut dhe vendit. Mësimi zhvillohet vetëm në 2 ditë në javë nga 5 ditë në të cilat shtrihet po e njëjta kurrikul për sistemin me kohë të plotë. Por pavarësisht nga starti pjesa më e madhe e këtyre studentëve pasi diplomohen në Ciklin e Parë me kohë të pjesshme i drejtohen Ciklit të Dytë të studimit (me kohë të plotë) duke bërë kështu të mundur që "të zhduket" përfundimisht "historia e tyre" e fillimit të studimeve pa meritë në IAL. Në vitin akademik 2011-2012 të diplomuarit e sistemit me kohë të pjesshme përfaqësonin 1/10 e numrit të përgjithshëm të studentëve. Ndërsa në vitin aktual 2013-2014 numri i tyre është pothuaj se 1/6 e numrit të përgjithshëm të studentëve (31 264 studentë/174 121 studentë). Në vitin 2004-2005 numri i studentëve me kohë të pjesshme ka qenë 19 616 ndërsa sot është 31 264 (2013-2014).

7.4.10. Kurrikulat e krijuara nuk u janë përshtatur me shpejtësi ndryshimeve dhe zhvillimeve të tregut. Kurrikulbërësit universitarë si në të gjithë botën dhe në Shqipëri nuk e kanë ndjerë shtysën për të ndryshuar e përshtatur kurrikulën me zhvillimin

social-ekonomik të vendit. Kjo ka bërë që kurrikulat jo gjithmonë të kenë qenë të suksesshme. IAL-të, duke mos ndjekur një politikë të zhvillimit kurrikular të orientuar nga tregu, kanë replikuar në pjesën më të madhe njëra-tjetrën, duke ndikuar në një rritje të panevojshme të konkurrencës për treg pune midis të diplomuarve të së njëjtës fushë. Për të konkretizuar sa më sipër sqarojmë se vetëm 4 fushave të studimit (biznes-menaxhim, drejtësi, mësuesi, shkenca infermieristike) në IAL-të publike përfaqësojnë 354 nga 835 programe studimi në total, ndërsa IAL-të private përfaqësojnë 435 programe studimi ndër 725 programe studimi në total.

7.4.11. Mungesa e një politike të zhvillimit të kurrikulave me synimin për t'i orientuar të rinjtë sa më mirë drejt tregut të punës ka bërë që struktura e kurrikulave në IAL-të publike të dominohet nga ato të shkencave humane (479), përkundrajt atyre të shkencave teknike dhe të aplikuar (333). Akoma më i thellë është ky raport midis këtyre drejtimeve në IAL-të private (497/228).

7.4.12. I njëjti fenomen, që ndodhi me kalimin nga Cikli i Parë në Ciklin e Dytë u vu re brenda pak kohe edhe në kalimin nga Cikli i Dytë në Ciklin e Tretë. Numri i doktorantëve të regjistruar në një vit akademik është rritur me shpejtësi shumë të madhe në këto vitet e fundit. Ai është rritur 2.6 herë në vitin akademik 2011-2012 përkundrajt 2009-2010. Kryerja e studimeve të doktoratës u pa si një mundësi karrierë në sektorin publik dhe jo si një karrierë në punën kërkimore-shkencore.

7.4.13. Në kushtet e mungesës së infrastrukturës kërkimore, rritja e madhe dhe e menjëhershme e numrit të doktorantëve, e pa shoqëruar me zhvillimin e infrastrukturës kërkimore të nevojshme, ka ndikuar jo pozitivisht në cilësinë e doktoratave, duke bërë që një pjesë e madhe e tyre të jenë kompilative.

7.4.14. "Punësimi i shumëfishtë", i stafit akademik të IAL publike edhe në strukturat e IAL private, të cilat nuk e kishin kapacitetin për ngritjen e kurrikulave dhe zhvillimin e tyre për mungesë të kapaciteteve, shpërndahu përkushtimin, kohën për zhvillimin e punës shkencore, shpërndau vëmendjen dhe uli cilësinë duke e shndërruar IAL në shumë raste në një shkollë teorike ku zhvillohej mësim dhe koha për kërkim erdhi fatkeqësisht duke u kufizuar. Për këtë është i nevojshëm rregullimi i këtij procesi.

7.4.15. Transferimet e ndërmjetme nga universitet private në ato publike kanë qenë një tjetër fenomen

i AL. Këto transferime e kanë shmangur zbatimin e mekanizmit meritë-preferencë të Maturës Shtetërore duke bërë që të krijohet një rrugë alternative për të përfituar akses të pa merituar në programe të caktuara studimi pranë IAL-ve publike.

7.4.16. Baza materiale dhe infrastruktura kërkimore mbeten një nga pikat e dobëta të IAL-ve publike. Universitet publike kanë një kohë shumë të gjatë që nuk marrin mbështetje për bazën materiale mësimore-shkencore nga ana e shtetit. Ndërkohë edhe procedurat e blerjes së mjeteve bazë të punës dhe bazës materiale për zhvillimin e mësimi dhe kërkimit, janë shumë burokratike, të zgjatura, të vështira dhe në përgjithësi kjo situatë ka ndikuar drejtpërsëdrejti në dëmtimin e rëndë të cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Rregullimi i këtij procesi kërkon përmirësimin e legjislacionit financiar të buxhetit dhe prokurimeve, për t'i trajtuar IAL-të me një status të veçantë.

## 7.5 Sugjerime- Rishikimi i Programeve të Studimit

7.5.1. Duhet të përgatitet një hartë e Programeve të Studimit të ofruara nga të gjitha IAL-të publike e private, në plan kombëtar dhe institucional. Për të gjykuar dhe konkluduar për politikën e zhvillimit të tyre dhe të financimit të diferencuar të Universiteteve Publike dhe të programeve të tyre duke i dhënë prioritet programeve, që do të plotësojnë nevojat e zhvillimit të vendit dhe do të favorizojnë punësimin e rinisë. Kjo analizë do të ndihmojë edhe në shmangien e paralelizmave midis IAL-ve dhe në krijimin e kurrikulave të reja të papërshtatshme me tregun.

7.5.2. Të përcaktohen për çdo IAL publike programet e çdo cikli studimi, që do të financohen nga shteti (si i domosdoshëm për zhvillimin strategjik të vendit), si dhe kuotat përkatëse të studentëve (bazuar në numrin e stafit dhe kualifikimin përkatës të tij si edhe në raportin student/sipërfaqe).

7.5.3. Mbi bazën e numrit të studenteve dhe të rikonceptimit të ngarkesës, të llogaritet stafi akademik. Është e rëndësishme që në këtë kuadër të shkohet drejt standardeve ndërkombëtare të mirënjohura.

7.5.4. IAL publike, mbi bazën e kapaciteteve të infrastrukturës, mund të zhvillojnë programe të tjera studimi dhe të rrisin ngarkesën e paguar plus të stafit akademik ekzistues, ose të punësojnë staf ekstra për programe të tjera mbi bazën e vendosjes së tarifave të shkollimit (vlerë tavan nga shteti, që

përcakton vlerën maksimale të tarifës, e cila më pas përcaktohet e diferencuar nga çdo IAL, sipas politikave të veta). Në qoftë se për futjen e këtyre programeve kërkohet financim shtetëror, atëherë këto programe duhet të aprovohen nga Agjencia Kombëtare e Financimit.

7.5.6. Për saktësimin dhe plotësimin e ofertës formuese të Ciklit të Tretë të studimeve duhet të rifutet kualifikimi i Masterit të Ciklit të Tretë. Kjo është e domosdoshme për diferencimin e këtij kualifikimi të kryer pas programeve të integruara të ciklit të dytë (Mjekët, Stomatologët, Farmacistët, Arkitektët etj.). Mbështetur në përvojën e disa vendeve të huaja ai duhet të quhet "Master Ekzekutiv", i pozicionuar në Ciklin e Tretë me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike, me 60 ose 120 kredite ECTS (ky kualifikim mund të realizohet pas studimeve Master i Shkencave të Ciklit të Dytë). Kualifikimi është i njëjtë me Masterin e Nivelit të Dytë, që parashikonte Ligji i Arsimit të Lartë të vitit 2007. Futja e këtij kualifikimi do të lehtësojë edhe ngarkesën e IAL-ve për studimet e doktoraturës.

7.5.7. Ngarkesa mësimore e Masterit Profesional duhet të jetë 1 vit akademik dhe me 60 kredite ECTS, nisur nga përvoja ndërkombëtare për t'u diferencuar qartë nga Masteri Shkencor.

7.5.8. Hapja e programeve të Ciklit të 2° dhe të 3°, me përjashtim të Masterave Profesionale dhe Ekzekutive, përkatësisht të Ciklit 2° dhe 3°, duhet të ketë komponent kërkimor-shkencor dhe infrastrukturë kërkimore të vërtetueshme paraprakisht.

7.5.9. Për programet e studimit të ciklit të 2° dhe të 3° të financuara nga shteti si prioritare për politikën zhvillimore dhe strategjike, duhet të zbatohen rigorozisht dhe të monitorohen kriteret e vendosura nga shteti ndaj IAL.

7.5.10. Të mbyllet sistemi i studimeve «me kohe të pjeshme» për të gjitha ciklet dhe programet e studimit si në IAL-të publike edhe ato private.

7.5.11. Të futet kodifikimi i programeve në të gjithë sistemin e arsimit të lartë. Për këtë të bëhet grupimi dhe organizimi i programeve të studimit bazuar në kode, që identifikojnë fusha të ngjashme. Kjo shërben dhe për të përcaktuar kalimin p.sh., në Master pas fitimit të një diplome bachelor. Kalimi mund të bëhet brenda fushës kryesore dhe të jetë i përcaktuar saktësisht në kurrikulën e programin përkatës të Masterit (Shkencor, Profesional). Linjë e ngjashme mund të ndiqet edhe për Ciklin e Tretë të Studimeve.

7.5.12. Të krijohet dhe publikohet e përdituar Baza e të dhënave për temat e mbrojtura në programet e studimit të ciklit të 2° dhe të 3°. Për Temat e ciklit të Dytë duhet të pasqyrohet një përmbledhje e shkurtër në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht). Po ashtu, autoreferati i tezës së doktoratës duhet të jetë i përkthyer në një nga gjuhët e mësipërme.

7.5.13. Të hiqet detyrimi ligjor i dhënies së gjuhës angleze me teste ndërkombëtare. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj gjuhe, u sugjerohet universiteteve ta aplikojnë dhënien e saj me teste ndërkombëtare në qoftë se e shohin të nevojshme. Kjo pasi nuk mund të kushtëzohet dhënia e një kualifikimi universitar me një testim jashtë universitar. Gjuha e huaj duhet të jetë pjesë e programit mësimor, me përmbajtje të orientuar sipas profesionit. Studentët duhet të jenë të lirë të zgjedhin gjuhën e huaj, që dëshirojnë ose që ofron programi i studimit.

7.5.14. Të hiqet provimi pasuniversitar i Gjuhës së Huaj, që mbrohet pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të UT-së (sistem, i cili ka lindur në vitet '90, si kusht i mbrojtjes së Doktoratës). Për një kualifikim të tillë të interesuarit t'u drejtohen Qendrave të Specializuara të njohura nga shtetet përkatëse.

7.5.15. IAL-të duhet të arkivojnë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dokumentacionin origjinal të procesit mësimor (regjistrat e zhvillimit të mësimit, listat zyrtare të notave të provimeve, të diplomimit, të diplomave të lëshuara, kopje të diplomave të lëshuara, fotokopja e noteruar e dëftesës së shkollës së mesme të studenteve, që janë diplomuar).

7.5.16. Akreditimi i programeve duhet të shoqërohet me një monitorim të vazhdueshëm. Sugjerojmë zhvillimin e një sistemi funksional të vazhdueshëm monitorimi.

7.6 Sugjerime- Rishikimi i Standardeve

7.6.1. Standardet e Kurrikulave të programeve të studimit në IAL duhet të jenë të njëjta për të gjithë sistemin dhe të gjitha llojet e programeve

7.6.2. Në universitetet publike, programet e së njëjtës emërtesë/profil dhe cikël/nivel studimi duhet të jenë të njëjta në masën 70-80%, e domosdoshme kjo për të ruajtur të njëjtin standard formimi në nivel kombëtar.



7.6.3. Standardet e cilësisë për programet e studimit të të tria cikleve duhet të jenë të matshme dhe të kontrollueshme. Duhet forcuar kontrolli i zbatimit të standardeve aktuale të Ciklit të Parë, të Ciklit të Dytë dhe Ciklit të Tretë.

7.6.4. Të verifikohet e rishikohet ngarkesa e të gjitha programeve pasi shpesh konstatohen detyrime të pa llogaritura në planin mësimor (lëndë me vlerësim të vazhduar apo firma, të cilat nuk përlogariten në numrin e detyrimeve të numërueshme në bazë të udhëzimeve përkatëse), që e rrisin artificialisht ngarkesën e studenteve. Pedagogët, që japin leksione në çdo cikël duhet të kenë të paktën një diplomë të ciklit pasardhës.

7.6.5. Programet e studimit, të Ciklit të Parë Bachelor duhet të realizohen me provime, por sipas vendimit të departamenteve mund të ketë një grup studentësh me rezultate të larta (me mesatare mbi 8,5), të cilët sipas mundësisë dhe zgjedhjes mund të përmbyllin studimet e këtij cikli me temë diplome, që mund të jetë kompilative ose eksperimentale (sipas fushës së studimit).

7.6.6. Përfundimet e studimeve në Ciklin e Dytë duhet të përmbillen me realizimin e një tezë diplome, që mund të jetë kompilative apo eksperimentale në varësi të llojit të programit të studimit. Temës së diplomës i përkasin një numër kreditesh, i cili është në varësi të llojit të temës dhe llojit të programit të studimit. Për Studimet e Ciklit të Dytë "Master profesional", përmbyllja e studimeve mund të jetë me tezë kompilative, detyrë kurs ose projekt. Në programet e studimit "Master i Shkencave" përzgjedhja e temës eksperimentale duhet të jetë e lirë nga studenti mbështetur në temat e vendosura në dispozicion nga IAL në përputhje me politikën e saj të kërkimit shkencor.

7.6.7. Për doktoratën, në vitin e parë të hien studimet e organizuara dhe të zhvillohet vetëm puna kërkimore e parashikuar në kuadrin e temës. Temat e studimeve të doktoratës duhet të jenë vetëm eksperimentale. Doktorata zhvillohet me atashim me kohë të plotë të doktorantit pranë Departamentit si staf i brendshëm i përkohshëm me maksimum kohë të pagueshme (me pagesë minimale) pranë IAL-së 3 vjet (koha minimale e realizimit të studimeve të doktoratës). Projekti kërkimor i doktoratës të përcaktohet nga Departamenti në varësi të programit/objektivave të përcaktuara për kërkimin shkencor si dhe projektet në ndjekje. Studentët e doktoratës aplikojnë për projektet e shpallura nga IAL-të. Për çdo projekt të shpallur përcaktohet dhe Drejtuesi Shkencor apo

Drejtuesit Shkencorë në varësi të numrit të vendeve në dispozicion për doktorantë. Drejtuesi Shkencor nuk mund të ndjekë më shumë se 2-3 doktorantë. Për doktoratat udhëheqësit e temave të doktoratës duhet të kenë të paktën titullin Prof. As. ose me PhD jashtë vendit.

7.6.8. Praktikat profesionale dhe programet, që përgatisin profesionistë në profesione të rregulluara të parashikohen në përputhje me Udhëzimin e BE-së për profesionet e rregulluara.

7.6.9. Të përcaktohen kodet kombëtare të programeve të studimit ekzistuese dhe çdo program i ri duhet të shtohet duke i dhënë një kod sipas fushës ku bën pjesë.

7.6.10. Të përcaktohen edhe programe të tjera me cikël unik 5 vjeçar veç atyre aktuale, për shembull drejtësi, etj., në përputhje me përvojat më të mira evropiane.

7.6.11. Ndryshimet në programet e studimit pas licencimit të tyre duhet t'u bëhen të njohura strukturave kompetente të MAS. Nëse programi ka në përbërjen e tij lëndë me zgjedhje këto duhet të jenë të aprovuara në total në momentin e aprovimit të programit dhe më pas mund të aktivizohen ose jo. Studentët duhet të kenë të drejtë që të zgjedhin me vullnetin e tyre midis lëndëve me zgjedhje, që ofrohen nga lëndët e aprovuara për vitin në vazhdim.

7.6.12. Në IAL-të publike duhet të përcaktohet numri minimal i studentëve për zhvillimin e një lënde me zgjedhje.

7.6.13. Kurrikulat e programeve të studimit në IAL duhet të ndërtohen në bazë të parimit të vartësisë ndërlëndore.

7.6.14. Të përcaktohet një masë frekuentimi minimale e detyruar e lëndës sipas zërave, veçanërisht për Ciklin e Parë.

7.6.15. Mangësitë e ndeshura në formimin bazë të një numri të konsiderueshëm studentësh që hyjnë në Arsimin e Lartë, të konstatuara në mjaft IAL, shtrojnë nevojën e rishikimit tërësor dhe të shpejtë të strukturës dhe përmbajtjes së kurrikulave të Arsimit të Mesëm (AM).

7.6.16. Reformimi i sistemit arsimor parauniversitar nga 4 + 4 + 4 në atë 9 + 3 çoi në shkurtime me një vit të periudhës së formimit në AM, duke ia kaluar atë arsimit 8- vjeçar dhe për pasojë çoi

në reduktimin me një vit të ngarkesës formuese të nxënësve, pikërisht në periudhën e arritjes së maturitetit, kur kapaciteti nxënës dhe analitik janë në fazën rritëse.

7.6.17. Në këto kushte rekomandojmë plotësimin e strukturës së Arsimit të Mesëm me një vit, duke e rikthyer kohëzgjatjen e tij në minimalisht 4 vjet. Arkitektura e re e sistemit parauniversitar mund të strukturohet në 2 variante:

7.6.17.1. me kohëzgjatje 12 vjet dhe strukturë 4 + 4 + 4 (sistemi i vjetër por mjaft i konsoliduar dhe rezultativ duke i bërë maturanët shqiptarë kompetitive edhe jashtë Shqipërisë)

7.6.17.2. me kohëzgjatje 13 vjet dhe me 2 opsione strukture: 9 + 4 ose 8 + 5 . Ky variant është sigurisht më i miri, pasi krijon më shumë hapësirë për formimin e maturanëve. Ai zbatohet në disa vende evropiane dhe është plotësisht i justifikuar për vendin tonë po të konsiderojmë diferencat në disnivelin kulturor mesatar midis Shqipërisë dhe BE.

7.6.18. Çdo IAL duhet të ketë të miratuar Kodin Etik Institucional.

7.7. Sugjerime- Rishikimi i Aksesit në Arsimin e Lartë

7.7.1. Të ndalohet ndjekja e njëkohshme dhe regjistrimi i çdo studenti në më shumë se një program studimi, referuar të gjitha cikleve. Kjo të arrihet me akte normative dhe nëpërmjet sistemit të matrikullimit.

7.7.2. Të vendoset një notë mesatare dysHEME, (6 fillimisht, kriter i cili mund të rishikohet me kalimin e kohës gjatë zbatimit të reformës me qëllim rritjen e këtij pragu brenda 3 viteve pasardhëse në 7), si kriter kombëtar për hyrjen në testim në programin Bachelor të organizuar nga IAL.

7.7.3. Të vendosen kritere përzgjedhëse të përgjithshme nga MAS dhe të detajuara nga IAL për hyrjen në programet e ciklit të 2 dhe të 3.

7.7.4. Aksesit në Ciklin e Dytë dhe të Tretë të shoqërohet me testin ose dokument, që vërteton njohjen e gjuhës në nivel universitar, të njohjes së një gjuhe të huaj (që mund të jetë një nga gjuhët e BE-së).

7.7.5. IAL mund të vendosin kritere shtesë për pranimit në ciklet e studimit, përveç atyre të vendosura nga MAS. Kriteret duhet të deklarohen

paraprakisht të paktën një vit përpara datës së testimit dhe në momentin e publikimit të vihen në dijeni edhe strukturat përkatëse të MAS.

7.7.6. Për transferimet e studimeve brenda të njëjtit cikël studimi, çdo i interesuar ka të drejtën që vetëm nëse shpallet fitues për programin e studimit në fjalë të transferojë pas një vlerësimi të kryer nga Departamenti përkatës kreditet e përfutuara nga programi i mëparshëm i po të njëjtit cikël.

7.7.8. Transferimet nga arsimit privat në atë publik dhe anasjelltas nuk duhet të lejohen.

7.7.9. Transferimet lejohen vetëm brenda të njëjtit cikël dhe fushe studimi, të njëjtë ose të përafërt, gjithmonë midis institucioneve të të njëjtit profil. Në përgjithësi kjo duhet të dekurajohet.

7.7.10. Modalitetet dhe procedurat e transferimeve brenda IAL-ve përcaktohen nga IAL-i përkatës në rregulloret tyre.

7.7.11. Kohëzgjatja e regjistrimit në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes të planit mësimor të atij programi.

7.7.12. Studentët përsëritës në IAL-të publike, për vitet jashtë planit mësimor paguajnë për çdo vit plus një tarifë të barabartë me ½ e tarifës vjetore të studimit.

7.8. Sugjerime- Rishikimi i Ngarkesës Mësimore

7.8.1. Duhet rishikuar sipas eksperiencave ndërkombëtare norma e punës të pedagogëve për mësimdhënien (në vlerë dhe strukturë) në favor të krijimit të mundësive për kërkim shkencor apo ndjekje të studentëve në tema diplome apo në asistencë të studentëve, që kanë nevojë

7.8.2. Në emërtesat e stafit akademik të futen 2 profilet :

i. Staf akademik mësimor (70% mësim, 30% kërkim shkencor)

ii. Staf akademik kërkimor-shkencor (30% mësim, 70% kërkim).

7.9. Sugjerime- Rishikimi i Mësuesisë

7.9.1. Mësuesia duhet të organizohet në dy cikle. Cikli i parë (Diplomë Bachelor) me 3 vite dhe 180 kredite të ndjekura nga studimet e Ciklit të Dytë me 1-2 vite me 60-120 kredite (Master Profesional; Master i Shkencave).

7.9.2. Mësuesit e arsimit parashkollor dhe atij fillor

duhet të formohen nga studime bachelor 3 vjeçare me 180 kredite me kurrikul të ndërtuar për këtë cikël. Pas këtyre studimeve studentët mund të kalojnë në tregun e punës si mësues ndihmës pasi kanë marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit (pas provimit të licencimit).

7.9.3. Një tjetër mundësi për këta studentë është vazhdimi i Ciklit të Dytë të studimeve Master Profesional 60 kredite 1 vjeçar, i cili duhet të jetë i diferencuar në MP, që përgatit mësues për arsimin parashkollor ose MP, për arsimin fillor. Pas fitimit të diplomës së Ciklit të Dytë të diplomuarit sipas titullit përkatës të diplomës mund të kalojnë në tregun e punës si mësues pasi kanë marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit (pas provimit të licencimit).

7.9.4. Mësuesit për Arsimin e Mesëm duhet të përgatiten duke ndjekur këtë rrugë:

i. Diplomim në fushën përkatëse të shkencës (Cikli i Parë Diplomë Bachelor 3 vjet 180 kredite).  
ii. Studime të Ciklit të Dytë Master i Shkencave 2 vjeçar 120 kredite, i cili përgatit mësues për AM të ulët dhe të lartë. Kurrikulat e Programeve të studimit të Ciklit të Dytë për përgatitjen e mësuesve duhet të ruajnë një ngjashmëri në nivel kombëtar sipas fushës së shkencës përkatëse 80% në ndërtimin e tyre.

iii. Kurrikulat e Programeve të Ciklit të Dytë të studimeve për formimin e mësuesve duhet të kenë një komponent të rëndësishme të formimit pedagogjik dhe psikologjik si edhe të formimit praktik pranë IAM.

iv. Kjo reformë propozon që viti i praktikës në shkollë, pas diplomimit të studentëve me Diplomën e Ciklit të Dytë, pranë Institucioneve të Arsimit të Mesëm duhet të bëhet me 1/2 e rrogës së mësuesit (sikundër edhe ndodh për stazhierët e mjekësisë).

v. Formimi i mësuesve duhet të jetë i vazhduar, IAL-të duhet të krijojnë kushte për trajnimin dhe formimin e vazhduar të mësuesve në bashkëpunim me Institucionet shtetërore të Arsimit të Mesëm.

7.10. Sugjerime - Struktura për organizimin e Programeve të Studimit në IAL

7.10.1. Programet e studimeve Bachelor në IAL të Ciklit të Parë zgjasin 3 vite (180 kredite); programet e Ciklit të Dytë të Studimeve zgjasin: 1 vit/60 kredite (Master Profesional), 2 vite/120 kredite (Master i Shkencave) ose të integruara 5 ose 6 vite/300 ose 360 kredite (Master Shkencor i Integruar). Programet e Ciklit të Tretë të studimeve zgjasin 1 ose 2 vite/60 ose 120 kredite (Master ekzekutiv), ose 3-5 vite për studimet doktorale. Në këtë cikël nuk ka detyrime akademike të drejtpërdrejta mësimesh institucionale (nuk ka 60 kredite studimesh të organizuara).

7.10.2. Në kuadrin e rishikimit të kurrikulave do të vlerësohet me prioritet mundësia e përfshirjes, në programet e studimit të IAL-ve, të kurrikulave të shkurtra profesionale, mbështetur në nevojat e zhvillimit social-ekonomik të rajonit, si dhe në përvojën e zhvillimit të arsimit profesional në vend dhe rajon. Pas Maturës Shtetërore në kuadrin e kësaj reforme IAL-të mund të propozojnë cikle të formimit profesional me kohëzgjatje 1 ose 2 vite (60 ose 120 kredite), pas së cilit studentët pajisen me Diploma profesionale dhe dalin në tregun e punës.

7.10.3. Studentët, që pajisen me diplomë Bachelor të Ciklit të Parë të studimeve pas përfundimit të tij kanë tre mundësi:


- i. Të dalin në tregun e punës (për këtë detyra e IAL është, që të bashkëpunojnë me strukturat e Ministrisë së Punës për përshkrimin e vendeve të punës së këtyre diplomave).
- ii. Të ndjekin programet Master Profesional 1-2 vjeçar me 60-90 kredite .
- iii. Të ndjekin programet Master i Shkencave 2 vjeçar me 120 kredite

7.10.4. Studentët, që pajisen me diplomë Ciklit të Dytë të studimeve Master i Shkencave kanë këto mundësi:

- i. Të dalin në tregun e punës
- ii. Të ndjekin programet Master Ekzekutiv 1 ose 2 vjeçar me 60 ose 120 kredite
- iii. Të ndjekin studimet Doktorale si më lart përshkruar.
- iv. Të ndjekin specializimet universitare afatgjata.

7.10.5. Studentët, që pajisen me diplomë Ciklit të Dytë të studimeve Master Profesional dalin drejtpërdrejt në tregun e punës.

Figura 7.1. Struktura e propozuar për organizimin e Programeve të studimit në IAL



# Kërkimi shkencor organizimi, funksionimi dhe financimi

## Kapitulli 8

### KËRKIMI SHKENCOR ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE FINANCIMI

#### 8.1. Niveli dhe Cilësia e Punës Kërkimore -Shkencore

Situata dhe rezultatet aktuale të Kërkimit Shkencor lenë mjaft për të dëshiruar. Në vitet e fundit nuk janë shënuar zhvillime pozitive në këtë drejtim, me gjithë dëshirën dhe ndërhyrjet e bëra në sistem. Midis të tjerave një ndër treguesit kryesorë të mungesës së progresit është numri mjaft i ulët i përfshirjes së institucioneve kërkimore shqiptare në programet ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe përfitimi prej tyre, gjë që flet për kapacitete institucionale dhe njerëzore të një niveli jo të kënaqshëm, si edhe për një produkt të pa krahasueshëm në nivel ndërkombëtar.

Në ndryshimet e kryera në vitet e tranzicionit në arsimin e lartë, në mënyrë të njëanshme i është kushtuar më shumë rëndësi mësimdhënies së kërkimit shkencor. Një tregues i kësaj situatë është fakti se janë ngritur me dhjetëra institucione të arsimit të lartë privat, që ofrojnë vetëm mësimdhënie, ndërsa ato institucione që i ofrojnë të dy aspektet janë të pakta.

Një tregues tjetër i kësaj gjendje jo optimiste të nivelit të kërkimit shkencor është edhe mbingarkesa në mësimdhënie e pedagogëve në IAL mbi normën e përcaktuar me ligj. Fatkeqësisht, kjo është edhe një përvojë që është transmetuar tek gjenerata e re, e punësuar në këto institucione të arsimit të lartë. Rritja e pa motivuar e numrit të kandidatëve të pranuar në studimet doktorale nuk rezultoi të ketë prodhuar ndonjë zhvillim pozitiv në kërkimin shkencor, pasi në pjesën më të madhe të rasteve përfundoi në një rendje për fitimin e gradës shkencore "Doktor".

#### 8.2. Problematika

8.2.1. Një nga arsytet e mëdha të nivelit të ulët të punës kërkimore shkencore është mungesa e vëmendjes së duhur, në radhë të parë nga vetë sistemi. Kjo është reflektuar në mungesën e investimeve në infrastrukturën kërkimore.

8.2.2. Vetëm në vitet fundit është krijuar një institucion shtetëror – AKTI, i cili ka për detyrë të vetme ndihmesën dhe financimin e punës kërkimore shkencore duke marrë funksionet, që më parë i mbulonte Drejtoria e Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Edhe ky institucion, që nga natyra është shumë i rëndësishëm, ka fonde të kufizuara për mbështetjen e kërkimit në nivel kombëtar. Nxjerrja e tij jashtë MASH-it, ndërkohë që riorganizimi i rrjetit të institucioneve të kërkimit shkencor e përqendroi atë në universitete, nuk solli rezultatet e pritura. Tregues i mos zhvillimit të sistemit të kërkimit shkencor është edhe mungesa e fondacioneve financuese të specializuara në këtë sektor, që i gjejmë në shumë vende më të zhvilluara. Aq më tepër nuk bëhet fjalë për institucione financimi apo mekanizma të specializuar për shkenca të caktuara.

8.2.3. Riorganizimi institucional i kërkimit shkencor, i ndërmarrë në vitet e fundit, bëri që institucionet e këtij sektori, të trashëguara nga periudha e para 1990-ës, t'i bashkëngjiten IAL-ve, që kishin statusin e universitetit. Megjithëse lëvizja ishte e mirë qëllimshme, për të integruar kërkimin shkencor me mësimdhënien, si në shumë vende që prodhojnë standard në këtë fushë, nuk solli ndonjë nxitje të dukshme apo risi në veprimtaritë kërkimore dhe nuk u shoqërua nga ndonjë evoluim cilësor i kërkim-zhvillimit në nivel kombëtar.

8.2.4. Kërkimi shkencor merret pak në konsideratë në procesin e akreditimit institucional të arsimit të lartë. Ndryshe nga vendet e zhvilluara të Evropës dhe të rajonit, ku preferenca për kryerjen e studimeve apo zhvillimin e karrierës akademike në një institucion të arsimit të lartë përcaktohet, ndër të tjera, edhe nga cilësia e kërkimit shkencor të prodhuar nga personeli akademik. Në Shqipëri ky kriter përzgjedhjeje nuk ekziston. Mbi të gjitha, niveli shkencor në rang institucioni apo departamenti është përgjithësisht i pamatshëm dhe vlerësimi i tij kryhet vetëm për efekte të karrierës individuale akademike.

8.2.5. Është gjithashtu i rëndësishëm, në këtë kuadër, fakti që llogaridhënia institucionale për punën kërkimore shkencore është minimale ose jo-ekzistuese në disa raste.



8.2.6. Në nivelin e institucioneve të arsimit të lartë, kjo problematikë është edhe më e madhe. Së pari, ka një mungesë të infrastrukturës kërkimore dhe, së dyti, mungojnë mekanizmat e mbështetjes në veprimtarinë kërkimore individuale të pedagogut.

8.2.7. Si rezultat i mbingarkesës në veprimtarinë pedagogjike, mungon ekuilibri midis punës kërkimore shkencore dhe mësimdhënies. Kjo ka bërë, që të mos arrihet kristalizimi i profilit të kërkuesit krahas atij të mësimdhënësit.

8.2.8. Aktualisht në IAL mungojnë mekanizmat e nxitjes të pedagogut që ai të kryejë punë kërkimore. Karriera e një pedagogu nuk ndiqet në mënyrë rigorozë dhe kjo bën që veprimtaria kërkimore të mos përbëjë stimul, përveç përparimit të individit në karrierën e tij akademike. Në IAL nuk ekziston portofoli i pedagogut, ku të përfshihet çdo gjë që ai ka bërë për t'u zhvilluar profesionalisht dhe nuk ka, gjithashtu, vlerësim vjetor apo disa vjeçar të punës së tij.

8.2.9. Ekziston, por nuk zbatohet si duhet koncepti i vitit sabbatik. Një pjesë e madhe e pedagogëve nuk e kanë shfrytëzuar atë dhe, madje, ka prej tyre që nuk janë në dijeni të tij.

8.2.10. Ka një koncept jo të drejtë të produktit kërkimor; ai në shumë raste justifikohet me botim tekstesh mësimorë, duke mos u fokusuar në punën origjinale dhe eksperimentim për të sjellë diçka të re në shkencë. Rastet e plagjiaturës janë të shpeshta.

8.2.11. Niveli i ulët i kërkimit shkencor shprehet edhe tek bashkëpunimi i vogël me institucionet e huaja në projekte të përbashkëta kërkimore, si me institucionet perëndimore, ashtu edhe me ato të vendeve fqinjë.

8.2.12. Ka një mungesë të veprimtarive të rregullta shkencore të organizuara nga IAL-të në nivel fakulteti dhe departamenti.

### 8.3. Sugjerimet - Organizimi

8.3.1. Në plan kombëtar propozohet organizimi i punës kërkimore -shkencore në një strukturë organizative siç paraqitet në skemën 9.1.

8.3.2. Në analogji me organizimin e kërkimit shkencor në mjaft vende të BE, Institucione të Kërkimit Shkencor (IKSh) në varësi të MAS ose që bashkëpunojnë me ato në procesin mësimor, do të konsiderohen:

1. Institucionet e Arsimit të Lartë që zhvillojnë ciklin dytë dhe të tretë të studimeve (Universitetet, Akademitë, Kolegjet Universitare)

2. Institutet dhe Qendrat Kërkimore Ndëruniversitare, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

3. Institutet dhe Qendrat e Kërkimit të zbatuar, në varësi të ministrive të tjera

8.3.3. Për të rritur e konsoliduar rolin ekzekutiv të AKTI-it në Kërkimin Shkencor dhe sidomos në sistemin e Arsimit të Lartë, propozohet kalimi i saj në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me emërtesën Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor (AKKSh), duke ruajtur funksionet e mëparshme, por duke forcuar komponentin e asistencës për programet ndërkombëtare.

8.3.4. AKKSh do të menaxhojë dhe do të bëjë publike një bazë të dhënash për të gjitha projektet e financuara në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkim Zhvillimit (PKKZh), në të cilat do të vazhdojnë të kenë akses institucionet publike e jo publike në varësi të misionit të tyre. AKKSh do të vazhdojë të administrojë fondet e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit, si edhe donacione të mundshme në rrafsh kombëtar apo ndërkombëtar.

8.3.5. Për sa i përket rrjetit institucional, konsiderohet i padobishëm rëndimi aktual i strukturës së universiteteve me institucione dhe qendra të kërkimit të zbatuar me rëndësi dhe përgjegjësi kombëtare, të cilat mbulojnë shërbime të rëndësishme për shtetin. Nisur nga ky këndvështrim, sugjerohet transferimi i tyre nga universitetet pranë ministrive, që mbulojnë këto fusha të veprimtarisë institucionale në planin kombëtar. Institutet dhe qendrat do të kenë një strukturë dhe organizim mbështetur në funksionin prioritar që ato kanë (shërbim dhe/ose kërkim-zhvillim). Është e rëndësishme të përmendet këtu se këto qendra kanë përgjegjësi institucionale ndaj shtetit për fushat specifike që mbulojnë, si edhe për veprimtaritë dhe produktin që ofrojnë. Ato do të financohen nga ministrinë përkatëse.

8.3.6. Ato mund të vazhdojnë bashkëpunimin me IAL-të duke kontribuar në realizimin e programeve ciklit të dytë dhe të tretë (tezat e doktoratës dhe mikro-tezat e masterit shkencor, mësimdhënie për lënde të specialitetit, praktika mësimore). Personeli i tyre mund të vazhdojë të zhvillojë një ngarkesë të kufizuar mësimore në IAL e fushave përkatëse. Këto marrëdhënie do të rregullohen me akte nënligjore apo normative të veçanta.

8.3.7. Në analogji me IAL jo-publike, mund të krijohen, licencohen dhe funksionojnë edhe institucione jo-publike të KSh. Hapja, funksionimi dhe akreditimi i tyre rregullohen me akte nënligjore të veçanta, gjithnjë duke respektuar të njëjtat standarde si për ato publike.

## 8.4. Sugjerimet - Funksionimi

8.4.1. Institucionet e Kërkimit Shkencor të pikave 2 dhe 3 do të funksionojnë të organizuar në departamente dhe do të zhvillojnë misionin e tyre duke bashkëpunuar me IAL-të sipas hapësirave të nevojshme.

8.4.2. Si u përmend më sipër një nga problemet e hasura në kërkimin shkencor është dhe raporti mësim/kërkim. Duke iu referuar këtij raporti parashikohen 2 tipa personeli akademik:

o tipi i parë, ku përfshihen Departamentet e IAL të pikës 1, ngarkesa akademike, e të cilëve do të jetë një baraspeshim midis mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore, me një peshë specifike më të lartë në mësimdhënie.

o tipi i dytë, ku përfshihen Departamentet e IAL të pikës 1, por edhe Qendrat R&D, ngarkesa akademike e të cilëve do të jetë kryesisht kërkimore.

8.4.3. Për sa i përket përmirësimit të përmbajtjes së kërkimit shkencor është i nevojshëm rishikimi i prioritetëve kombëtare të zhvillimit, nën optikën e prioritetëve aktuale të zhvillimit të vendit.

8.4.4. Gjithashtu, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet vlerësimit të cilësisë së kërkimit shkencor, mbi bazën e rezultateve të së cilës do të akordohen financimet strukturore dhe ato programore nga Agjencia Kombëtare e Financimit (si tregohet në kapitullin 4). Ato do të përdoren edhe si tregues për akreditimin e programeve të IAL të C2 dhe C3.

8.4.5. Për përmirësimin e cilësisë së publikimeve dhe të produktit shkencor të financuar nga shteti, do të përdoret sistemi i "peer review" me ekspertë të huaj.

8.4.6. Përgatitja e punimeve shkencore në gjuhë të huaj, krahas asaj shqipe, do të mundësojë shfrytëzimin e botimeve shkencore edhe nga studiuesit e huaj, duke bërë që ajo të jetë e citueshme, gjë që do të sjellë një vlerësim më objektiv të veprimtarive shkencore të institucioneve dhe kërkuesve të veçantë.

8.4.7. Një hap i rëndësishëm do të jetë krijimi dhe mbajtja e përditësuar nga MAS-i, nëpërmjet agjencive apo institucioneve të saj varësisë, e një bazë të dhënash të Kërkimit Shkencor Kombëtar ku do të përfshihen:

o Të gjitha tezat e doktoratave dhe mikrotezat e masterave të mbrojtura apo që do të mbrohen. Për shmangien e plagjiaturave, për çdo doktoratë do të publikohet në gjuhë të huaj (në njërën nga 5 gjuhët kryesore të BE të studiuara në Shqipëri: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht) titulli dhe një përmbledhje (autoreferat). Po ashtu MAS ose strukturat e saj do të publikojnë, në njërën nga gjuhët e huaja të mësipërme, titujt dhe një përmbledhje të mikrotezave të mbrojtura në kuadrin e programeve të ciklit të dytë.

o Kontributi shkencor i të gjithë personelit akademik e kërkimor të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.

o Vendet e punës aktuale dhe ato të reja në të gjitha institucionet e kërkimit shkencor.

8.4.8. Për rritjen e pjesëmarrjes së Institucioneve të Kërkimit Shkencor në programet e BE dhe në ato tjera ndërkombëtare, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet trajnimit të personelit teknik të tyre për hartimin dhe menaxhimin e projekteve. Kjo do të realizohet nëpërmjet forcimit të kapaciteteve teknike të AKKSh në këtë drejtim, por edhe të çdo IAL.

8.4.9. IAL dhe institucionet kërkimore duhet të garantojnë komunikimin e informacionit për projekte dhe fonde kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare tek i gjithë personeli i tyre. Sigurimi i këtij procesi duhet të mbështetet dhe garantohet edhe nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) në nivel kombëtar për IAL publike, jo-publike dhe institucionet kërkimore.

## 8.5. Sugjerimet - Financimi

8.5.1. Financimi i Kërkimit Shkencor nga shteti do të jetë strukturor dhe programor.

8.5.2. Për IAL publike të pikës 1 (Universitetet, akademitë, kolegjet universitare) financimi strukturor do të jetë nga një "grant" i veçantë që do të jepet nga Agjencia Kombëtare për Financim për kërkimin shkencor, i cili do të shpërndahet në nivel departamenti dhe pastaj pedagogu.

8.5.3. Në shpërndarjen e tij në nivel institucioni të arsimit të lartë do të mbahen parasysht një sërë treguesish si:

o cilësia e produktit shkencor të prodhuar e

publikuar nga departamentet e këtyre institucioneve në një periudhë të caktuar (sugjerohet 3 deri në 4 vjeçare në kushtet aktuale), duke konsideruar edhe numrin e personelit akademik;  
o tipologjia e fushës së kërkimit shkencor ku vepron departamenti. Për fakultet/institute/qendra dhe departamente të shkencave teknike, mjekësore, bujqësore e natyrore masa e financimit strukturor do të jetë më e madhe se sa e atyre që veprojnë në fushën e shkencave humane;  
o projektet kërkimore ndërkombëtare e kombëtare ku merr pjesë departamenti apo pedagogu.


8.5.4. Ky financim do të menaxhohet në mënyrë transparente nga vetë departamenti. Ndarja e këtij financimi brenda departamentit midis grupeve kërkimore apo individëve do të bëhet me vendim të Këshillit të Departamentit duke u mbështetur mbi parimin e meritokracisë, në varësi të cilësisë dhe vëllimit të kërkimit që ata kryejnë dhe jo të shpërndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë anëtarët e departamentit pa dallim.

8.5.5. Një financim i veçantë strukturor do të jepet nga Agjencia Kombëtare e Financimit (AKF) për institutet dhe qendrat ndëruniversitare, ndërsa financimi i institucioneve të kërkimit të zbatuar do të bëhet nga ministritë përkatëse.

8.5.6. Financimi programor do të jetë 2 llojesh :  
o i pari, për Programet Kombëtare të Kërkim Zhvillimit, i ofruar nga AKKSh dhe që do të jetë i hapur për të gjitha Institucionet publike e jopublike të Kërkimit Shkencor  
o i dyti, për Programet e Kërkimit Universitar, i ofruar nga AKF për IAL publike dhe jopublike që zhvillojnë K. Sh (kategoritë e përfshira në pikën 1).

8.5.7. Këto financime do të jepen gjithmonë mbi bazë aplikimesh dhe do të jenë të pavarura.  
Figura 8.1. Organizimi Strukturor Institucional i Kërkimit Shkencor.

### ORGANIZIMI I KERKIMIT SHKENCOR



## IAL/Degë, me natyrë të veçantë

### Kapitulli 9

#### IAL/DEGË, ME NATYRË TË VEÇANTË

##### 9.1. Përshkrimi

9.1.1. Është e rëndësishme të fillojmë duke përmendur se cilët janë këto IAL dhe çfarë statusi gëzojnë ata sot në ndryshim nga IAL e tjera. Për arsye të diskutimit do t'i ndajmë këta IAL në tri grupe:

9.1.1.1. Me status të veçantë: Universiteti i Arteve, Universiteti i Sporteve; Akademia Ushtarake dhe ajo e Policisë; Universiteti i Mjekësisë. Këto IAL kanë status të veçantë nga IAL e tjera.

9.1.1.2. IAL-të Rajonale dhe Universiteti Bujqësor. Kjo jo për natyrën e tyre specifike, se ata janë të ngjashëm me IAL e tjera, por më shumë për zgjidhjen afatgjatë që mendojmë për këto IAL do t'i klasifikojmë së bashku

9.1.2. Grupi i parë janë IAL vërtet me natyrë të veçantë në shumë gjëra të organizimit të tyre; mësimdhënies; punës krijuese; pranimit të studentëve dhe deri tek financimi. Këto IAL janë dhe duhen trajtuar ndryshe.

9.1.3. Në grupin e dytë hyjnë IALt rajonale, dhe Universiteti Bujqësor. Këto nuk kanë status të veçantë në krahasim me IAL e tjera. Sidoqoftë ne do i trajtojmë në këtë kapitull për arsye të ardhmes së përbashkët që ky komision sugjeron për ta dhe për arsye të traditës se formimit të tyre në kushtet e Shqipërisë. Universitetin Bujqësor do ta trajtojmë në këtë kapitull për arsye të rëndësisë strategjike për zhvillim që ka ky universitet.

9.1.4. IALt me natyra specifike të fushës së tyre të studimeve apo me status special janë kryesisht IAL publike. Ato funksionojnë sipas Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Statuti është dokumenti bazë i veprimtarisë së këtyre IALve. Misioni i Universitetit me status special është ofrimi i arsimit të lartë profesional dhe veprimtarive krijuese e kërkimore në fushat e tyre të studimit si dhe formimi i studiuesve të rinj në fushat teorike të

studimit dhe ndërmarrja e studimeve kërkimore e shkencore për zhvillimin e promovimin e fushave të tyre të studimit.

9.1.5. Organet drejtuese e kolegjinale në IALt me status special, si në të gjitha publike, i nënshtrohen procesit të zgjedhjeve. Trupa zgjedhore përbëhet nga stafi akademik, stafi administrativ dhe studentët, të ndarë sipas peshës specifike të votës që ka secili grup. Trupa zgjedhore i nënshtrohet procesit të votimit për të zgjedhur organet drejtuese të universitetit në nivel Rektori, Dekani apo Përgjegjësi Departamenti. Gjithashtu, trupa zgjedh dhe organet kolegjinale të Universitetit si Këshilli Administrimit, Senati Akademik dhe Këshilli i Fakultetit, Mandati i drejtuesve dhe organeve të zgjedhura është 4 vjet.

9.1.6. IAL me status special, si të gjitha IALt publike funksionojnë mbi bazën e veprimtarisë së fakulteteve apo njësive themelore. Secili fakultet e bazon veprimtarinë e tij në bazë të veprimtarisë së departamenteve, njësive bazë që kryejnë veprimtarinë mësimore dhe kërkimin shkencor.

9.1.7. Struktura e organizimit të procesit mësimor realizohet sipas Kartës së Bolonjës, me tri cikle studimi. Cikli i parë është niveli bachelor me tri vite studimi me 180 kredite. Cikli i dytë është niveli master me dy vite studimi me 120 kredite. Cikli i tretë janë programet e doktoratës. Struktura e vitit shkollor është e ndarë në semestrin e dimrit dhe semestrin e pranverës.

9.1.8. Kuotat e hyrjes së studentëve në IAL me status special përcaktohen nga MAS. Hyrja e studentëve në IAL me status special realizohet me konkurs. Modeli i përzgjedhjes së studentëve është kombinimi i rezultateve akademike të shkollës së mesme me rezultatet e arritura në konkursin në një fushë specifike të studimit.

9.1.9. Aktiviteti i stafit akademik në IAL me status special i nënshtrohet akteve në fuqi mbi normimin e punës së stafeve akademik në universitete. Aktiviteti akademik është i ndarë në përgatitjen për mësimdhënie, kërkimin shkencor dhe punën në mbështetje të institucionit. Procesi i mësimdhënies në këto IAL realizohet në kushte specifike. Ky

proces kushtëzohet nga natyra specifike e këtyre IAL, ku mësimdhënia ka veçoritë e saj specifike. Ajo në disa raste mund të zhvillohet edhe në formë individuale ose me grupe prej disa studentësh.

9.1.10. Aktiviteti shkencor i universitete me status special bazohet në kontributin që jep stafi akademik për ndërmarrjen e kërkimit shkencor në hulumtimin e problemeve teorike të fushave të ndryshme të studimit dhe në realizimin e veprimtarive dhe aktiviteteve të ndryshme profesionale brenda e jashtë vendit.

9.1.11. Financimi i IAL me status special bazohet tek skema e financimit që është e njëjtë për të gjitha universitete publike në Shqipëri. Financimi i tyre realizohet nga granti i pakushtëzuar që financohet nga MAS. Ky grant shërben për pagesat e stafit akademik dhe siguracioneve shoqërore. Një financim tjetër vjen nga të ardhurat dytësore që janë pagesat e tarifave të shkollimit të studentëve. Ky burim shërben për të mbuluar të gjitha shpenzimet e tjera koherente në universitet, si dhe mbulimin e pagesave të pedagogëve të jashtëm e madje edhe për mbingarkesën e stafit akademik. Një drejtim tjetër ku mund të gjenerohen fonde janë dhe aplikimet në bazë të projekteve për investime kapitale në IAL apo dhe financimi që vjen nga veprimtaria me të tretët, veprimtari që kryhet sipas legjislacionit në fuqi.

## 9.2. Problematikat

9.2.1. Është e rëndësishme që të përmendim që në fillim të këtij seksioni se problematika e përbashkët e këtyre institucioneve është e ngjashme me atë të IAL të tjera. Sidoqoftë këtu duhet të përmendim edhe disa nga problemet specifike që dalin nga natyrat e ndryshme të këtyre IALve.

9.2.2. Jo gjithçka që ka të bëjë me këto IAL mund të përshkruhet në këtë kapitull, por disa gjëra të rëndësishme do të mund t'i adresojmë.

9.2.3. IALt me status special gjatë funksionimit të tyre kanë të njëjtat probleme që kanë edhe IAL e tjera publike. Por, për vetë natyrën e tyre specifike të procesit të mësimdhënies, ato kanë dhe disa probleme që janë specifike për statusin e tyre.

9.2.4. Natyra e procesit të mësimdhënies në këto IALkërkon që realizimi i formimit profesional të studentit të mbështetet në raporte të veprimtarive formuese, ku formimi praktik ka një peshë më të lartë dhe procesi i mësimdhënies mund të

realizohet deri në nivele individuale me studentin apo mbi mësimdhënien me grupe të vogla studentësh. Ky proces kërkon rekrutimin e një numri të madh pedagogësh të jashtëm (të ftuar) për të realizuar procesin e mësimdhënies. Ky rekrutimi krijon vështirësi në administrimin me efektivitet të këtij procesi si nga ana organizative, ashtu edhe nga ana ekonomike, duke mos lënë mënjanë vështirësinë në identifikimin e stafeve të përshtatshme për këto drejtime në komunitetin e kufizuar akademik të vendit.

9.2.5. Specifika e procesit të mësimdhënies në këto IAL kërkon domosdoshmërisht prezencën e një baze materiale dhe teknike sipas kërkesave që shtron teknologjia e kohës. Kjo kërkesë nxjerr në pah nevojën për rinovimin e vazhdueshëm të teknologjisë në ndihmë të formimit profesional të studentëve. Por amortizimi i saj në vite dhe pamundësia financiare e këtyre institucioneve për rinovimin e saj në kohë, krijojnë vështirësi në realizimin me efikasitet të procesit të mësimdhënies me studentët. Ndërkohë prezenca e kësaj baze materiale është e domosdoshme në procesin e mësimdhënies, ndryshe nga roli që luan mungesa e bazës materiale apo mjeteve didaktike në fusha të tjera studimi në shkollën e lartë. Prezenca e kësaj baze teknike mjeteshe në ndihmë të mësimdhënies lidhet direkt me realizimin e mësimdhënies me studentët. Mungesa e saj bllokoi procesin e mësimdhënies në këto programe specifike.

9.2.6. Një tjetër problem është pamundësia e stafit akademik për pjesëmarrje të gjerë në seminare apo aktivitete profesionale jashtë vendit, ngjarje këto që ndihmojnë stafin akademik për të krahasuar vlerat e tij profesionale me kolegët dhe për t'u njohur me përvojën e kolegëve jashtë Shqipërisë. Mungesa e burimeve financiare për këto aktivitete, ka kufizuar ballafaqimin e vlerave të stafit akademik me kolegët jashtë Shqipërisë dhe ka vendosur aktivitetin profesional të stafit vetëm mbi baza të mundësive apo sponsorizimeve individuale. Mungesa e fondeve për pjesëmarrjen e stafit akademik në veprimtari të ndryshme profesionale, duke u bashkuar edhe me problemin që ka në tërësi kërkimi shkencor në IAL shqiptare, krijon vështirësi për zhvillimin profesional të stafit akademik.

9.2.7. Problem në IALt me status (veçanërisht IALt e grupit parë) special është dhe numri i ulët i studentëve. Natyra specifike e hyrjes së studentëve në këto IAL dikton numrin e ulët të studentëve. Procedura e konkurrimit në tërësi, duke u bashkuar me nevojat e tregut të punës dhe me infrastrukturën e nivelin cilësor të studentëve,



ndikojnë që numri i studentëve të jetë i vogël. Ky numër i vogël studentësh gjeneron të ardhura të pakta nga pagesat e ulëta të tarifave të shkollimit të studentëve. Një fakt i tillë, krahasuar me numrin e lartë të studentëve në IALt publike, krijon vështirësi për funksionimin cilësor të mësimdhënies e kërkimit shkencor në këto IAL, por edhe disavantazh në aspektin e financimit të këtyre IAL.

9.2.8. Problem tjetër në IALt me status special është infrastruktura fizike. Procesi mësimor, për vetë natyrën specifike në këto IAL, kërkon ngritjen e objekteve të reja për t'iu përshtatur natyrës specifike që kërkon formimi profesional i studentëve në këto fusha. Kërkesat specifike të programeve për formimin profesional të studentëve kërkojnë objekte me kërkesa bashkëkohore që sigurojnë kushtet për vënien në jetë të programit mësimor dhe ristrukturimin e infrastrukturës ekzistuese, Ky problem është i ndjeshëm dhe kërkon zgjidhje institucionale për investime kapitale.

9.2.9. Natyra specifike e studimit në IAL dhe degët në IAL-ve të tjera me status special, ndikon që kostoja për përgatitjen e një studenti të jetë e lartë. Analiza financiare tregon se kostoja për përgatitjen e një studenti është disa herë më e lartë se përgatitja për një student në një degë "normale" të arsimit të lartë. Por pagesa e shkollimit të studentit në këto IAL specifike mbetet në nivele të ulëta, krahasuar me koston e tij. Ky fakt ndikon që një përqindje e lartë e të ardhurave që grumbullohen nga ky aktivitet të shkojnë në shërbim të pagesave të stafit. Kjo situatë limiton maksimalisht shpenzimet për investime apo operacione të tjera gjeneruese në këto IAL me status special dhe jep efekte negative në cilësinë e mësimdhënies e kërkimit shkencor.

9.2.10. Pavarësisht faktit se kostoja e përgatitjes së një studenti në IALt me status special, kërkon financime të larta, përsëri formula aktuale e financimit, i kategorizon këto IAL në të njëjtën kategori me IAL e tjera publike që mund të kenë një numër të madh studentësh dhe një kosto të ulët të përgatitjes për një student. Një kategorizim i tillë ndikon që IAL me status special të përfitojnë pak fonde nga zëri mbi pagesat e studentëve. Niveli i ulët i financimit që përfitojnë IALt me status special nga skema aktuale e financimit të IAL, është pengesë serioze për të zhvilluar standardet e kërkuara në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në universitet.

### 9.3. Sugjerime

9.3.1. Është e rëndësishme të përmendim këtu se sugjerimet e bëra në këtë raport për ndryshimet strukturore brenda IAL-ve aplikohen edhe për këto IAL me status specifik. Në rastet kur ka ndryshim do të përmenden në këtë seksion. Gjithashtu aksesit në financimin publik të shtetit nga ana e këtyre IAL-ve me natyrë speciale do të mbetet i njëjtë. Në fakt ky seksion sugjeron edhe alternativa të tjera financimi për këto raste të veçanta.

9.3.2. Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet që ana mësimore e veprimtarisë së këtyre IALve është dhe duhet të mbetet në varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, që ka të gjitha mekanizmat e kontrollit të cilësisë dhe është përgjegjëse në vend për arsimin e lartë në Shqipëri.

9.3.3. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtyre institucioneve është edhe statusi që ato kanë për sa i përket llojit të institucioneve të arsimit të lartë që ato përfaqësojnë. Është në sugjerimet e këtij Komisioni që statusi që kanë këto institucione të mbetet i njëjtë me atë që kanë për momentin. Vetëm në rastet kur stafi akademik i këtyre institucioneve kërkon në maxhorancë një ndryshim të tillë kjo mund të konsiderohet nga organizmat përkatëse të Ministrisë së Arsimit.

9.3.4. Krahas ndërhyrjeve sugjeruese që nxisin performancën në organizimin dhe funksionimin në tërësi të IALve, ka dhe disa sugjerime që ndikojnë direkt vetëm mbi performancën e IALve me status special.

9.3.5. Hyrja e studentëve në IALt me status special duhet t'i nënshtrohet idesë se është një investim kombëtar me impakt mbi jetën e shoqërisë shqiptare. Kjo do të thotë se, pavarësisht zhvillimeve të tregut të punës, programet e studimit në këto degë speciale duhet të kenë vazhdueshmëri sepse janë një investim për shoqërinë shqiptare .

9.3.6. Pranimi i studenteve në IAL speciale duhet të realizohet me konkurs përpara një jurie profesionistësh të fushës. Konkursi do të shërbejë si mjet kontrolli për të menaxhuar prurjet e studentëve që pretendojnë se kanë të dhëna apo aftësi speciale dhe për të zgjedhur ata që kanë aftësitë më të përshtatshme për të vazhduar studimet.

9.3.7. Nota mesatare e hyrjes së studentëve në IALt me status special dhe që i nënshtrohen konkurrimit, duhet të jetë e ndryshme nga nota mesatare që

mund të vihet si kriter për të fituar të drejtën për të studiuar në shkollën e lartë. Kjo do të thotë se nëse në ligj ka një notë mesatare minimale për të aplikuar për në shkollën e lartë, atëherë kjo notë mesatare për të aplikuar për në universitetet me status special duhet të jetë më e ulët. Ulja e kufirit të notës mesatare për të aplikuar në universitete me status special duhet për faktin se aplikanti konkurrin për aftësitë e talentin që ka në një fushë të caktuar.

9.3.8. Agjencia e Aplikimit të Studentëve duhet të ponderoj peshën e secilit element të procedurës së konkursit për pranimet në këto universitete, Ky akt duhet të ndodhi vetëm pasi të ketë marrë propozimet e universiteteve, Institucionet e arsimit të lartë janë më të specializuara për të përcaktuar peshën e secilit element në procesin e konkurrimit. Propozimet e tyre do të kenë vlerë për institucionet vendimmarrëse.

Përcaktimi i numrit të studentëve fitues duhet të jetë kompetencë e vetë universiteteve me status special, duke lejuar tolerancë nga një numër minimal deri tek një numër maksimal fituesish në një degë të caktuar. Toleranca mbi numrin e fituesve shërben për të përcaktuar më mirë konkurrentët me aftësi afërsisht të njëjta dhe për të mos krijuar ndërç për përjashtime midis të barabartëve vetëm duke u nisur nga një numër i fiksuar hyrjesh. Por kjo duhet të jetë natyrisht në përputhje me standardet akademike të cilësisë.

9.3.9. Natyra specifike e organizimit të procesit të mësimdhënies në universitete me status special duhet të parashikojë të drejtën e tyre që të rregullojnë vetë këtë proces, duke e bërë atë pjesë të lirisë akademike. Ato duhet të kenë të drejtë që të rregullojnë vetë veprimtarinë e departamenteve në lidhje me përcaktimin e numrit të stafit, ngarkesën mësimore të stafit, llogaritjen e normës mësimore, rekrutimin e stafit, kontrollimin e praktikave profesionale, punën kërkimore e shkencore, hartimin e sillabuseve, programet lëndore, analizën e mësimdhënies, etj. Format e organizimit të procesit të mësimdhënies në këto universitete të përcaktohen nga specifikat që shpreh secili departament në procesin e realizimit të mësimdhënies me studentët.

9.3.10. Universitete me status special të kenë të drejtë të bëjnë një shpërndarje më fleksibël të fondeve në dispozicion, Departamentet të kenë mekanizmat që të jenë hallka kryesore për planifikimin, administrimin dhe vënien në jetë të buxhetit financiar.

9.3.11. Të hartohen instrumentet për të bërë të mundur që aktivitetet specifike profesionale të zhvillohen nga stafi akademik i universiteteve me status special, të përkthehen me parametra mbi kërkimin shkencor dhe/apo krijimtarinë artistike, parametra mbi të cilat vlerësohet stafi akademik në universitete që nuk kanë këtë status. Kjo do të thotë se aktivitetet profesionale që zhvillojnë stafet akademik të universiteteve me status special, si për shembull aktivitete artistike apo sportive, të konvertohen nëpërmjet instrumenteve vlerësues në prodhimtari shkencore të këtyre stafeve dhe të shërbejnë për të vlerësuar performancën e tyre në fushën e kërkimit shkencor. Kjo mënyrë konvertimi do të mundësojë që departamentet të marrin pjesë edhe në rankimin universitar për të përfituar fonde nga kërkimi shkencor.

9.3.12. Financimi i Universiteteve me status special duhet të marrë në konsideratë numrin e ulët të studentëve në këto institucione. Ky fakt duhet të parashikohet në procesin e përlogaritjes për financimet nga granti për mësimdhënie apo kërkim shkencor. Koeficientet e financimit që mund të bazohen mbi numrin e studentëve për subvencionimin e këtyre universiteteve duhet të jenë më të larta se ato të universiteteve që kanë numër të madh studentësh. Pësha e financimit nga këto grante, e bazuar mbi numrin e studentëve për këto universitete, duhet të jetë në përqindje më të madhe se e universiteteve të tjera.

9.3.13. Financimin e Universiteteve me status special me një grant për mbulimin e shpenzimeve që duhen për sigurimin dhe rinovimin e mjeteve didaktike dhe teknike të cilat janë në shërbim të procesit mësimor dhe të domosdoshme për realizimin e përgatitjes së studentëve. Ky grant financimi mund të planifikohet nga granti për zhvillim.

9.3.14. Një tjetër sugjerim për financimin e Universiteteve me natyrë specifike është dhe financimi i dyfishtë buxhetor që këto institucione duhet të përfitojnë. Komisioni mendon se nga ana financiare këto institucione duhet të jenë në varësi të dyfishtë, nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe nga Ministria përkatëse. Për shembull në rastin e Universitetit të Arteve në financimin e projekteve mund dhe duhet të financojë edhe Ministria e Kulturës. Në rastin e Universitetit të Mjekësisë, Ministria e Shëndetësisë financon në Spitalin universitar dhe në gjithë punën laboratorike të domosdoshme për mësimdhënie.

9.3.15. Hartimin e bazës ligjore për të mundësuar

marrjen e të ardhurave nga vetë institucioni për një objekt tregtar që mund të krijojë universiteti me status special dhe shfrytëzimin e burimeve të ndryshme që vendosen në shërbim të publikut. Kjo paketë ligjore do krijojë mundësitë për ndarjen e të ardhurave që gjenerohen nga objekti tregtar, të cilat shkojnë një pjesë për institucionin dhe një pjesë për shpërblimin e autorëve apo protagonistëve të krijimit të këtij objekti tregtar.

9.3.16. Universitetet me status special, duke pasur numër të ulët studentësh dhe kosto të lartë të përgatitjes për student, kërkojnë vendosjen e tarifave të diferencuara mbi pagesat e shkollimit të studentëve, në dallim nga degët e universiteteve të tjera. Tarifat e shkollimit të studentëve në këto universitete, duke qenë më të larta, sipas kostonë së përgatitjes për student, mund të rimbursohen pjesërisht edhe nga shteti për të ulur barrën ekonomike të studentëve në këtë universitet.

9.3.17. Programet e studimit që zhvillohen në universitetet rajonale dhe që u përkasin fushave të studimit që kanë edhe universitetet me status special, të fokusohen në prodhimin e diplomave të integruara në fushat e edukimit. Ato mund të përgatisin mësues jo vetëm për degën speciale të studimit, por dhe për lëndë të tjera të përafërta.

9.3.18. Universitetet me status special duhet të kenë gatishmëri të aplikojnë edhe sistemin e kontratës me MAS-in dhe Ministrinë përkatëse, për përdorimin me efikasitet të fondeve. Në kontratë të dy pjesëmarrësit do të vendosin detyrimet e tyre dhe do të bien dakord për mjetet e monitorimit. Kontrata mund të jetë një tip granti, dorëzuar universitetit.

## 9.4. Universiteti i Arteve (UART)

9.4.1. Universiteti i Arteve është universitetet publik me karakter akademik, artistik dhe shkencor. UART funksionon përmes Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. UART funksionon mbi bazën e tri fakulteteve: Fakulteti i Arteve të Bukura; Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Muzikës.

9.4.2. Forma e studimit në UART është me kohë të plotë. Hyrja e studentëve në UART realizohet me konkurs. Kuotat e hyrjes së studentëve vijnë nga MAS. Modeli i përzgjedhjes së studentëve është kombinim i rezultateve akademike të shkollës së mesme me rezultatet e arritura në konkursin në një fushë specifike të artit.

9.4.3. Procesi i mësimdhënies realizohet në kushte specifike. Ai kushtëzohet nga natyra e punës mësimore në shkollën e artit, ku mësimdhënia realizohet kryesisht në formë individuale ose me grupe prej 3 – 4 studentësh.

9.4.4. Aktiviteti shkencor i UART bazohet në kërkimin shkencor për hulumtimin e problemeve teorike në fushat e artit dhe në kontributin që stafi jep për realizimin e veprimtarive artistike brenda e jashtë vendit.

9.4.5. Financimi i UART bazohet tek skema me të cilën funksionojnë universitetet publike në Shqipëri. Ai nuk ka trajtim të veçantë si rezultat i specifikave që ka.

### Sugjerime – Specifike

9.4.6. Hyrja e studentëve në UART; duhet t'i nënshtrohet idesë se është një investim kombëtar; të realizohet me konkurs përpara një jurie profesionistësh të fushës; të eliminohet barriera e notës mesatare; modeli i hyrjes dhe i numrit të studentëve fitues në UART duhet të jetë kompetencë e vetë Universitetit.

9.4.7. Raporti pedagog/student në realizimin e procesit të mësimdhënies, të përcaktohet nga vetë specifika që shpreh ky proces në departamentet e ndryshme të UART.

9.4.8. Financimi nga shteti në formën e grantit i UART duhet të marrë në konsideratë numrin e ulët të studentëve në këtë institucion. Koeficientët për subvencionimin e UART për këto zëra duhet të jenë të ndryshëm nga llogaritjet për universitetet e tjera.

9.4.9. Financimi i UART me një grant për mbulimin e shpenzimeve për sigurimin e logjistikës dhe teknikës didaktike në shërbim të procesit mësimor dhe krijues, mund të ofrohet prej grantit të zhvillimit në MAS, por edhe prej Ministrisë së Kulturës.

9.4.10. UART duke pasur numër të ulët studentësh dhe kosto të lartë të përgatitjes për student, duhet të ketë tarifave të diferencuar mbi pagesat e shkollimit, ndryshe nga degët e universiteteve të tjera, Këto tarifa duke qenë më të larta, mund të rimbursohen pjesërisht edhe nga shteti.

## 9.5. Universiteti i Sporteve (UST)

9.5.1. Universiteti i Sporteve është universitetet publik me karakter akademik, sportiv dhe shkencor. UST ka tri njësi themelore; Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarive Fizike dhe Rekreacionit, dhe Institutin e Kërkimeve Shkencore të Sportit i krijuar mbi bazën e Qendrës Kërkimore Shkencore të Sportit

9.5.2. UST është përfshirë në një proces të thellë ristrukturimi e riformatimi të drejtuar dhe koordinuar nga konsorciumi kryesor i Rrjetit EU të Universiteteve të Sportit, ku përfshihen: Universiteti i Sportit Romë, Universiteti i Vjenës, Universiteti i Danimarkës së Jugut, Odense, e të tjerë.

9.5.3. Universiteti i Sportit, si institucion unik i fushës së Aktivitetit Fizik dhe Sportit, ofron programe studimi për të tri ciklet, në kuadër të dy fakulteteve. Diplomat janë të orientuara sipas kërkesave të tregut të punës dhe sipas standardeve të rrjetit Evropian të Universiteteve të Sportit, referuar standardeve të AEHESIS.

9.5.4. Hyrja e studentëve në UST realizohet me anë të testeve sportive, që përbëjnë 50% të pikëve dhe 50% tjetër nga nota mesatare. Për programe të ndryshme aplikohen teste të ndryshme. Në ciklin e dytë të studimeve pranohen vetëm studentët që kanë rezultate 80% e lartë.

9.5.5. Kërkimi i aplikuar është zhvilluar në fushën e Shkencave Sportive dhe së fundmi janë ngritur tre laboratorë të rinj në funksion të kërkimit dhe mësimdhënies. Veprimtaria shkencore është mbështetur dhe zhvillohet gjithmonë në bazë të bashkëpunimit e standardizimeve që ka fusha e Shkencave Sportive në nivel evropian e botëror. Sugjerime – Specifike

9.5.6. Në mënyrë që edukimi fizik të lidhet edhe me tregun e punës sugjerojmë që programet e studimit të fushës së edukimit fizik dhe sportit që janë në zhvillim nga IAL e tjera në vendin tonë të fokusohen në prodhimin e diplomave të integruara në fushat e edukimit si p.sh: mësues i edukimit fizik dhe historisë; gjeografisë; edukimit shëndetësorë etj. Është jo produktive vazhdimi i prodhimit të diplomave thjesht të mësuesve të edukimit fizik.

9.5.7. Edhe për UST sikurse për UART-in raporti pedagog/student në realizimin e procesit të mësimdhënies të përcaktohet nga vetë specifika që ka ky institucion.

9.5.8. Financimi nga shteti në formën e grantit duhet të marrë në konsideratë numrin e ulët të studentëve në këtë institucion. Gjithashtu, granti duhet të mbulojë edhe shpenzimet për sigurimin e logjistikës dhe teknikës didaktike në shërbim të procesit mësimor.

## 9.6. Universiteti i Mjekësisë

9.6.1 Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është universitetet publik me karakter akademik, mjekësor dhe shkencor. UMT funksionon përmes Ligjit të Arsimit të Lartë, Statutit dhe Rregullores së UMT.

9.6.2. UMT ka në përbërjen e vet 5 fakultete: Fakulteti i Mjekësisë (FM), Fakulteti i Mjekësisë Dentare (FMD), Fakulteti i Farmacisë (FF), Fakulteti i Shëndetit Publik dhe (FSHP), Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Teknike (FSHMT).

Në Universitetin e Mjekësisë ndjekin studimet rreth 10.000 studentë. Kuotat e pranimit të studentëve vijnë nga MAS.

9.6.3. Format e studimit në këto fakultete janë si më poshtë:

- Fakulteti i Mjekësisë Dentare dhe Fakulteti i Farmacisë - studime të integruara të nivelit të dytë DND dhe me kohë të plotë.
- Fakulteti i Shëndetit Publik është i organizuar sipas sistemit të Bolonjës, bachelor dhe master profesional dhe shkencor, me kohë të plotë.
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Teknike është i organizuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme; studime të nivelit të parë sipas sistemit të Bolonjës, master profesional dhe shkencor. Gjithashtu ka dhe sistem filiali në Sarandë dhe Kukës.

Financimi i UMT për pagat dhe sigurimet bëhet nga buxheti i shtetit, ndërsa investimet dhe shpenzimet mbuloohen nga të ardhurat dhe tarifat e shkollimit, skemë me të cilën funksionojnë të gjitha universitetet publike në Shqipëri. UMT nuk ka asnjë trajtim të veçantë financiar si rrjedhojë e specifikave që ka.

### Sugjerime – Specifike

9.6.4. Procesi i mësimdhënies në një pjesë të mirë të UMT-së (FM, FMD...) realizohet në kushte specifike; në universitet, por sidomos në QSUT, në shtratin e të sëmurit, në kabinetet mjekësore, sallat e operacioneve, etj. Normalisht, kjo formë

mësimdhënieje duhej të garantojë që studenti, me të mbaruar studimet universitare, të jetë në gjendje të diagnostikojë dhe mjekojë pacientin në mënyrë të pavarur. Aktualisht, kjo nuk ndodh për arsye të; mënyrës se si zhvillohet mësimdhënia; mungesës së praktikës së mjaftueshme të studentit në shërbimet përkatëse; mospërfshirjes së tij në punën kërkimore - shkencore. Për këtë arsye ne sugjerojmë që klinikistët e Qendrës Spitalore, të kenë detyrim kontraktual që të përfshihen në procesin mësimor.

9.6.5. Aktiviteti shkencor i UMT-së duhet të jetë pjesë integrale e jetës shkencore të klinikave universitare, gjë që do ta bënte studentin tonë të mjekësisë, si kudo në botë, pjesë integrale të studimeve të mirëfillta shkencore në nivelin nacional dhe ndërkombëtar. Me përfundimin e studimeve universitare, përvoja e studentit tonë të mjekësisë në lidhje me kërkimin shkencor është e tillë që nuk i lejon atij të japë një gjykim shkencor mbi një artikull për botim. Kjo, është shumë e rëndësishme për ta bërë mjekun tonë të ardhshëm pjesë të debatit shkencor të komunitetit mjekësor kombëtar e ndërkombëtar. Prandaj theksojmë se performanca e pedagogut duhet matur edhe në lidhje me përfshirjen e studentit në kërkimin shkencor.

9.6.6. Nga pikëpamja organizative dhe strukturore, edhe pse në përgjithësi në harmoni të plotë me IAL-të e tjera të vendit, UMT ofron një specifikë të rëndësishme për shkak të lidhjes së domosdoshme organike me aktivitetin e QSUT-së. Elementet kyçe dhe shumë domethënëse, që i japin UMT-së këtë status specifik janë: shërbimet; njësitë përbërëse të departamenteve, aktiviteti praktik i së cilave realizohet në Universitet dhe në QSUT. Këto njësi janë praktikisht bërthama shumë të rëndësishme, jo vetëm akademike dhe shkencore, por edhe të punës me të sëmurët. Të gjitha linjat guidë të diagnostikimeve dhe mjekimit, në nivel kombëtar, përcaktohen nga këto shërbime. Drejtimi i këtyre shërbimeve është i një rëndësie shumë të madhe dhe përzgjedhja e drejtuesve duhet të reflektojë këtë specifikë në raport me universitetet e tjera jo të veçanta. Sugjerohet që përzgjedhja e shefave të shërbimit, të bëhet me konkurrim të përgjithshëm, ku në grupin intervistues të marrin pjesë anëtarë të UMT-së, por edhe të Ministrisë së Shëndetësisë.

9.6.7. Kriteret për zgjedhjen e shefave të Shërbimit pranë departamenteve sugjerohet të jenë: Titulli më i lartë; Vjetërsia e titullit; Vjetërsia pedagogjike (të pakten 15 vjeçare si pedagog i brendshëm); Botimet jashtë dhe brenda vendit; Aftësi

organizative; Organizim i aktiviteteve shkencore; Pjesëmarrja në Projekte Ndërkombëtare; Moshë e cila duhet t'i lejojë të mbyllë mandatin 4 vjeçar.

## 9.7. Akademia e Policisë

### 9.7.1. Histori

9.7.1.1. Shkolla e Lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme u krijua në 1971 dhe kalon si Institucion i Arsimit të Lartë (jo universitar) në 1972. Diploma titullohej "Oficer policie". Në vitin 1980 emërtohet "Shkolla e Lartë e Ministrisë së Brendshme", dhe njesohet me Shkollat e Larta të sistemit universitar si në drejtim të planeve dhe programeve mësimore, ashtu edhe të aktivitetit kërkimor - shkencor. Në vitin 1992 ajo riemërohet me emrin "Akademia e Rendit Publik". Në vitin 2000 krijohet Akademia e Policisë, duke u ndërmarrë një seri ndryshimesh si në programet mësimore, ashtu dhe në organizimet strukturore. Diploma titullohej "Specialist i Lartë Policie" Në vitin 2003 hartohen programet e para dhe filloi funksionimi i "Qendrës Pasuniversitare" me diplomën "Master në Fushën e Sigurisë".. Akademia e Policisë në vitin 2005 "akreditohet me kusht" nga Qendra e Akreditimit, por jetëgjatësia e këtij akreditimi ishte e shkurtër për shkak të ndërthurjes së një sistemi arsimor policor të afruar nga misioni policor ICITAP (konsulentë për strukturat e policisë - SHBA). Pas një procesi organizimi, insitucioni emërohet "Qendra e Formimit Policor", në vitin 2009.

9.7.1.2. Qendra e Formimit Policor, aktualisht, përgatit punonjës të nivelit zbatues, kryesisht punonjës policie, patrulle etj, nëpërmjet zhvillimit të programit mësimor të balancuar mes kohëzgjatjes teorike dhe asaj praktike.

9.7.1.3. Qendra e Formimit Policor funksionon si një institucion arsimor që formon dhe përgatit oficerët e policisë për nivele dhe grada të ndryshme në zbatim të kërkesave të ligjit për policinë e shtetit.

9.7.1.4. Qendra e Formimit Policor është e përbërë nga 7 sektorë, të ndarë në 15 seksione të cilat mbulojnë planifikimin e trajnimeve, si dhe hartimin e programeve mësimore për realizimin e shkollimit në nivelin bazë policor, si dhe shkollimin e trajnimit në niveleve të mesme dhe të larta policore.



## 9.7.2. Problematika

9.7.2.1. Kjo strukturë arsimore nuk mundet që t'i përgjigjet kërkesave kryesisht për hetimi, menaxhimi dhe zbulimi të veprave penale.

9.7.2.2. Specialistët e policisë nuk përgatiten me një formim të plotë profesional juridik për plotësimin e detyrimeve të tyre ligjore.

9.7.2.3. Studentëve nuk u krijohen hapësira informuese dhe kualifikuese, si në nivelin bachelor dhe më pas në nivelin master.

9.7.2.4. Ka një mungesë në zhvillimin e programeve të studimit bachelor dhe master në fushën e sigurisë publike

## 9.7.3. Sugjerime

9.7.3.1 Akademia e Policisë duhet të respektojë angazhimet, parimet dhe përvojat e shkollave më të mira simotra në kuadër të angazhimit në NATO dhe BE, për t'u kthyer në një IAL elitare në ngritjen e kapaciteteve të formimit policor.

9.7.3.2. Sistemit të arsimit policor, në kushte gjithnjë e në rritje të kërkesave që ka komuniteti për një polici profesionale dhe korrekte në shërbim të tyre, duhet t'i krijohen kushte ligjore për dhënien e një "statusi" më të lartë.

9.7.3.3. Përfshirjen në ligjin e arsimit të lartë shqiptar të institucionit arsimor për Policinë e Shtetit dhe krijimin e hapësirave ligjore për funksionimin e tij sipas këtij ligji.

9.7.3.4. Krijimin e hapësirave ligjore për dhënien e mundësive për bashkëpunim si me institucionet e tjera të larta arsimore në vend dhe me ato jashtë vendit.

9.7.3.5. Krijimin e mundësive për njohjen dhe transferimin e krediteve në institucione të tjera të larta arsimore dhe njohjen apo unifikimin e moduleve apo lëndëve mësimore.

9.7.3.6. Krijimin e hapësirave ligjore për kualifikimin dhe specializimin e vazhdueshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të agjencive të tjera të sigurisë publike, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

9.7.3.7. Koha, kushtet, problematikat profesionale, kualifikimi dhe ecuria në karrierë e punonjësit të policisë, kërkon bashkë me zhvillimin arsimor edhe ringritjen e një institucioni me parametra të një institucioni të arsimit të lartë i cili mund të emërtohet: "Akademia e Sigurisë Publike".

## 9.8. Akademia Ushtarake

### 9.8.1. Gjendja aktuale

9.8.1.1. Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), është Institucioni më i lartë i Arsimit Ushtarak. Aktualisht përbëhet nga Fakulteti i Arsimit të Përgjithshëm (FAP), i cili përgjigjet për organizimin dhe zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të parë "Bachelor", si dhe nga Fakulteti i Sigurisë dhe i Mbrojtjes (FSM), që zhvillon programe studimi për ciklin e dytë dhe të tretë. Të dy njësitë kryesore të punës mësimore - shkencore kanë si objekt kryesor studimet në Fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes.

9.8.1.2. Akademia e Forcave të Armatosura ka nisur në stadin aktual programet për vlerësim në Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) dhe është në pritje të zyrtarizimit të tyre nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe Ministria e Mbrojtjes.

9.8.1.3. Kandidatët që përzgjidhen në akademitë ushtarake vijnë kryesisht nga arsimi i mesëm pas disa testeve specifike, karakteristike për natyrën e arsimit ushtarak. Gjithashtu, afrohen edhe kandidatë nga universitetet e tjera, nëpërmjet transferimit të krediteve. Numri i kandidatëve që përzgjidhen për të vazhduar këtë program studimi, janë në vartësi të politikave të arsimit dhe nevojave të Forcave të Armatosura.

9.8.1.4. Akademia e Forcave të Armatosura realizon programe studimi "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave", në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Këto programe janë hapur dhe zhvillohen në Akademinë e Forcave të Armatosura qysh prej vitit shkollor 2011 – 2012. Kontingjentet që vazhdojnë programet master janë kryesisht nga radhët e Forcave të Armatosura, si dhe nga institucionet e sigurisë së vendit si Presidenca, Kryeministria, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, Ministria e Drejtësisë etj.

9.8.1.5. Skema e pranimeve të studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë, mban parasysh Standardet Shtetërore të Arsimit të Lartë.

Ajo ka ngjashmëri me praktikën e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik të vendit dhe të disa akademive ushtarake homologe duke pasur parasysh veçoritë për të rekrutuar kontingjente cilësore.

9.8.1.6. Akademia e Forcave të Armatosura, si institucioni më i lartë ushtarak arsimor e kualifikues pasuniversitar i Forcave të Armatosura, ka përvojë më shumë se 55 vjeçare në fushën e kualifikimit pasuniversitar. Ajo u caktua si qendra e vetme e Forcave të Armatosura, ku do të realizohej kualifikimi pasuniversitar për mbrojtjen e disertacioneve dhe marrjen e gradave. Gjatë gjithë kësaj periudhe të gjatë kohore, kjo veprimtari shkencore ka qenë dhe mbetet pjesë e misionit, detyrave dhe përgjegjësisë të këtij institucioni, duke realizuar me sukses edhe ciklin e tretë të studimeve universitare. Gjithsej kanë qenë 20 disiplina të zgjedhura për studimet doktorale, me 131 disertacione të mbrojtura. Sot, projektet studimore, pothuajse, orientohen në dy fushat kryesore të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, duke qenë se edhe drejtimet e tjera derivojnë në fusha bazë të studimit.

## 9.8.2 Problematika

9.8.2.1. Përvoja e deritanishme kërkon që të shikojmë më mirë konsolidimin e kriterëve specifike institucionale që lidhen me filozofinë e re të arsimit ushtarak, si dhe të pasqyrimin të dukurive të reja të mjedisit të sigurisë dhe të mbrojtjes.

9.8.2.2. Vëmendje më të madhe nga MM dhe KDS-së për një mbështetje më të mirë financiare në trajtimin e mësimdhënësve që aktivizohen përtej ngarkesës ligjore pedagogjike të normuar.

9.8.2.3. Vëmendje më e madhe për të parë dhe forcuar më shumë kriteret specifike të pranimit të studentëve, si dhe kriteret që lidhen me fushën e studimit.

9.8.2.4. Ka nevojë për një planifikim më të studiuar të kërkesave të aplikantëve që do të përzgjidhen për të vazhduar programin e ciklit të tretë.

9.8.2.5. Ka nevojë për vazhdimin e zgjerimit dhe thellimin e bashkëpunimit të mëtejshëm, si me IAL-të në vend ashtu dhe me Akademitë e vendeve partnere të NATOS-s, përfshirë fushën e mësimdhënies dhe atë të kërkimit shkencor.

## 9.8.3. Sugjerime

9.8.3.1 Akademia e Forcave të Armatosura Ushtarake të respektojë angazhimet, parimet dhe përvojat e shkollave më të mira simotra në kuadër të angazhimit në NATO dhe BE, për ta kthyer në një IAL elitare për ngritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura.

9.8.3.2. Akademia e Forcave të Armatosura duhet të jetë i vetmi institucion për ekspertizë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në interes të vendimmarrjes politike.

9.8.3.3. Konsolidim i plotë i strukturës akademike të AFA me të gjithë nivelet e saj të studimit. Kjo do të bëjë të mundur rritjen e cilësisë dhe të produktivitetit të këtij aktiviteti mësimor - shkencor të suksesshëm deri tani.

9.8.3.4. Përfshirjen në Ligjin e Arsimit të Lartë Shqiptar, të institucionit të Akademisë së Forcave të Armatosura si një institucion i arsimit të lartë dhe krijimin e hapësirave ligjore për funksionimin e tij sipas këtij ligji.

9.8.3.5. Krijimin e hapësirave ligjore për dhënien e mundësive për bashkëpunimin e këtij institucioni me institucionet e tjera të larta arsimore në vend dhe jashtë vendit.

9.8.3.6. Krijimin e mundësive për njohjen dhe transferimin e krediteve të këtij institucioni, në institucione të tjera të larta arsimore në vend dhe njohjen apo unifikimin e moduleve dhe lëndëve mësimore.

9.8.3.7. Krijimin e hapësirave ligjore për kualifikimin dhe specializimin e vazhdueshëm të punonjësve të Akademisë së Forcave të Armatosura dhe agjencive të tjera të ushtarake, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

9.8.3.8. Realizimi në Akademinë e Forcave të Armatosura të të tria cikleve të studimit universitar, sikurse si modelet aktuale të akademive në SHBA, Belgjikë, Bullgari, Kanada, Angli, Çeki, Rumani, Norvegji, Poloni, etj.

9.8.3.9. Krijimin e mundësive ligjore për ndjekjen pas përfundimit të programit bachelor në arsimin ushtarak, të studimeve master në profile të tjera si brenda institucionit ashtu dhe jashtë institucionit. Kjo do të mundësojë orientimin e ushtarakut në tregun e punës pas lirimit të tij nga forcat e armatosura ose krijimin e mundësive që pas, ciklit

të parë të studimeve ushtarake të ketë akses në tregun e punës.

## 9.9. Universiteti Bujqësor i Tiranës

### 9.9.1. Gjendja aktuale

9.9.1.1. Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), është qendra e vetme e formimit universitar, pasuniversitar, kërkimit shkencor, trajnimit dhe ekstensionit në fushën e bujqësisë dhe ushqimit. Ky IAL u krijua më 1 Nëntor 1951, si Institut i Lartë Bujqësor (ILB) dhe mori statusin e një Universiteti, në vitin 1991, kur dhe u emërtua Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT). Deri në vitin 1990 universiteti ishte i organizuar në katër fakultete (Agronomi, Ekonomi Agrare, Inxhinieri Pyjore dhe Veterinari) me rreth 6000 studente e 480 pedagogë. Në vitin 1992-1994, u krye ristrukturimi akademik i universitetit. Që nga viti akademik 2005-2006, UBT i ka organizuar studimet sipas skemës së re 3+2+3 (Bachelor, Master dhe Doktoraturë).

9.9.1.2. Në UBT kërkimi shkencor konsiderohet si një komponent esencial i jetës akademike. Kërkimi është realizuar në sajë të një numri të madh projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare. UBT është iniciator i lidhjeve të shkencës me prodhimin. Këto lidhje janë konkretizuar përmes marrëveshjeve të lidhura me biznesin shqiptar.

9.9.1.3. UBT-ja, ka në përbërjen e tij pesë Fakultete: Fakulteti I Bujqësisë dhe Mjedisit, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Fakulteti Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Fakulteti i Shkencave Pyjore, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare.

9.9.1.4. Misioni: Universiteti Bujqësor i Tiranës ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mjedisit. Misioni i tij lidhet me formimin bujqësor në drejtim të zhvillimit të bujqësisë moderne dhe garantimit të ushqimit të shëndetshëm dhe cilësor.

9.9.1.5. Vizioni: Universiteti Bujqësor i Tiranës synon të mbetet qendra më ekselente, më e madhe e edukimit universitar, pasuniversitar, kërkimit dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së bujqësisë, ushqimit dhe të mjedisit. Duke ndërthurur edukimin me kërkimin në nivel të lartë, ai kërkon të përgatisë jo vetëm specialistë të kualifikuar, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë, veçanërisht për zhvillimin rural, zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe agroturizmin. UBT duhet ta shohë vetveten në kuadrin e një perspektive të gjerë ndërkombëtare.

### 9.9.2. Problematika

9.9.2.1. Shtrirja përtej misionit dhe vizionit në disa raste ka ndikuar në uljen e cilësisë së shërbimit dhe përgatitjes së specialistëve.

9.9.2.2. Emërimet pa konkurime dhe pa plotësuar kriteret e duhura të stafit akademik.

9.9.2.3. Mësimdhënia jashtë formimit universitar.

9.9.2.4. Shtrirja e mësimdhënies edhe në sistemin me kohë të pjesshme, si dhe në filialet në rrethe e ka dëmton cilësinë e saj.

9.9.2.5. Kontratat me privatët për mjediset universitare të dhëna me qira, që janë kthyer në lokale dhe nuk mund të përdoren për qëllime mësimdhënieje dhe kërkim shkencor.

### 9.9.3. Sugjerime

9.9.3.1. Rikonfigurimi i drejtimit themelor të Institucionit, duke mbuluar fushat e tij specifike të specializimit dhe ekspertizës pa u mbivendosur me IAL-të e tjera.

9.9.3.2. Universiteti Bujqësor i Tiranës duhet të jetë promotori i mbështetjes dhe zhvillimit të politikave kombëtare dhe rajonale, duke ndikuar sidomos në fushat e Bujqësisë, Blektorisë dhe Fondit Gjenetik të Farërave.

9.9.3.3. UBT duhet të promovojë tendencat e reja të zhvillimit në këto fusha me rëndësi strategjike për përparimin e vendit.

9.9.3.4. UBT duhet të shërbejë si një hallkë lidhëse midis politikave të zhvillimit, ekspertizave të kërkimeve shkencore dhe përgatitjes së kuadrove në shërbim të fushave, që mbulon për të ndikuar në rritjen ekonomike të vendit si dhe në drejtim të agro-biznesit, agro-turizmit, agro-industrisë etj.

9.9.3.5. UBT-ja duhet të ndikojë përmes veprimtarisë së saj në zhvillimin e qëndrueshëm në zonat bujqësore e blegtorale, pyjore dhe ato malore.

9.9.3.6. Ky Institucion duhet të bashkëpunojë intensivisht edhe me IAL të specializuara për zhvillimin e zonave urbane, për një barazpeshë më të mirë në zhvillimin territorial në tërësi, veçanërisht në raportet ruralo-urbane për një shfrytëzim më të mirë të burimeve ekonomike të vendit.

9.9.3.7. Ky universitet duhet t'i rikthehet traditës së tij të hershme të cilësisë si një IAL me njohje ndërkombtare. Organizimi i tij i brendshëm i duhet përshtatur thelbësisht misionit dhe vizionit të tij, politikave zhvillimore të vendit në përgatitjen e specialistëve të fushave të lartpërmendura dhe nevojave të tregut të punës.

9.9.3.8. UBT duhet të shërbejë si model i një institucioni të rëndësishëm në fushën e promovimit të teknologjive të reja dhe studimeve bashkëkohore, si në nivel kombëtar dhe në atë rajonal.

9.9.3.9. Të nxitet ngritja dhe riorganizimi i strukturave funksionale që realizojnë bashkëveprimin e të dhënave teorike me zbatimin praktik të tyre.

9.9.3.10. Përdorimi i mjediseve universitare vetëm për qëllime mësimore – shkencore, jo nga të tretë për aktivitete të tjera të ndryshme nga këto.

9.9.3.11. Organizimi strukturor i kësaj IAL-je është dhe duhet të jetë i njëjtë me atë të IAL-ve të tjera publike.

9.9.3.12. Financimi i këtij Institucioni të Arsimit të Lartë mbetet i njëjtë si për të gjitha IAL-ëtë e tjera publike. Duhet të theksohet se për degët prioritare të zhvillimit ku nuk ka konkurrencë në treg, shteti duhet të ketë financim të veçantë si për të gjitha IAL-ëtë e specializuara.

## 9.10 Universitetet Rajonale

9.10.1. Tradita universitare në vend ka nxitur dhe krijuar edhe ngritjen e universiteteve të rretheve, të cilët gjatë periudhës së tranzicionit janë shtrirë edhe në rajone të tjera, përveç atyre që tradicionalisht kanë pasur universitet ose filiale si Shkodra, Durrësi, Gjirokastra dhe Vlora.

9.10.2. Në këto vitet e fundit ky fenomen është shtuar jashtë mase dhe numri i universiteteve në rrethe është gati trefishuar. Përveç degëve tradicionale që një pjesë e këtyre universiteteve kanë zhvilluar, në krijimet e reja nuk ka pasur një

strategji zhvillimi të tyre. Ato ofrojnë kurrikula të njëjta me universitetet tradicionale. Kjo bën që këto universitete të jenë të pa lidhura me tregun e punës dhe si rrjedhojë të ofrojnë diploma të njëjta me UT por që shpesh herë janë të një niveli më të ulët se ato të UT.

9.10.3. Fatkeqësisht, këto universitete nuk janë parë si elemente të zhvillimit rajonal duke u përpjekur t'i orientojnë ato në bazë të nevojave të zhvillimit dhe kërkesave e traditave sipas rajoneve.

### Sugjerime - Specifike

9.10.4. Shteti duhet ta shohë me përparësi zhvillimin dhe trajnimin universitar rajonal. Duhet të lidhë elementet e zhvillimit me ato të trajnimit universitar për të ndihmuar zhvillimin kombëtar dhe atë rajonal.

9.10.5. Mbi këtë bazë, Komisioni sugjeron Krijimin e Qendrave Rajonale të Zhvillimit dhe Trajnimit. Në këto qendra mendojmë se nevojat e zhvillimi rajonal mund të mundësohen më mirë, duke i lidhur me trajnimin e domosdoshëm në nivel universitar. Kjo është një mënyrë më e mirë për të lidhur nevojat e tregut të punës me ofertën e trajnimit universitar.

9.10.6. Komisioni, gjithashtu sugjeron që trajnimi universitar në këto qendra zhvillimi dhe trajnimi të bëhet i fokusuar në diplomat universitare profesionale dhe në ciklin e parë të studimeve. Kjo nuk i heq të drejtën këtyre universiteteve për të ofruar edhe diploma të ciklit të dytë, apo degë të ndryshme nga ato prioritare të shtetit. Por, në këtë rast ata duhet të konkurrojnë njëllor mbi bazën e standardit me universitetet e tjera dhe shteti nuk mund të garantojë financim të vazhdueshëm për këto degë.

9.10.7. Shteti duhet të financojë vetëm ato degë që i ka strategjike për zhvillimin rajonal dhe kombëtar. Këto qendra trajnimi mund të përfitojnë fonde edhe nga qeverisjet vendore, si dhe duhet të nxitin për të bashkëpunuar me biznesin lokal duke të lidhur nevojat e tij me trajnimin universitar.

## KAPITULLI 10

### VËNIA NË JETË E REFORMËS

#### 10.1 Rëndësia e vënies në jetë

10.1.1. Është e rëndësishme të theksohet qysh në fillim se faza më e rëndësishme e çdo reforme është faza e vënies në jetë të saj. Në kushtet e një reforme të thellë kjo fazë merr një rëndësi akoma më të veçantë. Të gjitha reformat e thella kanë një element që i dallon; atë të zbatimit rigoroz të vendimeve, apo ligjeve që dalin prej tyre.

10.1.2. Gjithashtu vlen të përmendim këtu një nga konkluzionet e dala nga analizat e këtij Komisioni: Fakti që një pjesë e problemeve në arsimin e lartë në Shqipëri kanë dalë nga moszbatimi i ligjit.

10.1.3. Prandaj, mendojmë dhe sugjerojmë që monitorimi i zbatimit të Reformës në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, i propozuar nga ky Komision, duhet të jetë ashtu si edhe hartimi i tij, i pavarur dhe rigoroz.

#### 10.2. Fazat e Vënies në Jetë

10.2.1. Faza hartuese e Dokumentit Strategjik dhe Ligjit

Kjo Reformë që nisi në Janar të 2014, ka kaluar tashmë në fazën përgatitore, atë të hartimit të dokumentit strategjik për parimet dhe drejtimit kryesor të reformës.

10.2.1.2. Pas hartimit të Raportit të parë (Green Paper) nga Komisioni, raporti duhet të diskutohet me grupet e interesit dhe me faktorët e arsimit të lartë në Shqipëri. Kjo është faza në të cilën hyjmë në daljen e këtij raporti (Shiko Figurën 10.1). Propozimet e marra, pasi analizohen përfshihen në Raportin përfundimtar (Ëhite Paper) që është edhe dokumenti kryesor për realizimin e politikës së Arsimit të Lartë në Shqipëri.

10.2.1.3. Kjo fazë ndiqet nga ndryshimet ligjore përkatëse dhe kalon në strukturat ekzekutive dhe legjislativë që parashikon ligji.

10.2.1.4. Me aprovimin e ligjit, mbyllet Faza e Hartimit dhe Fillon Faza tjetër, ajo e Zbatimit afatmesëm të Reformës në Arsimin e Lartë në Shqipëri. Kjo fazë do të zgjasë së paku tre vjet.

10.2.2. Faza e Parë afatmesme. Kjo fazë ndahet në të paktën tri vite dhe ka si qëllim vënien në jetë të ligjit të arsimit të lartë dhe përgatitjen e IAL-ve për krijimin e sistemit të unifikuar të arsimit të lartë në Shqipëri.

10.2.2.1. Viti i parë i kësaj faze (2014-15) është ai i ndryshimeve të menjëhershme – përgatitja për ndryshim. Në këtë vit kihen parasysh:

- riorganizimi i IAL –ve sipas parimeve të reformës
- riorganizimi strukturor i arsimit të lartë shqiptar
- krijimi i sistemit të aplikimit të studentëve hyrës në IAL sipas parimeve të reformës.
- mbikqyrja e ndryshimeve organizative brenda IAL-ve
- mbikqyrja e ndryshimeve në nivel makro: qeveria dhe institucionet e reja
- shpërndarja e informacionit për studentët, prindërit, mësuesit e shkollave të mesme dhe pedagogët
- krijimi i mekanizmave të kontrollit, brenda IAL-ve dhe jashtë tyre
- shpjegimi i ndryshimeve ligjore
- përgatitja e akteve nën ligjore
- trajnimi i stafit për ndryshim

10.2.2.2. Viti i dytë i kësaj faze (2015-2016) - Viti i vënies në jetë, fokusohet në aplikimin dhe monitorimin të ndryshimeve. Gjatë kësaj faze duhet të kryhen:

- krijimi i një organi të asistencës për ndryshime në IAL (pranë ministrisë) për të dhënë ndihmë dhe asistencë teknike
- zbatimi i skemës së re të financimit të arsimit të lartë
- zbatimi i reformës për kërkimin shkencor
- ringritja e sistemeve të brendshme të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë
- antarësimi i plotë i ASKAL-it në ENQAR

10.2.2.3. Viti i fundit i kësaj faze është (2016-2017) - Viti i Vlerësimit. Gjatë kësaj periudhe ëshë shumë i rëndësishëm monitorimi i çdo ndryshimi dhe tjetërsimi institucional. Në këtë fazë kryhen:



- krijimi i treguesve të matjes së cilësisë dhe vënies në jetë.
- monitorimi i këtyre treguesve
- përgatitja dhe emërtimi i raporteve të brendshme për vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
- përgatitja për akreditim e hapësirës shqiptare të arsimit të lartë
- akreditimi i IAL-ve në hapësirën shqiptare të arsimit të lartë

10.2.3. Faza e Dytë Afatgjate – Faza e standardizimit të hapësirës shqiptare të arsimit të lartë dhe integritit në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

10.2.3.1. Gjatë vitit të parë të kësaj faze, (2017-2018) Viti i Ridimensionimi i Arsimit të Lartë do të kryen:

- një analizë e detajuar mbi shëndetin financiar, organizativ dhe administrativ të IAL-ve në fazën e parë. Në këtë fazë kemi një ridimensionim të arsimit të lartë në Shqipëri. IAL-të përgatiten të ndryshojnë statusin.
- Përgatiten ndryshimet ligjore – duhet të jenë gati ndryshimet ligjore që nevojiten për këtë ndryshim.
- krijimi i mekanizmave të përhershëm të monitorimit të standardit.
- ridimensionimi i IAL-ve në përputhje me rezultatet e akreditimit dhe kornizën ligjore në fuqi.
- analiza dhe vlerësimi i efektivitetit të reformës nga Komisioni teknik i reformës.
- propozimi për masat korrektuese, përmirësuese dhe plotësuese.


10.2.3.2. Viti i dytë i kësaj faze është ai i Unifikimit të Hapësirës Shqiptare të Arsimit të Lartë (2018-2019). Gjatë këtij viti do të kryen:

- zbatimimi i masave të propozuara nga Komisioni teknik i Reformës
- unifikimi i sistemit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë
- unifikimi i hapësirës shqipfolëse të arsimit të lartë

10.2.3.3. Kjo është dhe faza e fundit e Reformës, 2019-2022 – Faza e Integritit të arsimit të lartë shqiptar në hapësirat evropiane. Gjatë kësaj faze kryhet:

- Identifikimi i diferencave të mbetura ndërmjet hapësirës shqiptare dhe asaj evropiane të arsimit të lartë
- hartimi dhe zbatimimi i masave korrektuese për eliminimin e diferencave
- integrimi në hapësirën evropiane.

## FAZAT E ZBATIMIT TE REFORMES SE ARSIMIT TE LARTE



# E Ardhmja e Sistemit të Unifikuar dhe të Standardizuar, i AL-ve në Shqipëri

## Kapitulli 11

E Ardhmja e Sistemit të Unifikuar dhe të Standardizuar, i AL-ve në Shqipëri

11.1. Arsimi i lartë në Shqipëri duhet të mbetet shërbim publik dhe si i tillë shteti është garantuesi kryesor i tij, bazuar edhe mbi disponimin kushtetues aktual. Megjithëse shteti duhet të jetë garantuesi kryesor i tij dhe ai, i cili duhet të përcaktojë drejtimet e zhvillimit, kjo nuk do të thotë që shteti të jetë domosdoshmërisht: a) financuesi kryesor i tij; b) prodhuesi i arsimit të lartë në Shqipëri.

11.2. Siç është përmendur edhe më sipër, bazuar në eksperiencat më të mira ndërkombëtare u mendua që ndërsa përqasja e shtetit në arsimin e lartë të ndryshojë, njëherazi duhet të ndryshojë edhe pavarësia e plotë institucionale e IAL-ve në Shqipëri. Kjo pavarësi nuk mund të arrihet plotësisht në qoftë se nuk do të ketë edhe ndryshim në statutet e universiteteve publike, ku të garantohet me ligj kjo pavarësi.

11.3. Institucionet publike të arsimit të lartë nuk kanë autonominë Kushtetuese, neni 57/7, që duhej të ishte garantuar, sipas legjislacionit aktual në fuqi. Ky nen nuk garanton zhdërvjelltësi, mekanizma efektivë të administrimit të suksesshëm dhe nuk është motivues për të ofruar një arsim cilësor në kushtet aktuale të zhvillimit të shoqërisë. Nga ana tjetër, edhe arsimi i lartë jopublik nuk solli pritshmëri lidhur me përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë, edhe pse ndikoi pozitivisht në rritjen e numrit të studentëve në Shqipëri.

11.4. Në të njëjtën kohë, bazuar mbi eksperiencat më të mira ndërkombëtare, por edhe mbi eksperiencën më të mirë vendase, është i preferuar organizimi i IAL-ve të tipit fondacion për shkakun se ato kanë zhdërvjelltësi dhe liri organizimi e përdorimi efektiv të fondeve dhe se ofrojnë shërbim publik pa qëllim fitimi. Por nga ana tjetër institucionet e arsimit të lartë nuk mund të kthehen të gjitha në fondacione, bazuar mbi ligjin dhe kushtetutën e RSH-së.

11.5. Një tjetër arsye për të ndryshuar statusin afatgjatë të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri është edhe fakti se fuqia blerëse e familjeve shqiptare nuk është e tillë për të përballuar një sistem të fortë privat, ku të ketë tarifa konkurruese që të garantojnë një nga parimet kryesore, atë të konkurrencës së barabartë.

11.6. Një tjetër argument për të shkuar drejt një njësimi të statuseve të arsimit të lartë në Shqipëri, është edhe fakti që tregu në Shqipëri është i vogël dhe si i tillë parimi i konkurrencës së mirëfilltë nuk mund të aplikohet duke pasur një numër të madh të institucioneve me statuse të veçanta. Mekanizmat rregulluese të institucioneve me statuse të ndryshme, bëhen shumë të komplikuar (siç edhe tregoi eksperiencia 15 vjeçare në Shqipëri) dhe kështu krijojnë mundësinë për abuzime në sistem.

11.7. Bazuar në sa përmendëm më lart, Komisioni vlerëson që në fazën afatgjatë të zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri, IAL-të, të lëvizin drejt “qendrës” pra drejt një statusi të ri të të qenit “fondacion”, një organizatë jo-fitimprurëse, por që edhe mund të krijojë aktivitete ekonomike fitimprurëse për produktet akademike që prodhon dhe që duhet t’i përdorë në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

11.8. Kjo nuk do të thotë se nuk duhet apo nuk do të ekzistojnë institucione me status tjetër në sistem, me status publik dhe jo publik, fitimprurës dhe jo fitimprurës. Edhe në vendet si Britania e Madhe ku ky sistem aplikohet, nuk ndalohet krijimi apo edhe funksionimi i IAL-ve me status tjetër nga ai i lartpërmendur. Kjo për shkak të lejitimit të diversitetit dhe zgjerimit të tregut për arsimin dhe kërkim shkencor.

11.9. Komisioni sugjeron tiparet e mëposhtme të zhvillimit afatgjatë universitar në Shqipëri:

1. Pavarësi: a) e plotë akademike b) dhe financiare e audituar
2. Një status të ndryshëm kushtetues nga ai autonom në të pavarur
3. Një organizim të qartë institucional të pavarur dhe efektiv, ku ndarja midis anës akademike dhe asaj financiare të jetë e qartë.
4. Një mundësi për trajtim jo diskriminues financiar, bazuar mbi parime të njëjta.
5. Garantimin e një cilësie dhe standardi në mësimdhënie dhe kërkim shkencor konkurrues me ato të vendeve të zhvilluara evropiane.
6. Transformimin e orientimit të tyre për të realizuar më shumë kërkim shkencor, krahas rritjes së nivelit dhe cilësisë së mësimdhënies
7. Forcimin dhe garantimin e financimit të tyre për të përballuar sfidat e një zhvillimi afatgjatë dhe strategjik të arsimit të lartë konkurrues në Shqipëri.
8. Zvogëlimin e barrierave burokratike të funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë, për të rritur eficientë dhe funksionimin në përmbushje të misioneve të tyre.
9. Krijimin e një hapësire rajonale, mbarëkombëtare të institucioneve të arsimit të lartë, të afta që të tërheqin studentë dhe veprimtari kërkimore - shkencore me interes për rajonin, duke ndikuar në tregun universitar rajonal.
10. Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri duhet të ofrojnë mësimdhënie jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe minimalisht në atë angleze me qëllim hapjen e programeve të studimit me interes për studiues dhe kërkues

nga vendet e tjera të zhvilluara, si dhe për të krijuar mundësi reale për bashkëpunim institucional dhe partneritet me simotrat evropiane e më gjerë.

11.10. Ndërsa në fazën e parë afatmesme të zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri është menduar të fokusohet drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit të lartë, në fazën e dytë afatgjate duhet të kemi mundësi për zgjedhje më efikase të statuseve të IAL-ve me orientim vetë administrimin dhe pavarësinë e tyre.

11.11. Sot arsimit i lartë është publik dhe jo publik, ku ky i fundit është i karakterit fitimprurës dhe jo fitimprurës. Komisioni vlerëson se në terma afatgjatë duke lejuar njëkohësisht diversitetin dhe zgjedhjen e institucioneve të arsimit të lartë, të shkohet drejt strukturave universitare efektive dhe konkurruese. Në vlerësimin e komisionit, organizimi si fondacione apo struktura të ngjashme që lejojnë zhdërvjelltësi në orientimi drejt zhvillimit, si për institucionet publike ashtu edhe për ato jo publike është e ardhmja që do konsolidojë suksesin e reformimit afatgjatë të sistemin arsimor.

11.12. Për këtë kërkohen ndryshime të mëtejshme ligjore dhe padyshim edhe ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të paktën kjo për sa i përket përcaktimit të tyre si institucione publike dhe jo-publike, si dhe ndryshimit të statusit nga institucione autonome në institucione të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre. Në arsimin e lartë nuk duhet të mbizotërojë koncepti i institucionit publik, por ai i shërbimit publik.





